

20140391133

L I G J **PËR KOMUNIKIME ELEKTRONIKE**

Kapitulli i parë **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

Neni 1 **Lënda e Ligjit**

Me këtë ligj rregullohen kushtet dhe mënyra e sigurimit të rrjeteve komunikuese elektronike publike dhe shërbimeve komunikuese elektronike publike në Republikën e Maqedonisë.

Neni 2 **Qëllimi i Ligjit**

Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë:

- nxitjen e zhvillimit të rrjeteve komunikuese elektronike publike dhe shërbimeve në Republikën e Maqedonisë, me qëllim të sigurohet zhvillim ekonomik dhe social,
- nxitjen e shfrytëzimit dhe zhvillimit të qasjes me shtrirje të gjerë në shërbime (broadband),
- mbrojtjen e të drejtave të shfrytëzuesve, duke i përfshirë shfrytëzuesit e fundit me invaliditet dhe shfrytëzuesit e fundit me nevoja të veçanta sociale,
- sigurimin e konkurrencës efikase dhe të qëndrueshme në tregun e komunikimeve elektronike,
- sigurimin e shërbimit universal,
- shfrytëzimin efikas të spektrit të radiofrekuencës dhe numeracionit,
- përparimin e zhvillimit dhe nxitjes së investimeve në rrjetet komunikuese elektronike publike me vendosjen e teknologjive dhe shërbimeve të reja, ndërsa posaçërisht me vendosjen e gjeneratave të ardhshme të rrjeteve komunikuese elektronike publike dhe
- sigurimin e besueshmërisë së komunikimeve.

Neni 3 **Definicione**

Shprehje të veçanta të përdorura në këtë ligj e kanë këtë domethënie:

1. Rrjeti komunikues elektronik është sistem bartës dhe atje ku është e zbatueshme edhe pajisje komutative apo orientuese dhe mjete tjera duke përfshirë elemente të rrjetit që nuk janë aktive, ndërsa të cilat mundësojnë transmetim të sinjaleve nëpërmjet mjeteve të telta, radiovalëve, mjeteve optike apo mjeteve tjera elektromagnetike, duke përfshirë rrjete satelitore, fikse (me komutacion të qarqeve apo komutacion të pakove, duke përfshirë edhe Internet) dhe rrjete mobile tokësore, sisteme kablloviqe elektroenergjetike, nëse shfrytëzohen për transmetim e sinjaleve komunikuese, rrjete radiodifuzive dhe rrjete televizive kablloviqe, pavarësisht nga lloji i informatave që transmetohen;

2. Shërbim komunikues elektronik është shërbimi që zakonisht ofrohet për kompensim, ndërsa i cili plotësisht apo kryesisht përbëhet nga transmetimi i sinjaleve nëpërmjet rrjeteve komunikuese elektronike dhe i përfshin shërbimet telekomunikuese dhe shërbimet bartëse në rrjetet e dedikuara për emetimin apo rrimetimin e përmbajtjeve programore, por i përjashton shërbimet të cilat mundësojnë apo realizojnë kontroll redaktues mbi përmbajtjet të cilat transmetohen me ndihmën e rrjeteve apo shërbimeve komunikuese elektronike, ndërsa nuk i përfshin as shërbimet e shoqërisë informatike të cilat plotësisht apo pjesërisht nuk përbëhen nga transmetimi i sinjaleve nëpërmjet rrjeteve komunikuese elektronike;

3. Posta elektronike është porosi në formë të tekstit, zërit apo fotografisë e transmetuar nëpërmjet rrjetit komunikues elektronik publik dhe e cila mund të ruhet në rrjetin apo pajisjen terminale të pranuesit, derisa pranuesi nuk e merr;

4. Rrjet komunikues elektronik publik është rrjeti komunikues elektronik i cili plotësisht apo pjesa më e madhe e tij shfrytëzohet për sigurimin e shërbimeve komunikuese elektronike të arritshme për opinionin dhe të cilat e përkrahin transmetimin e informatave ndërmjet pikave përfundimtare të rrjetit;

5. Lak lokal është qark fizik komunikues, që e lidh pikën përfundimtare të rrjetit me kornizën shpërndarëse apo me mjet tjetër ekuivalent në rrjet fiks komunikues elektronik publik;

6. Shërbim komunikues elektronik publik është shërbimi komunikues elektronik i arritshëm për opinionin;

7. Shërbim telefonik i arritshëm publikisht është shërbimi i arritshëm për opinionin për thirrje dhe pranim, në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë, i thirrjeve nacionale apo nacionale dhe ndërkombëtare nëpërmjet numrit apo numrave nga plani telefonik nacional apo ndërkombëtar për numeracion;

8. Kod i shfrytëzuesit për identifikim do të thotë kodi unik për identifikim i ndarë parapaguesit apo shfrytëzuesit të regjistruar për shërbimin për qasje në internet apo për shërbim komunikues nëpërmjet internetit;

9. Kodi i qelisë do të thotë identiteti i qelisë prej ku ka filluar apo ka përfunduar thirrja telefonike në rrjetin komunikues mobil publik;

10. Tentim i pasuksesshëm për thirrje do të thotë komunikimi kur thirrja telefonike ka qenë i vendosur me sukses, por atij nuk i është përgjigjur apo kur ka pasur intervenim për menaxhim me rrjetin;

11. Shërbime radiokomunikuese janë shërbime komunikuese elektronike që sigurohen me shfrytëzimin e radiofrekuencave;

12. Shërbim universal është pako minimale e shërbimeve me kualitet të caktuar, e arritshme me çmim të pranueshëm për të gjithë shfrytëzuesit e fundit në Republikën e Maqedonisë, pa marrë parasysh lokacionin gjeografik;

13. Dhënës i shërbimit universal është personi juridik i cili siguron shërbim universal;

14. Shërbime të shoqërisë informatike janë shërbime që sigurohen për kompensim në largësi, nëpërmjet mjeteve elektronike dhe me kërkesë personale të pranuesit të shërbimit. “Në largësi” shënon se shërbimi sigurohet pa prezencë të njëkohshme të të dyja palëve. “Nëpërmjet mjeteve elektronike” do të thotë se shërbimi dërgohet nga pika fillestare/burimore dhe merret në destinacionin e fundit nëpërmjet pajisjes elektronike për procesim (duke përfshirë edhe kompresim digjital) dhe ruajtje të të dhënave dhe dërgohet, transmetohet dhe merret në tërësi nëpërmjet kabllor, radiovalëve, mjeteve optike apo mjeteve tjera elektromagnetike. “Me kërkesë personale të pranuesit të shërbimit” do të thotë se shërbimet sigurohen nëpërmjet transmetimit të të dhënave me kërkesë personale;

15. Shërbim me vlerë të shtuar është shërbimi që kërkon përpunim të të dhënave për komunikacion apo të dhëna për lokacion, më shumë sesa që është e nevojshme që të sigurohet transmetimi i komunikimit apo arkëtimi i tij;

16. Numër gjeografik është numri nga Plani për numeracion të rrjeteve komunikuese publike dhe shërbimeve të Republikës së Maqedonisë ku një pjesë nga struktura e tij e shifrave përmban domethënie gjeografike që shfrytëzohet për rutimin e thirrjeve ndaj lokacionit fizik të pikës përfundimtare të rrjetit;

17. Numër jogjeografik është numri nga Plani për numeracion të rrjeteve komunikuese publike dhe shërbimeve të Republikës së Maqedonisë që nuk është numër gjeografik dhe ndër të tjera i përfshin numrat mobilë, numrat për shërbime falas dhe numrat për qasje të shërbimit me vlerë të shtuar;

18. Interkoneksion është lloj i veçantë i qasjes i cili sigurohet ndërmjet operatorëve të rrjeteve komunikuese elektronike publike dhe me të cilin vendoset lidhja fizike dhe logjike e rrjeteve komunikuese elektronike publike me një apo më shumë operatorë të ndryshëm me qëllim që t'u mundësohet shfrytëzuesve të një operatori të komunikojnë me shfrytëzuesit e operatorit tjetër, apo t'u qasen shërbimeve që i siguron operatori tjetër. Këto shërbime mund t'i sigurojnë palët të cilat janë të lidhura në mënyrë të ndërsjellë apo palë tjera të cilat kanë qasje në rrjet;

19. Qasje është mundësimi i qasshmërisë në mjetet dhe/apo shërbimet e operatorit tjetër në kushte të caktuara, në bazë ekskluzive apo joekskluzive, për shkak të sigurimit të shërbimeve komunikuese elektronike duke përfshirë edhe kur ato shfrytëzohen për sigurimin e shërbimeve të shoqërisë informatike apo emetimin e përmbajtjeve programore. Kjo ndër të tjera përfshin: qasje te elemente të rrjetit dhe mjete shoqëruese që mund të përfshin lidhjen e pajisjes nëpërmjet mënyrës fikse apo lëvizëse (kjo posaçërisht përfshin qasje te laku lokal dhe te mjetet dhe shërbimet, të domosdoshme për sigurimin e shërbimeve nëpërmjet lakut lokal), qasje te infrastruktura fizike, duke përfshirë ndërtesa, kanale dhe shtylla, qasje te sisteme përkatëse softuerike, duke përfshirë sisteme për mbështetje operative, qasje te sistemet informatike apo baza të të dhënave për parashtrimin e kërkesave për para-porositje, sigurim, dërgesë, mirëmbajtje, rregullim dhe arkëtim, qasje te sistemet për translacion të numrave apo qasje te sistemet të cilat ofrojnë funksionalitet të tillë ekuivalent, qasje te rrjetet fikse dhe mobile, posaçërisht për roaming, qasje te sistemet me qasje të kushtëzuar për shërbime televizive digjitale dhe/apo qasje te shërbimet virtuale të rrjetit;

20. Infrastrukturë fizike është secili element nga rrjeti i cili nuk është aktiv si gypa, shtylla, kanale, dhoma kontrolluese, shahta, kabinete, ndërtesa apo hyrje në ndërtesa, instalime të antenave, kulla dhe mjete të tyre shoqëruese;

21. Rrjet komunikues elektronik për sigurimin e transmetimit me shpejtësi të mëdha, në kuptim të Kapitullit të nëntë të këtij ligji, është rrjeti komunikues elektronik që mundëson qasje me shtrirje të gjerë te shërbimet (broadband) me shpejtësi të transmetimit prej së paku 30 Mbps;

22. Infrastrukturë fizike në ndërtesë është infrastruktura fizike e cila është e vendosur te shfrytëzuesi i fundit, duke përfshirë edhe elementet të cilat janë në pronësi të përbashkët të dedikuara të përmbajnë rrjete komunikuese elektronike qasëse të telta dhe/apo të patelta që do të kenë mundësi të sigurojnë rrjete komunikuese elektronike dhe lidhje të pikës së koncentrimit të ndërtesës me pikë përfundimtare të rrjetit në rrjet komunikues elektronik publik;

23. Infrastrukturë fizike në ndërtesë për transmetim me shpejtësi të mëdha është infrastruktura fizike në ndërtesë e dedikuar të përmban elemente të rrjetit komunikues elektronik për sigurimin e transmetimit me shpejtësi të mëdha;

24. Sigurim i rrjetit komunikues elektronik do të thotë ndërtimi, puna dhe menaxhimi me rrjetin komunikues elektronik apo mundësimi i qasshmërisë së të njëjtit;

25. Operator është personi fizik i cili kryen veprimtari apo personi juridik i cili siguron apo ka për qëllim të sigurojë rrjet komunikues elektronik publik dhe/apo shërbime si dhe mjete shoqëruese, në bazë të notifikimit të dorëzuar dhe vërtetimit të marrë për regjistrim nga Agjencia për Komunikime Elektronike;

26. Pika përfundimtare e rrjetit është pikë fizike në të cilën parapaguesi ka qasje te rrjeti komunikues publik. Kur rrjetet përfshijnë komutacion apo orientim, pika përfundimtare e rrjetit identifikohet me adresë të veçantë të rrjetit, që ka të bëjë me numër të parapaguesit apo emër;

27. Pajisje terminale është prodhimi apo pjesa e tij përkatëse, që mundëson komunikim në mënyrë që kyçet në mënyrë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në pikë përfundimtare të rrjetit në rrjet komunikues elektronik publik i cili në tërësi apo pjesërisht shfrytëzohet për sigurimin e shërbimeve komunikuese elektronike publike;

28. Të dhëna për qarkullimin e komunikimit janë të dhëna që përpunohen për shkak të transmetimit të komunikimit nëpërmjet rrjetit komunikues elektronik publik për shkak të arkëtimit të të njëjtit;

29. Të dhëna për lokacion janë të dhëna që përpunohen në rrjet publik komunikues elektronik apo me shërbim publik komunikues elektronik të cilat e shënojnë lokacionin gjeografik të pajisjes terminale të shfrytëzuesit të fundit të shërbimit publik komunikues elektronik;

30. Rrezikim i sigurisë së të dhënave personale është rrezikimi që sjell te asgjësimi i rastësishëm apo i paligjshëm, humbja, ndryshimi, zbulimi i paautorizuar apo qasje te të dhënat personale të cilat barten, ruhen apo në mënyrë tjetër përpunohen në lidhje me sigurimin e shërbimeve publike komunikuese elektronike;

31. Paraqitja e identifikimit të linjës thirrëse është shërbim që mundëson parapaguesi i thirrur ta identifikojë pikën përfundimtare të rrjetit prej ku vjen thirrja në bazë të numrit apo kodit të ndarë për atë pikë përfundimtare të rrjetit;

32. Paraqitja e identifikimit të linjës së thirrur është shërbim që mundëson shfrytëzuesi që thirr ta identifikojë pikën përfundimtare të rrjetit ku përfundon thirrja në bazë të numrit apo kodit të ndarë për atë pikë përfundimtare të rrjetit;

33. Parapagues është personi fizik apo juridik i cili për shfrytëzim të shërbimeve publike komunikuese lidh marrëveshje me operatorin i cili i siguron ato shërbime;

34. Shfrytëzues është personi fizik apo juridik i cili shfrytëzon apo kërkon shërbim publik komunikues elektronik, ndërsa në kuptim të dispozitave nga Kapitulli i tetëmbëdhjetë të këtij ligji, shfrytëzues është personi fizik i cili shfrytëzon shërbim publik komunikues elektronik, për qëllime private apo afariste, me ç'rast nuk duhet medoemos të parapaguhet për ato shërbime.

35. Shfrytëzues përfundimtar është shfrytëzuesi që nuk ka rrjet publik komunikues apo nuk siguron shërbim publik komunikues;

36. Konsumator është personi fizik, i cili shfrytëzon apo kërkon shërbim publik komunikues elektronik për qëllime të cilat nuk janë të lidhura me veprimtarinë apo profesionin e tij;

37. Sistem për qasje të kushtëzuar është masë teknike dhe/apo procedurë ku qasja te emetimi i mbrojtur i radios apo televiziv në formë të kuptueshme është kushtëzuar me parapagim apo në mënyrë tjetër të lejimit individual paraprak;

38. Shërbim televiziv me format të ekranit të gjerë është shërbim televiziv i cili përbëhet plotësisht apo kryesisht nga programe që janë prodhuar dhe rregulluar të prezantohen në lartësi të plotë në ekrane me format të gjerë. Format 16:9 është format referent për shërbimet për televizion në ekran të gjerë;

39. Numër është numri i caktuar me Planin për numeracion për rrjete dhe shërbime publike komunikuese të Republikës së Maqedonisë;

40. Numra të shërbimeve për thirrje urgjente janë numrat nga Plani për numeracion për rrjete dhe shërbime publike komunikuese të Republikës së Maqedonisë të cilat veçanërisht janë dedikuar për polici, shërbim zjarrfikës, ndihmë të shpejtë urgjente, shërbim për njoftim dhe alarmim, duke e përfshirë edhe numrin unik evropian për thirrje urgjente "E-12", si dhe numrin unik evropian 116000 i cili është dedikuar për paraqitjen e fëmijëve të zhdukur;

41. Interferencë e dëmshme është interferenca e cila e rrezikon funksionimin e shërbimeve të radionavigacionit apo shërbimeve tjera për siguri apo në mënyrë serioze i degradon, pengon apo në mënyrë të vazhdueshme e ndërpret funksionimin e shërbimeve radiokomunikuese të shfrytëzuesve tjerë të cilët punojnë në pajtim me këtë ligj dhe rregulla ndërkombëtare dhe marrëveshje që i ka lidhur apo të cilat i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë;

42. Interfejs programor aplikativ (IPA) është interfejs softuerik ndërmjet aplikacioneve të cilat i ofrojnë radiodifuzerët apo dhënësit e shërbimeve dhe mjeteve të pajisjes televizive digjitale bashkëkohore për shërbime televizive digjitale dhe radio;

43. Mjete shoqëruese janë shërbimet shoqëruese, infrastruktura fizike dhe mjetet tjera apo elementet të cilat janë shoqëruar në rrjetin komunikues elektronik dhe/apo shërbimin komunikues elektronik me të cilat mundësohet dhe/apo mbështet sigurimi i shërbimeve nëpërmjet atij rrjeti dhe/apo shërbimi ose kanë potencial ta bëjnë atë dhe përfshin, ndër të tjera, ndërtesa apo qasje te ndërtesat, instalime në ndërtesa, kulla dhe konstruksione tjera shoqëruese, kanale, gypa, shtylla, shahta dhe kabinete;

44. Shërbime shoqëruese janë ato shërbime të shoqëruara me rrjetin komunikues elektronik dhe/apo shërbimin komunikues elektronik të cilët e mundësojnë dhe/apo e mbështesin dhënien e shërbimeve nëpërmjet atij rrjeti dhe/apo shërbimi apo kanë potencial ta bëjnë atë dhe përfshijnë, ndër të tjera, translacion të numrave apo sistemeve të cilët ofrojnë funksionim të barabartë, sisteme për qasje të kushtëzuar dhe udhërrëfyes programorë elektronikë, si dhe shërbime tjera, për shembull shërbime për identifikim, lokacion apo prezencë;

45. Shpërndarje e spektrit të radiofrekuencës do të thotë përcaktim i shtrirjes së caktuar të radiofrekuencës për shfrytëzimin e një apo më shumë llojeve të shërbimeve radio komunikuese dhe ku është përkatëse në kushte të caktuara;

46. Thirrje do të thotë lidhje e vendosur nëpërmjet shërbimit publik komunikues elektronik e cila lejon komunikim me zë në dy drejtime;

47. Kabinë telefonike publike është pajisje telefonike e arritshme për opinionin, shfrytëzimi i së cilës paguhet me para, kartela pagesore kreditore, kartela të paguara paraprakisht si dhe kartela me qasje të koduar;

48. Pajisje televizive digjitale bashkëkohore është pajisje e përshtatur (set-top boks), që shërben për lidhjen e aparateve televizive apo aparateve televizive digjitale të integruara të cilat mundësojnë pranim të shërbimeve televizive interaktive digjitale;

49. Komunikim nënkupton secilën informatë që shkëmbehet apo bartet ndërmjet numri të kufizuar të palëve nëpërmjet shërbimeve publike komunikuese elektronike, ndërsa nuk përfshin informata që barten si një pjesë nga emetimi i përmbajtjeve programore nëpërmjet rrjetit publik komunikues elektronik, përveç kur informata është dedikuar për parapagues apo shfrytëzues të caktuar;

50. Informatë për komunikimin e ndjekur janë të dhëna për sinjalizim të lidhur me shërbimin e ndjekur komunikues, sinjalizim për vendosje të komunikimit dhe kontrollit të rrjedhës së saj, si dhe informata tjera të cilat i ka të arritshme operatori;

51. Multipleks digjital terestrial është rrjedhë e standardizuar të një vargu të sinjaleve e cila përmban servise televizive, servise programore të radios, shërbime plotësuese dhe informata dhe të dhëna tjera shoqëruese dhe e cila deri te shfrytëzuesit e fundit emetohet nëpërmjet një kanali terestrial televiziv të radiofrekuencës;

52. Sistem terestrial digjital është rrjeti komunikues elektronik i cili përmbajtjen e multipleksit terestrial digjital e emeton te shfrytëzuesit përfundimtarë nëpërmjet radiokomunikimit terestrial;

53. Të dhëna në kuptim të dispozitave nga nenet 176, 177 dhe 178 nga ky ligj janë të dhënat për komunikacion dhe të dhënat për lokacion si dhe të dhënat e lidhura me të njëjtat të cilat janë të domosdoshme që të identifikohet parapaguesi apo shfrytëzuesi i shërbimit komunikues elektronik.

Kapitulli i dytë

KOMPETENCA PËR KOMUNIKIME ELEKTRONIKE

Neni 4

Organe kompetente

Për punët nga sfera e komunikimeve elektronike të përcaktuara me këtë ligj, kompetent janë:

- Ministria kompetente për punët nga sfera e komunikimeve elektronike dhe
- Agjencia për Komunikime Elektronike.

Neni 5

Kompetenca të Ministrisë

(1) Ministria kompetente për punët nga sfera e komunikimeve elektronike:

- e realizon politikën e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë në sferën e komunikimeve elektronike,

- jep iniciativë për miratimin e rregullave, apo ndryshimin e rregullave ekzistuese dhe/apo përpilon rregulla nga sfera e komunikimeve elektronike në bashkëpunim me Agjencinë për Komunikime Elektronike, me organe tjera shtetërore dhe me institucione tjera,

- i kryen punët në lidhje me zhvillimin e komunikimeve elektronike në drejtim të zhvillimit të shoqërisë informatike dhe

- kryen harmonizim me rregulla tjera të cilat, ndër të tjera, rregullojnë edhe çështje të lidhura me zhvillimin e komunikimeve elektronike.

(2) Ministri kompetent për komunikimet elektronike:

- përgatit dokumente strategjike në sferën e komunikimeve elektronike dhe organizimin e debateve publike mbi të njëjtat,

- e promovon zhvillimin e konkurrencës në sferën e komunikimeve elektronike dhe rritjen e qasshmërisë dhe shfrytëzimit të shërbimeve komunikuese elektronike,

- i koordinon dhe harmonizimin punët në fushën e komunikimeve elektronike,

- jep pëlqim të vendimit për shpalljen e tenderit publik për zgjedhje të dhënësit të shërbimit universal,

- bashkëpunon me ministrin e Mbrojtjes dhe ministrin e Punëve të Brendshme për çështjet që kanë të bëjnë me komunikimet elektronike që lidhen me mbrojtjen dhe sigurinë,

- e koordinon punën me ministrin e Mbrojtjes dhe ministrin e Punëve të Brendshme në lidhje me shfrytëzimin e radiofrekuencave për qëllimet e mbrojtjes dhe sigurisë, në bashkëpunim me Agjencinë për Komunikime Elektronike,

- i kryen punët e përcaktuara me këtë ligj dhe tjetër ligj dhe dispozitat e miratuara në bazë të tyre në lidhje me punën e rrjeteve komunikuese elektronike publike në kushte të gjendjes së luftës dhe gjendjes së jashtëzakonshme dhe sigurim të shërbimeve komunikuese elektronike publike në kushte të tilla dhe

- e përfaqëson Republikën e Maqedonisë në organizatat ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike dhe negocion dhe nënshkruan marrëveshjeve dypalëshe dhe ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike në emër të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë.

Neni 6

Agjencia për Komunikime Elektronike

(1) Agjencia për Komunikime Elektronike (në tekstin e mëtejshëm : Agjencia) është trup rregullator jofitimprurës i mëvetësishëm dhe i pavarur dhe ka statusin e personit juridik me autorizime publike të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Republika e Maqedonisë është themelues i Agjencisë. Kuvendi i Republikës së Maqedonisë i ka të drejtat themeluese në aspekt të pronës dhe mjeteve për punë të Agjencisë. Prona dhe mjetet për punë të Agjencisë i shfrytëzon dhe me to menaxhon Agjencia.

(3) Selia e agjencisë është në Shkup.

(4) Agjencia në punën e saj është e pavarur nga cilido organ shtetëror ose trup, përkatësisht organizatë e formuar nga organi shtetëror, si dhe nga çdo person juridik ose fizik që siguron rrjete komunikuese elektronike dhe /ose shërbime.

(5) Agjencia i kryejnë punët në pajtim me këtë ligj dhe rregullat e miratuara në bazë të tij, Ligjit për procedurë administrative të përgjithshme, nëse me këtë ligj nuk është përcaktuar ndryshe, ligje tjera dhe dokumente strategjike të Republikës së Maqedonisë, si dhe marrëveshje ndërkombëtare në fushën e komunikimeve elektronike që i ka nënshkruar ose i ka ratifikuar Republika e Maqedonisë.

(6) Organizimi dhe puna e Agjencisë rregullohet me Statutin e Agjencisë.

Neni 7

Qëllimet rregullatore dhe parimet

(1) Agjencia inkurajon konkurrencën në sigurimin e rrjeteve publike komunikuese elektronike, shërbimeve komunikuese elektronike publike dhe mjeteve shoqëruese dhe shërbimeve edhe atë sidomos në mënyrat në vijim:

- garantim se shfrytëzuesit e fundit, duke përfshirë edhe personat me invaliditet, personat e moshuar dhe personat me nevoja të veçanta fitojnë dobi maksimale për sa i përket zgjedhjes, çmimit dhe kualitetit,

- garantim se nuk ka rrezikim ose kufizim të konkurrencës në tregun për komunikime elektronike, duke përfshirë transmetimin e përmbajtjeve programore dhe

- stimulimin e shfrytëzimit efikas dhe sigurimin e menaxhimit efektiv me radiofrekuencat, numrat dhe/ose seritë e numrave.

(2) Agjencia i promovon interesat e qytetarëve, edhe atë sidomos në mënyrat në vijim:

- sigurim të qasjes në shërbimet universale për të gjithë qytetarët në pajtim me dispozitat e këtij ligji,

- sigurim të nivelit të lartë të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve në marrëdhëniet e tyre me operatorët, e veçanërisht përmes sigurimit të procedurës së thjeshtë dhe të lirë për zgjidhjen e kontesteve në përputhje me dispozitat e këtij ligji,

- kontribut në sigurimin e nivelit të lartë të mbrojtjes së të dhënave personale dhe privatësisë,

- promovim të detyrimeve për dhënien e informatave të qarta, veçanërisht në aspekt të detyrimit për transparencë të çmimeve dhe kushteve për shfrytëzimin e shërbimeve komunikuese elektronike publike,

- plotësim të nevojave të grupeve të veçanta sociale, veçanërisht personave me invaliditet, personave të moshuar dhe personave me nevoja të veçanta sociale,

- sigurim se ruhet integriteti dhe siguria e rrjeteve komunikuese elektronike publike dhe

- promovim të mundësisë që shfrytëzuesit e fundit të realizojnë qasje dhe të shpërndajnë informata ose të shfrytëzojnë aplikacione dhe shërbime sipas përzgjedhjes së tyre.

(3) Agjencia kontribuon në zhvillimin e Tregut evropian, edhe atë sidomos në mënyrat në vijim:

- mënjanim të të gjitha pengesave të mbetura në sigurimin e rrjeteve komunikuese elektronike publike dhe shërbimeve komunikuese elektronike publike dhe mjeteve shoqëruese dhe shërbimeve në nivel evropian,

- stimulimin e vendosjes dhe zhvillimit të rrjeteve trans-evropiane dhe interoperabilitetin e shërbimeve pan-evropiane, dhe lidhjen e ndërsjellë të shfrytëzuesve përfundimtarë dhe

- bashkëpunim të ndërsjellë, bashkëpunim me Komisionin e Bashkimit Evropian dhe me BEREC.

(4) Agjencia për realizimin e qëllimeve të përcaktuara në paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, detyrohet t'i zbatojë parimet rregullatore për objektivitet, transparencë, mosdiskriminim dhe proporcionalitet, edhe atë sidomos nëpërmjet:

- promovimit të parashikueshmërisë rregullatore me sigurimin e qasjes të qëndrueshme rregullatore në periudhat përkatëse të kontrollit,

- sigurimit se, në rrethana të ngjashme, nuk ka diskriminim në trajtimin e operatorëve,

- mbrojtjes së konkurrencës në favor të konsumatorëve dhe promovimit, nëse është e përshtatshme, të konkurrencës së bazuar në infrastrukturë,

- promovimit të investimeve efikase dhe inovacioneve në infrastruktura të reja dhe moderne, mes tjerash edhe me sigurimin se detyrimi për qasja në mënyrë përkatëse e merr parasysh rrezikun në të cilin ekspozohen operatorët që investojnë, me atë që lejon marrëveshje të ndryshme kooperative ndërmjet investitorëve dhe palëve të interesuara që kërkojnë qasje me qëllim që të modifikohet rreziku nga investimet, ndërsa me këtë rast duke siguruar se konkurrenca në treg dhe parimi për mosdiskriminim janë ruajtur,

- marrjes parasysh diversitetin e kushteve që kanë të bëjnë me konkurrencën dhe konsumatorët që ekzistojnë në fusha të ndryshme gjeografike në kuadër të Republikës së Maqedonisë dhe

- imponimit të detyrimeve të mëparshme rregullatore vetëm nëse nuk ka konkurrencë efektive dhe të qëndrueshme dhe tërheqje e tyre në qoftë se konstatohet ekzistim i konkurrencës efikase dhe të qëndrueshme.

Neni 8

Kompetencë e Agjencisë

Për realizimin të qëllimeve rregullatore dhe parimeve nga neni 7 i këtij ligji, Agjencia është kompetente që:

1) të kryejë mbikëqyrje dhe kontroll dhe ta përcjellë punën e operatorëve në përputhje me këtë ligj dhe rregullat e miratuara në bazë të tij;

2) të sigurojë vendosjen e interkoneksionit ose qasjes;

3) të miratojë ofertë referente për interkoneksion ose qasje në operatorët me fuqi të konsiderueshme tregu,;

4) t'i përcaktojë tregjet relevante të prodhimeve dhe shërbimeve dhe tregjet relevante gjeografike në sferën e komunikimeve elektronike në territorin e Republikës së Maqedonisë;

5) të caktojë operatorë me fuqi të konsiderueshme në treg, t'u imponojë detyrime në pajtim me këtë ligj dhe ta përcjellë plotësimin e tyre;

6) të kryejë regjistrimin e notifikimit të operatorëve;

7) të miratojë Plan për dedikim të shtrirjeve të radiofrekuencës dhe Plan për ndarjen dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave;

8) të kryejë kontroll dhe monitorim të spektrit të radiofrekuencave, si dhe analizë dhe zbulim të interferencave të dëmshme;

9) të lëshojë leje për shfrytëzimin e radiofrekuencave;

10) të kryejë koordinimin e radiofrekuencave me trupat rregullatorë të shteteve fqinje dhe shteteve tjera;

11) të miratojë Plan për numeracionin për rrjetet komunikuese elektronike dhe shërbimeve në Republikën e Maqedonisë;

12) t'u ndajë numra dhe seri të numrave operatorëve;

13) të miratojë dhe kontrollojë marrëveshje standarde parapaguese të operatorit;

14) të marrë masa në përputhje me ligjin në rastet kur është kryer shkelje e dispozitave të këtij ligji ose rregullave të miratuara në bazë të tij;

15) të udhëheq dhe menaxhon me fondin e kompensimit për shërbimin universal dhe të kryejë pagesën e mjeteve nga e njëjta;

16) të udhëheqë procedurë për zgjidhjen e kontesteve në pajtim me këtë ligj;

17) të ruajë dhe azhurnojë bazë elektronike të të dhënave në pajtim me këtë ligj;

18) të bashkëpunojë, japë mendime, propozime dhe shkëmbejë të dhëna me organet e administratës shtetërore, trupave kompetentë dhe institucioneve për punë të cilat janë lëndë e rregullimit me këtë ligj;

19) të kërkojë të dhëna dhe informata nga operatorët në pajtim me këtë ligj;

20) të sigurojë informata për shfrytëzuesit, operatorët dhe organizatat dhe trupat ndërkombëtarë;

21) të miratojë akte nënligjore të nevojshme për zbatimin e këtij ligji;

22) të japë pëlqim të projektit themelues për ndërtim të rrjetit publik komunikues elektronik dhe mjeteve shoqëruese;

23) të japë mendim gjatë procedurës për përgatitje dhe miratim të dokumenteve për rregullimin hapësinor;

24) të japë pëlqim për plotësimin e kushteve të posaçme për realizim të punëve në zonën e rrjetit komunikues elektronik dhe mjeteve shoqëruese;

25) të realizojë zbatimin e standardeve nacionale dhe ndërkombëtare dhe rregullave teknike në sferën e komunikimeve elektronike;

26) të marrë pjesë në punën e organizatave ndërkombëtare dhe shoqatave të trupave rregullatorë nacionale në fushën e komunikimeve elektronike;

27) të zbatojë procedura për përcaktimin e dhënësit të shërbimit universal dhe do të lidhë marrëveshje me të;

28) të sigurojë pikë unike për informata;

29) t'i kontrollojë dhe matë parametrat për cilësi të shërbimeve publike elektronike komunikuese;

30) e kontrollon dhe mat rrezatimin jo-jonizues të shkaktuar me përdorimin e rrjeteve publike komunikuese elektronike;

31) të ndërmarrë aktivitete për zhvillim të pikave për shkëmbim të qarkullimit të internetit;

32) të mbajë regjistra të përcaktuar me këtë ligj dhe

33) të kryejë edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 9

Statuti i Agjencisë

(1) Organizimi dhe puna e Agjencisë më afër rregullohet me Statutin e Agjencisë.

(2) Statuti i Agjencisë sidomos përmban dispozita për:

- vendin, shenjën mbrojtëse dhe selinë e Agjencisë,
- përpilimin dhe përdorimin e vulave të Agjencisë,
- përfaqësimin e Agjencisë,
- mënyrën e emërimit dhe shkarkimit të drejtorit të Agjencisë,
- mënyrën për miratimin e akteve të përgjithshme dhe nënligjore të Agjencisë,
- detyrimin për të punësuarit në lidhje me ruajtjen e fshehtësisë së të dhënave dhe
- dispozita tjera të rëndësishme për punën e Agjencisë.

(3) Statuti i Agjencisë është i kapshëm publikisht dhe publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

Neni 10

Akte tjera të Agjencisë dhe mënyra e publikimit të tyre

(1) Agjencia miraton akte të përgjithshme dhe nënligjore për punët në kompetencë të saj, Raport vjetor për punë të Agjencisë për vitin paraprak, Program vjetor për punë të Agjencisë për vitin e ardhshëm, ndërsa për punë të caktuara mund të miratojë edhe rekomandime.

(2) Agjencia vendos për punët në kompetencë të saj me miratimin e vendimeve dhe aktvendimeve.

(3) Aktet nënligjore të Agjencisë botohen në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në ueb faqen e Agjencisë.

(4) Aktet e përgjithshme, Raporti vjetor për punë të Agjencisë për vitin paraprak, Programi vjetor i punës së Agjencisë për vitin e ardhshëm, vendimet dhe aktvendimet e Agjencisë publikohen në ueb faqen e Agjencisë.

Neni 11

Raportimi për punën e Agjencisë

(1) Agjencia për punën e saj raporton para Kuvendit të Republikës së Maqedonisë me dorëzimin e Raportit për punën e vet.

(2) Raportin nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia është e detyruar ta dorëzojë në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë për shqyrtim më së voni deri 31 mars të vitit rrjedhës.

(3) Raporti nga paragrafi (1) i këtij neni, përmban:

a) Raport vjetor për punën e Agjencisë për vitin paraprak dhe

b) Program vjetor për punë të Agjencisë për vitin e ardhshëm.

(4) Raporti vjetor për punë të Agjencisë për vitin paraprak nga paragrafi (3) pika a) të këtij neni, sidomos përmban:

- Raport për zhvillimin e tregut të komunikimeve elektronike në Republikën e Maqedonisë në vitin paraprak,

- Raport për realizimin e aktiviteteve të përcaktuara në Programin vjetor të punës së Agjencisë për vitin paraprak,

- Raport financiar për zbatimin e Planit financiar për vitin paraprak dhe Llogari vjetore me të dhëna për të hyrat e realizuara, shpenzimet, kërkesat dhe detyrimet për vitin paraprak të grupuara sipas strukturës dhe sipas strukturës organizative të Agjencisë,

- Raport të revizorit nga revizori i pavarur i autorizuar, si dhe nga Enti Shtetëror për Revizion nëse ka revizion të kryer. Në shtojcë të raportit të revizorit dorëzohet edhe qëndrimi i Agjencisë në lidhje me rezultatet nga revizioni i kryer dhe

- Raport për gjendjen e mjeteve në fondin e kompensimit për shërbimin universal, që veçanërisht përmban të dhëna për pagesën e shpenzimeve neto të dhënësve të shërbimit universal.

(5) Me Programin vjetor për punë të Agjencisë për vitin e ardhshëm nga paragrafi (3) pika b) të këtij neni përcaktohen detyrat dhe qëllimet që Agjencia duhet t'i plotësojë vitin e ardhshëm, në përputhje me këtë ligj edhe ai veçanërisht duhet të përmbajë:

- Program të aktiviteteve të planifikuara për vitin e ardhshëm dhe

- Plan financiar për vitin e ardhshëm, i cili përmban të dhëna për zbatimin e aktiviteteve të planifikuara, të ardhurat e planifikuara dhe shpenzimet e Agjencisë për vitin e ardhshëm të grupuara sipas strukturës dhe sipas strukturës organizative të Agjencisë si dhe investimet kapitale të parapara të Agjencisë për vitin e ardhshëm.

(6) Raportin vjetor për punë të Agjencisë për vitin paraprak nga paragrafi (3) pika a) të këtij neni, e miraton Komisioni i Agjencisë, me propozim të drejtorit të Agjencisë më së voni deri me 10 mars të vitit rrjedhës.

(7) Raportin vjetor për punë të Agjencisë për vitin e ardhshëm nga paragrafi (3) pika b) të këtij neni, e miraton Komisioni i Agjencisë, me propozim të drejtorit të Agjencisë më së voni deri më 10 dhjetor të vitit rrjedhës.

Neni 12

Transparenca në punën e Agjencisë

(1) Agjencia është e detyruar çdo tre muaj gjatë vitit, të botojë publikisht raporte për gjendjen dhe zhvillimin e tregut të komunikimeve elektronike.

(2) Agjencia është e detyruar së paku dy herë në vit të organizojë mbledhje publike me qëllim që t'u mundësojë të gjitha palëve të interesuara që t'i shprehin mendimet dhe qëndrimet e tyre në lidhje me zhvillimin e komunikimeve elektronike në Republikën e Maqedonisë, në veçanti për:

- gjendjet në tregun e komunikimeve elektronike,

- realizimin e aktiviteteve dhe plotësimin e qëllimeve të Programit vjetor për punë të Agjencisë dhe

- të drejtat e të gjithë shfrytëzuesve të fundit, përfshirë dhe personat me invaliditet në lidhje me sigurimin e shërbimeve publike komunikuese elektronike.

(3) Qëndrimet dhe mendimet e marra nga paragrafi (2) të këtij neni, si dhe qëndrimi i Agjencisë në lidhje me të njëjtat në afat prej shtatë ditëve nga dita e mbajtjes së mbledhjes publike do të publikohen në ueb faqen e Agjencisë.

(4) Agjencia me aktin nënligjor më afërsisht i rregullon:

- mënyrën e pranimit të propozimeve nga palët e interesuara,
- të dhënat dhe informatat që Agjencia do t'i shpallë si dhe mënyrën e qasjes në të njëjtat, në pajtim me ligj dhe
- mënyrën e bashkëpunimit me përfaqësuesit të organizatave të shfrytëzuesve të shërbimeve komunikuese elektronike.

Neni 13 **Ndikimi i publikut**

(1) Agjencia para se të miratojë ose të ndryshojë akte nënligjore ose vendime nga kompetenca e vet, ndërsa të cilat ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në tregun relevant të komunikimeve elektronike, si dhe para se ta miratojë Programin vjetor të punës së Agjencisë për vitin e ardhshëm është e detyruar në ueb faqen e saj publikisht ta shpallë vendimin e propozuar ose aktin nënligjor, përkatësisht Programin vjetor të propozuar të punës së Agjencisë për vitin e ardhshëm, me qëllim të sigurojë debat publik me të cilin do t'u mundësohet të gjitha palëve të interesuara t'i shprehin mendimet e tyre, pikëpamjet dhe qëndrimet në lidhje me të njëjtat.

(2) Afati i kohëzgjatjes së debatit publik nuk guxon të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga dita e publikimit të akteve të propozuara nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Pas skadimit të afatit nga paragrafi (2) i këtij neni, ndërsa para miratimit të akteve nga paragrafi (1) të këtij neni, Agjencia do t'i publikojë në ueb faqen e saj mendimet dhe komentet e marra, si dhe qëndrimin e Agjencisë në lidhje me të njëjtat, me ç'rast informatat konfidenciale dhe të dhënat nuk publikohen.

(4) Para se t'i miratojë aktet nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia mund të mbajë edhe mbledhje publike me palët e interesuara.

Neni 14 **Organet e Agjencisë**

Organet e Agjencisë janë komisioni dhe drejtori.

Neni 15 **Përbërja dhe emërimi i anëtarëve të Komisionit**

(1) Komisioni përbëhet nga pesë anëtarë të cilët emërohen dhe shkarkohen nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë me propozim të Komisionit për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë.

(2) Komisioni nga radhët e anëtarëve të vet zgjedh dhe shkarkon kryetar dhe zëvendëskryetar të Komisionit në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara në Rregulloren e punës së Komisionit.

(3) Anëtarët e Komisionit emërohen për mandat prej pesë vjetësh.

(4) Anëtarët e Komisionit nuk mund të emërohen për më shumë se dy mandate të njëpasnjëshme.

(5) Anëtarët e Komisionit emërohen jo më vonë se 30 ditë para skadimit të mandatit të paraardhësve të tyre. Kryetari është i detyruar ta njoftojë Komisionin për zgjedhje dhe emërime të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë për skadimin e mandatit të anëtarëve të Komisionit jo më vonë se 60 ditë para skadimit të tij.

(6) Nëse procedura e emërimit nuk është përfunduar para skadimit të mandatit të Komisionit, anëtarët e Komisionit mandati i të cilëve ka skaduar do të vazhdojnë të kryejnë funksionin e tyre, por jo më gjatë se gjashtë muaj.

(7) Anëtarët e Komisionit nëse miratojnë vendim në kompetencë të vet me të cilin do t'i cenojnë interesat e Agjencisë, përgjigjen në mënyrë të pakufizuar dhe solidarë për dëmin e shkaktuar me vendimin e tillë. Nuk do të konsiderohet përgjegjës ai anëtar i Komisionit që ka sugjeruar se vendimi i propozuar është në kundërshtim me ligjin dhe e ka kundërshtuar miratimin e vendimit, në mënyrë që e ka veçuar mendimin e tij në procesverbalin e mbledhjes dhe ka votuar "kundër" vendimit.

Neni 16

Kushte për emërimin e anëtarëve të Komisionit

(1) Për anëtar të Komisionit mund të emërohet personi i cili:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive e shfrytëzon gjuhën maqedonase,
- ka fituar së paku 240 kredi SETK ose ka përfunduar shkallë VII / 1 të arsimimit nga sfera e shkencave elektroteknike, informatikës, drejtësisë apo ekonomisë,
- ka së paku pesë vjet përvojë pune përkatëse dhe njohuri të posaçme në fushën e komunikimeve elektronike,
- certifikatë të njohur ndërkombëtarisht të lëshuar nga testatori zyrtar evropian, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropianë të B2 (B2) nivelit të CEFR (CEFR) ose TOEFEL PBT (TOEFEL PBT) së paku 500 pikë, TOEFEL CBT (TOEFEL CBT) së paku 175 pikë ose TOEFEL IBT (TOEFEL IBT) së paku 60 pikë dhe

- posedon certifikatë për njohjen e programeve kompjuterike për punë në zyrë.

(2) Për anëtar të Komisionit mund të emërohet person i punësuar në person tjetër juridik, përveç në person tjetër juridik i cili mund të jetë në konflikt të interesave në përputhje me këtë ligj.

Neni 17

Papajtueshmëria e funksionit anëtar i Komisionit

(1) Gjatë kohëzgjatjes së mandatit të tij, anëtarët e Komisionit nuk mund të jenë deputetë të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, anëtarë të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë si dhe persona që kryejnë detyra në organet dhe trupat e partive politike, si dhe të jenë të punësuar në operatorë.

(2) Anëtari i Komisionit, bashkëshorti i tij/i saj apo partneri i pakurorëzuar si dhe farefisi i afërt në vijë të drejtë deri në brezin e dytë, nuk mund:

- të jenë pronarë të pjesëmarrjeve ose aksioneve në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në personat juridikë që kryejnë aktivitete që janë në kompetencë të drejtpërdrejtë të Agjencisë, si dhe në operatorët ose

- të jenë anëtarë të organit administrativ ose mbikëqyrës ose të kryejnë funksione udhëheqëse në person juridik që kryen veprimtari nga sfera që është në kompetencë të Agjencisë e përcaktuar me këtë ligj ose në person juridik i cili mund të çojë në konflikt të interesave në përputhje me këtë ligj dhe ligj tjetër.

Neni 18

Shkarkimi i parakohshëm i anëtarit të Komisionit

(1) Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, me propozim të Komisionit për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë mund të shkarkojë anëtar të Komisionit para skadimit të mandatit:

- me kërkesë të tij,
- ka ndodhur ndonjë prej pengesave për anëtarësim në Komision të parapara në nenin 17 të këtij ligji,
- nëse është gjykuar në mënyrë të plotfuqishme për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me burg në kohëzgjatje më gjatë se gjashtë muaj ose i është shqiptuar masë e sigurisë ndalim i kryerjes së profesionit, veprimtarisë apo detyrës, në kohëzgjatje më të gjatë se gjashtë muaj,
- nëse nuk ka mundësi ta kryejë detyrën më shumë se gjashtë muaj në vazhdimësi,
- nëse pa arsye ka munguar në tri mbledhje të Komisionit njëra pas tjetrës, ose gjithsej nga pesë mbledhje gjatë një viti,
- nëse konstatohet se anëtari i Komisionit në procedurë të emërimit të tij ka dhënë të dhëna të pavërteta ose ka lëshuar të paraqesë disa informata që janë të rëndësishme për emërimin e tij,
- nëse përcaktohet se gjatë kryerjes së funksionit vetë ose së bashku me anëtar tjetër të Komisionit vepron në kundërshtim me qëllimet themelore të këtij ligji dhe zbatimin konsistent të sistemit të komunikimeve elektronike, siç parashikohet me këtë ligj, dhe i cili mund të përcaktohet nga raporti i revizorit për shkallën e arritjes së kompetencave ligjore të Agjencisë ose
- për shkak të kryerjes jokompetente, joprofesionale, dhe të pandërgjegjshme të funksionit kryetar ose anëtar i Komisionit në fushën e punës materiale dhe financiare, të konstatuar në raportin e revizorit.

(2) Mosdorëzimi i Raportit për punë të Agjencisë nga neni 11 i këtij ligji të Kuvendi i Republikës së Maqedonisë është shkak për shkarkim kolektiv të Komisionit.

(3) Për plotësimin e kushteve për shkarkimin e parakohshëm të anëtarit të Komisionit, të parapara në paragrafin (1) të këtij neni, kryetari, përkatësisht zëvendëskryetari i Komisionit është i detyruar ta njoftojë Komisionin për çështje të zgjedhjeve dhe emërimeve të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë në afat prej pesë ditëve nga dita e plotësimit të kushteve nga paragrafi (1) të këtij neni.

Neni 19

Kompetenca e Komisionit

Komisioni i ka kompetencat në vijim:

- miraton Statut me pëlqim të marrë paraprak nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë,
- miraton Rregullore për punën e vet në pajtueshmëri me këtë ligj dhe Statutin e Agjencisë,
- miraton vendim për miratimin e Raportit vjetor për punë të Agjencisë për vitin paraprak,
- miraton vendim për miratimin e Raportit vjetor për punë të Agjencisë për vitin e ardhshëm,
- miraton vendim për emërim dhe shkarkim të drejtorit të Agjencisë në pajtim me këtë ligj dhe me procedurë të përcaktuar në Statutin e Agjencisë,
- e përcjellë zbatimin e programit vjetor për punë të Agjencisë përmes raporteve tremujore të dorëzuara nga drejtori i Agjencisë,
- miraton vendim për shfrytëzimin e mjeteve të përealizuara nga plani financiar i Agjencisë nga viti paraprak, me propozim të drejtorit të Agjencisë,
- miraton vendim për dhënie me qira të hapësirës afariste të lirë, që Agjencia nuk e shfrytëzon dhe për lartësinë e qirasë që do të paraqesë çmimin fillestar në procedurën e ankandit publik, me propozim të drejtorit të Agjencisë,
- jep pëlqim të propozim-vendimit të drejtorit të Agjencisë për disponim me pronën e Agjencisë, si dhe për punësimin ose ndërprerjen e marrëveshjes për punësim për të punësuarit në Agjenci,
- vendos për kundërshtime të të punësuarve të parashtruara kundër aktvendimit të drejtorit të Agjencisë të miratuar në lidhje me plotësimin e të drejtave dhe detyrimeve nga marrëdhënia e punës,

- bashkëpunon me organe tjera shtetërore dhe institucionet, organe të njëjësive të vetëqeverisjes lokale dhe me organizata joqeveritare dhe shoqata të qytetarëve në Republikën e Maqedonisë,

- jep mendime, rekomandime dhe propozime te Kuvendi i Republikës së Maqedonisë dhe organet tjera shtetërore dhe institucionet nga sfera e komunikimeve elektronike dhe

- miraton akte të përgjithshme për punën e Agjencisë të përcaktuara në Statutin e Agjencisë, ndërsa me propozim të drejtorit të Agjencisë.

Neni 20

Mënyra e punës dhe vendosjes së Komisionit

(1) Komisioni mbledhet së paku katër herë në vit.

(2) Vendimet e Komisionit miratohen me shumicën e votave nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit.

(3) Kryetari i Komisionit i cakton mbledhjet e Komisionit me propozim të shkruar të drejtorit të Agjencisë ose me propozim të shkruar të tre anëtarëve të Komisionit. Kryetari i Komisionit kryeson mbledhjet e Komisionit dhe e përfaqëson Komisionin, kurse në rast të mungesës së tij ose pengesës, detyrimet i kryen zëvendëskryetari i Komisionit.

(4) Kryetari ose zëvendëskryetari i Komisionit cakton mbledhje të Komisionit në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se pesë ditë nga dita e pranimit të kërkesës për caktimin e mbledhjes.

(5) Komisioni me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve të Komisionit e zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe zëvendëskryetarin e Komisionit. Procedura për zgjedhje dhe shkarkim të kryetarit dhe zëvendëskryetarit të Komisionit përcaktohet me Rregulloren për punë të Komisionit.

(6) Drejtori është i pranishëm dhe merr pjesë në mbledhjet e Komisionit, pa të drejtë vote.

(7) Në mbledhjet e Komisionit, pa të drejtë vote, mund të jenë të pranishëm edhe të punësuar nga shërbimi profesional i Agjencisë, me ftesë të Komisionit, e për dhënie të informatave, sqarimeve dhe arsytetimeve profesionale për çështje që janë në rend të ditës të mbledhjes, kurse në pajtim me Rregulloren për punë të Komisionit.

(8) Vendimet dhe aktet tjera të Komisionit i nënshkruan kryetari i Komisionit, kurse në rast të pengimit të tij, zëvendëskryetari i Komisionit, më së voni në afat prej tre ditësh nga dita e miratimit të tyre.

(9) Materialet për mbledhjet e Komisionit i përgatit shërbimi profesional i Agjencisë dhe të njëjtat dorëzohen te të gjithë anëtarët e Komisionit, në mënyrë dhe në afat të përcaktuar në Rregulloren për punë të Komisionit.

(10) Rendi i ditës, procesverbalet nga mbledhjet e Komisionit, vendimet e marra dhe aktet shpallen në ueb faqen e Agjencisë në afat prej shtatë ditësh nga dita e mbajtjes së mbledhjes.

(11) Nëse anëtari i Komisionit ka interes privat të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në lidhje me marrjen e vendimeve me kompetencë të Komisionit, anëtari është i detyruar për këtë ta njoftojë Komisionin. Komisioni vendos për ekzistimin e interesit të tillë dhe pjesëmarrjen e atij anëtari në vendosjen për atë çështje.

Neni 21

Kompensime të anëtarëve të Komisionit

(1) Anëtarët e Komisionit kanë të drejtë për:

- kompensim mujor në lartësi deri në katër rroga mujore mesatare në Republikën e Maqedonisë sipas të dhënave të shpallura nga Enti Shtetëror i Statistikës, në pajtim me Statutin e Agjencisë për Komunikime Elektronike dhe

- kompensim për shpenzime të rrugës për ato anëtarë të Komisionit të cilët jetojnë jashtë Shkupit kur janë të pranishëm në mbledhje të Komisionit dhe kompensim për shpenzime për rrugë, vendosje dhe mëditje për udhëtim zyrtar, në pajtim me Ligjin për rrogë dhe kompensime tjera të personave të zgjedhur dhe të emëruar në Republikën e Maqedonisë.

(2) Mjetet për kompensimin mujor dhe të shpenzimeve tjera të anëtarëve të Komisionit sigurohen nga mjetet e Agjencisë të përcaktuara me planin financiar.

Neni 22

Emërimi i drejtorit të Agjencisë

(1) Komisioni emëron drejtor të Agjencisë nëpërmjet konkursit publik.

(2) Për drejtor të Agjencisë mund të emërohet personi i cili:

- është shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive e shfrytëzon gjuhën maqedonase,
- një vit para ditës së shpalljes së konkursit publik të mos jetë i punësuar tek operatori,
- ka të fituara së paku 240 kredi sipas SETK ose të kryer shkallën VII/1 të arsimit nga sfera e shkencave elektroteknike, informatikës, drejtësisë ose ekonomisë,
- ka së paku pesë vjet përvojë përkatëse të punës në sferën e komunikimeve elektronike,
- certifikatë të pranuar ndërkombëtarisht të dhënë nga testatori evropian zyrtar, anëtar i shoqatës ALTE të testatorëve evropianë të B2 (B2) niveli i CEFR (CEFR) ose TOEFEL PBT (TOEFEL PBT) së paku 500 pikë, TOEFEL CBT (TOEFEL CBT) së paku 175 pikë ose TOEFEL IBT (TOEFEL IBT) së paku 60 pikë,
- të ketë të dhënë test psikologjik dhe test për integritet dhe
- të posedojë certifikatë për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

(3) Gjatë zgjedhjes së drejtorit të Agjencisë do të merret parasysh përvoja e tij profesionale dhe menaxhuese në sferën e komunikimeve elektronike.

(4) Komisioni është i detyruar të emërojë drejtor të Agjencisë jo më vonë se 30 ditë para skadimit të mandatit të paraardhësit të tij.

(5) Drejtori i Agjencisë është në mënyrë profesionale i angazhuar në Agjenci me orar të plotë të punës.

(6) Mandati i drejtorit të Agjencisë është pesë vjet me mundësi për edhe një mandat të njëpasnjëshëm.

(7) Nëse mandati i drejtorit të Agjencisë ka përfunduar, kurse procedura për emërim të drejtorit nuk është përfunduar, drejtori i Agjencisë vazhdon ta ushtrojë funksionin derisa nuk emërohet drejtor, por jo më gjatë se gjashtë muaj.

Neni 23

Papajtueshmëria e funksionit drejtor i Agjencisë

Drejtori i Agjencisë, bashkëshorti i tij ose partneri i pakurorëzuar, si dhe farefisi i afërm në vijë të drejtë deri në brez të dytë, nuk mund:

- të jenë pronarë të pjesëmarrjeve ose aksioneve, në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në organizata që realizojnë aktivitete që drejtpërdrejtë janë në kompetencë të Agjencisë ose
- të jenë anëtarë të organit administrativ ose mbikëqyrës ose të kryejnë funksion udhëheqës në person juridik i cili ushtron veprimtari nga sfera që është në kompetencë të Agjencisë të përcaktuar me këtë ligj ose në person juridik i cili do të mund të çojë në konflikt të interesave në pajtim me këtë ligj dhe ligj tjetër.

Neni 24

Kompetenca e drejtorit të Agjencisë

(1) Drejtori i Agjencisë menaxhon me punën e Agjencisë, është përgjegjës për punën ligjore të Agjencisë dhe i ka kompetencat në vijim:

- e përfaqëson dhe prezanton Agjencinë,
 - nënshkruan marrëveshje në emër të Agjencisë,
 - i miraton aktet nënligjore të cilat dalin nga ky ligj,
 - merr masa në pajtim me këtë ligj në rastet kur është realizuar shkelje e dispozitave të këtij ligji ose të rregullave të miratuara në bazë të tij, si dhe kushteve dhe detyrimeve nga aktvendimet e lëshuara dhe lejet,
 - miraton vendime, aktvendime dhe akte tjera për çështje nga kompetenca e Agjencisë në pajtim me këtë ligj dhe Statutin e Agjencisë,
 - i propozon Statutin, Raportin vjetor për punë të Agjencisë për vitin paraprak, Programin vjetor për punë të Agjencisë për vitin e ardhshëm, si dhe aktet tjera dhe të përgjithshme që i miraton Komisioni i Agjencisë,
 - jep autorizime në korniza të kompetencave të veta,
 - autorizon persona për kryerje të mbikëqyrjes duke pasur parasysh përfaqësimin e drejtë dhe adekuat,
 - miraton Program vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes dhe parashtrohet Raport vjetor për mbikëqyrje të zbatuar si pjesë përbërëse e Raportit vjetor për punë të Agjencisë për vitin paraprak dhe
 - kryen edhe punë të tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe Statutin e Agjencisë.
- (2) Drejtori është i detyruar Komisionit t'i dorëzojë raport tremujor për zbatimin e programit vjetor për punë të Agjencisë.

Neni 25

Shkarkimi i parakohshëm i drejtorit

(1) Drejtori i Agjencisë mund të shkarkohet para skadimit të mandatit të tij me vendim të miratuar nga Komisioni vetëm në rastet në vijim:

- me kërkesë të tij,
- nëse nuk ka mundësi ta kryejë detyrën më shumë se gjashtë muaj në vazhdimësi,
- pranim të funksionit ose punës që janë të papajtueshme me funksionin e tij të drejtorit të Agjencisë në pajtim me nenin 23 të këtij ligji,
- nëse është i gjykuar në mënyrë të plotfuqishme për vepër penale për të cilën i është shqiptuar dënim me burg në kohëzgjatje më gjatë se gjashtë muaj ose i është shqiptuar masë e sigurisë ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës, në kohëzgjatje më gjatë se gjashtë muaj,
- nëse konstatohet se në procedurën për emërimin e tij ka dhënë të dhëna të pavërteta ose ka lëshuar të paraqesë disa informata të cilat janë të rëndësishme për emërimin e tij ose
- keqpërdorim të funksionit sipas raportit të revizorit nga neni 11 i këtij ligji.

(2) Drejtori i Agjencisë kundër të cilit është në rrjedhë procedura për shkarkim, i mundësohet mbrojtja para Komisionit.

(3) Vendimi për shkarkimin e drejtorit të Agjencisë, përveç tjerash duhet t'i përmbajë shkaqet për shkarkimin e tij, detajisht të arsyetuara dhe i njëjti shpallet në ueb faqen e Agjencisë në afat prej shtatë ditësh nga dita e miratimit të tij.

(4) Nëse drejtori i Agjencisë është i shkarkuar, kurse procedura për emërim të drejtorit të Agjencisë nuk ka përfunduar, funksionin drejtor i Agjencisë do ta kryejë personi i punësuar në shërbimin profesional të Agjencisë i cili për atë qëllim do të autorizohet nga Komisioni për periudhë jo më të gjatë se tre muaj.

Neni 26

**Organizimi dhe punësimi
në Agjenci**

(1) Punët profesionale, normative-juridike, administrative, administrative-mbikëqyrëse, materiale-financiare, të kontabilitetit, informatike dhe punët tjera të Agjencisë i kryen shërbimi profesional organizimi i brendshëm i të cilit, fushëveprimi i punës dhe kushtet për punësim më afërsisht rregullohen me aktet për organizim të brendshëm dhe sistematizim të punëve dhe detyrave.

(2) Të punësuarit në shërbimin profesional nga paragrafi (1) i këtij neni kanë status të nëpunësve administrativë në pajtim me Ligjin për nëpunës administrativë.

(3) Të punësuarit në Agjenci, që kryejnë punë teknike-ndihmëse, në pajtim me Ligjin për nëpunës kanë status të personelit teknik-ndihmës, në pajtim me Ligjin për të punësuarit në sektorin publik dhe dispozitat e përgjithshme për marrëdhëniet e punës.

(4) Mënyrën e përcaktimit të rrogës bazë dhe të shtesave të rrogës për të punësuarit në Agjenci si dhe lartësinë e koeficientit të rrogës bazë, i përcakton komisioni.

Neni 27

Bashkëpunimi

(1) Agjencia në kuadër të kompetencave të veta është e detyruar të japë mendime, propozime dhe shkëmbejë të dhëna dhe informata me ministrinë kompetente për punët nga sfera e komunikimeve elektronike, trupin rregullator nga sfera e radiodifuzionit, Komisionin për mbrojtje të konkurrencës, Drejtorinë për mbrojtje të të dhënave personale, dhe trupa tjerë shtetërorë, organe të administratës shtetërore, ndërmarrje publike, njësi të vetëqeverisjes lokale, institucione publike dhe institucione nga Republika e Maqedonisë, në pajtim me këtë ligj dhe ligj tjetër.

(2) Vëllimi i shkëmbimit të të dhënave dhe informatave ndërmjet Agjencisë dhe subjekteve nga paragrafi (1) i këtij neni është i kufizuar në të dhëna informata që janë përkatëse dhe proporcionale me qëllimet për të cilat shkëmbehen, në pajtim me këtë ligj.

(3) Agjencia mund të shkëmbejë të dhëna dhe informata me të cilat disponon me subjektet nga paragrafi (1) i këtij neni, me kërkesë të tyre, me kusht që të dhënat dhe informatat që shkëmbehen të jenë në kompetencë të subjekteve dhe të shkëmbehen në kushte dhe mënyrë të përcaktuara në paragrafin (2) të këtij neni.

Neni 28

**Harmonizimi me BE, bashkëpunimi tjetër ndërkombëtar
dhe zbatimi i standardeve**

(1) Agjencia në punën e vet, për shkak të përparimit dhe zhvillimit të tregut të komunikimeve elektronike në Republikën e Maqedonisë, i merr parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian dhe të Unionit Ndërkombëtar për Telekomunikime.

(2) Agjencia në pajtim me kompetencat e veta, kurse në drejtim të zbatimit të dispozitave të këtij ligji, bashkëpunon me trupat rregullatorë nga shtete tjera dhe organizata ndërkombëtare, institucione dhe trupa dhe me to mund të lidhë marrëveshje për bashkëpunim.

(3) Agjencia mund të bashkëpunojë me trupa nacional rregullatorë të vendeve tjera kompetentë për komunikime elektronike.

Kapitulli i tretë

KOMPENSIME

Neni 29

Financimi i Agjencisë

(1) Agjencia financohet nga mjetet e realizuara nga të hyrat nga kompensimet e përcaktuara në këtë Kapitull nga ky ligj për shkak të mbulimit të shpenzimeve administrative që i ka Agjencia për zbatimin e kompetencave të veta të përcaktuara me këtë ligj.

(2) Agjencia mund të financohet edhe nga donacione, dhënie me qira të hapësirës së lirë afariste të Agjencisë, hua dhe ndihmë tjetër financiare dhe teknike.

(3) Lartësia e kompensimeve nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohen me vendim që e miraton drejtori i Agjencisë në bazë të Programit vjetor për punë të miratuar për vitin e ardhshëm në përbërje të të cilit është plani financiar i Agjencisë për vitin e ardhshëm dhe në pajtim me aktet nënligjore nga nenet 30, 31 dhe 32 të këtij ligji.

(4) Vendimin nga paragrafi (3) i këtij neni, drejtori i Agjencisë është i detyruar ta miratojë në afat prej dhjetë ditësh nga dita e miratimit të Programit vjetor për punë për vitin e ardhshëm.

(5) Dhënia me qira të hapësirës së lirë afariste të Agjencisë nga paragrafi (2) i këtij neni kryhet nëpërmjet ankandit publik në mënyrë të përcaktuar me akt nënligjor të Agjencisë. Procedura e ankandit publik zbatohet përmes komisionit të posaçëm të cilin e formon drejtori i Agjencisë nga radhët e të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë. Drejtori i Agjencisë me propozim të komisionit të posaçëm për ankand publik miraton vendim për zgjidhje të ofertuesit më të volitshëm.

(6) Revizionin e punës materiale dhe financiare të Agjencisë dhe të fondit kompensues për shërbim universal e kryen revizori i jashtëm dhe i pavarur, i zgjedhur në pajtim me Ligjin për furnizime publike, si dhe nga Enti Shtetëror për Revizion.

(7) Agjencia është e detyruar të udhëheq kontabilitet të posaçëm për mjetet në fondin kompensues për shërbim universal, pas formimit të tij, si dhe për mjetet nga puna e Agjencisë.

(8) Mjetet e përcaktuara nga plani financiar i Agjencisë nga viti paraprak, agjencia do t'i bartë në planin financiar për vitin e ardhshëm, me ç'rast mund të vendosë që ato mjete, ose pjesë të tyre, të shfrytëzohen për zhvillim të komunikimeve elektronike dhe shoqërisë informatike, si dhe për punë të tjera me rëndësi për Republikën e Maqedonisë, të përcaktuara me planin financiar të Agjencisë.

Neni 30

Kompensimi për mbikëqyrje të tregut

(1) Operatorët paguajnë kompensim vjetor për mbikëqyrjen e tregut.

(2) Kompensimi vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni, është më së shumti 0,30% nga të ardhurat e përgjithshme vjetore të operatorit të realizuara me shfrytëzimin e rrjeteve publike komunikuese dhe dhënien e shërbimeve publike komunikuese gjatë vitit paraprak kalendarik, ose pjesë më të shkurtër nga viti kur operatori ka filluar të punojë.

(3) Operatori është i detyruar më së voni deri 15 mars të vitit rrjedhës në Agjencinë të dorëzojë raport për shumën e të ardhurave të përgjithshme nga paragrafi (2) i këtij neni.

(4) Nëse operatori nuk e dorëzon raportin për shumën e të ardhurave të përgjithshme nga paragrafi (2) i këtij neni në afatin e përcaktuar nga paragrafi (3) i këtij neni, Agjencia të dhënat për të ardhurat e përgjithshme do t'i kërkoj nga Drejtoria e të Hyrave Publike e Republikës së Maqedonisë.

(5) Operatori është i detyruar më së voni deri në 15 prill të vitit rrjedhës në llogari të Agjencisë ta paguajë kompensimin vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni në bazë të raportit paraprak të dorëzuar për shumën e të ardhurave të përgjithshme nga paragrafi (3) i këtij neni ose të dhënat e marra nga paragrafi (4) i këtij neni, kurse në pajtim me vendimin nga neni 29 paragrafi (3) i këtij ligji.

(6) Nëse tek Agjencia ekziston dyshim i bazuar për vërtetësinë e të ardhurave të përgjithshme vjetore të realizuara të shënuara në raportin nga paragrafi (3) i këtij neni, ka të drejtë me shpenzim të operatorit ose dhënësit të kryejë vlerësim të të njëjtit.

(7) Nëse të ardhurat e vlerësuara të përgjithshme në mënyrë të konsiderueshme shmangen nga të ardhurat e përgjithshme të paraqitura, gjatë arkëtimit të kompensimit vjetor nga paragrafi (2) i këtij neni, Agjencia do ta ngarkojë operatorin ta paguajë dallimin e përlogaritur.

(8) Mënyrën e përlogaritjes së kompensimit vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni, që duhet të bazohet në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, e përcakton Agjencia.

Neni 31

Kompensimi për shfrytëzim të radiofrekuencave

(1) Poseduesit e lejeve për shfrytëzim të radiofrekuencave paguajnë kompensim vjetor për shfrytëzimin e radiofrekuencave.

(2) Lartësia e kompensimit vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni përcaktohet në bazë të kriterëve vijuese:

- lloji i shërbimit radikomunikues,
- shtrirja e ndarë e radiofrekuencës,
- gjerësia e kanaleve të ndara të radiofrekuencës,
- sfera e mbulimit,
- madhësia e zonës së servisit (vendbanimi/ numri i banorëve),
- lartësia efektive e antenës,
- shfrytëzim i përbashkët i radiofrekuencës së njëjtë ose
- kombinimi nga të njëjtat.

(3) Mënyra e llogaritjes së kompensimit vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni i cili duhet të bazohet në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, rregullohet me akt nënligjor të miratuar nga Agjencia. Lartësia e kompensimit vjetor përcaktohet me vendim nga neni 29 paragrafi (3) i këtij ligji.

(4) Agjencia mund ta zmadhojë kompensimin vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni, të përcaktuar në pajtim me vendimin nga neni 29 paragrafi (3) i këtij ligji, por zmadhimi i tillë, nuk mund të jetë më i lartë nga indeksi i rritjes së çmimeve në BE zonën të përcaktuar nga Banka Evropiane Qendrore për vitin paraprak.

(5) Kompensimi vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni, paguhet në llogari të Agjencisë për secilin vit vijues paraprakisht nga data e vlefshmërisë së pëlqimit për shfrytëzimin e radiofrekuencave.

(6) Poseduesit të lejes për shfrytëzimin e radiofrekuencave të cilit i është ndërprerë e drejta për shfrytëzimin e tyre në pajtim me nenet 145 dhe 146 të këtij ligji, Agjencia ia kthen pjesën nga kompensimi vjetor i paguar për shfrytëzim të radiofrekuencave për ato muaj të plotë nga viti kalendarik në të cilat nuk shfrytëzohen radiofrekuencat e ndara, e llogaritur në mënyrë që numri i muajve të ngelur shumëzohet me një të dymbëdhjetën nga kompensimi i paguar vjetor.

(7) Me përjashtim të dispozitës nga paragrafi (1) i këtij neni, poseduesit e lejeve të përkohshme për shfrytëzim të radiofrekuencave në pajtim me këtë ligj, Agjencisë i paguajnë kompensim për shfrytëzim të radiofrekuencave, në lartësi prej 10% nga kompensimi vjetor që do të ishte paguar për shfrytëzim të atyre radiofrekuencave.

(8) Kompensim vjetor për shfrytëzim të radiofrekuencave nuk paguajnë organet e administratës shtetërore, NP Radiodifuzioni i Maqedonisë për transmetim të serviseve programore radio-televizive të NP Radiotelevizioni i Maqedonisë, radioamaterët dhe shfrytëzuesit e shtrirjes qytetare (CB).

Neni 32

Kompensimi për shfrytëzim të numrave të ndarë dhe/ose serive të numrave

(1) Operatorët të cilëve Agjencia u ka ndarë numra dhe/ose seri të numrave i paguajnë kompensim vjetor Agjencisë për shfrytëzim të numrave të ndarë dhe/ose serive të numrave.

(2) Kompensimi vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni llogaritet sipas kritereve të përcaktuara në bazë të llojit, dedikimit dhe gjatësisë së numrave.

(3) Mënyra e llogaritjes së kompensimit vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni i cili duhet të bazohet në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, përcaktohet me aktin nënligjor të miratuar nga Agjencia.

(4) Lartësia e kompensimit vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni shprehet në pikë. Vlera e pikës përcaktohet me vendim nga neni 29 paragrafi (3) i këtij ligji.

(5) Agjencia mund ta zmadhojë kompensimin nga paragrafi (1) i këtij neni, të përcaktuar në pajtim me vendimin nga neni 29 paragrafi (3) i këtij ligji, por zmadhimi i tillë, nuk mund të jetë më i lartë nga indeksi i rritjes së çmimeve në BE zonën të përcaktuar nga Banka Evropiane Qendrore për vitin paraprak.

(6) Kompensimi vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni, paguhet në llogari të Agjencisë për secilin vit rrjedhës paraprakisht, duke filluar nga dita e ndarjes së numrave dhe/ose serive të numrave.

(7) Operatorit që i është ndërprerë e drejta për shfrytëzimin e numrave dhe/ose serive të numrave për shkak të bartjes së të drejtës për shfrytëzim të numrave të ndarë dhe/ose serive të numrave në pajtim me nenin 155 të këtij ligji, Agjencia ia kthen pjesën nga kompensimi i paguar vjetor për shfrytëzim të numrave dhe/ose serive të numrave për ato muaj nga viti kalendarik në të cilat nuk shfrytëzohen numrat e ndarë dhe/ose seritë e numrave, e llogaritur në mënyrë që numri i muajve të plotë të mbetur shumëzohet me një të dymbëdhjetën nga kompensimi i paguar vjetor.

(8) Me përjashtim të dispozitës nga paragrafi (1) i këtij neni, operatorët numrat e të cilëve janë bartur në operator tjetër në pajtim me nenin 116 të këtij ligji, për ato numra nuk e paguajnë kompensimin vjetor nga paragrafi (1) i këtij neni. Kompensimin vjetor e paguan operatorit të cilit i janë bartur numrat. Agjencia me këtë rast i shfrytëzon të dhënat nga baza qendrore e të dhënave për bartjen e numrave në pajtim me aktet nënligjore nga neni 116 të këtij ligji.

Neni 33

Kompensimi i njehershëm për shfrytëzim të radiofrekuencave, numrave dhe/ose serive të numrave

(1) Kur ndahen radiofrekuencat, numrat dhe/ose seritë e numrave me procedurë të tenderit publik ose tender publik me ankand publik në pajtim me këtë ligj paguhet kompensim i njehershëm për shfrytëzim të radiofrekuencave, numrave dhe/ose serive të numrave.

(2) Kompensimi i njehershëm për shfrytëzim të radiofrekuencave, numrave dhe /ose serive të numrave pas procedurës së zbatuar të tenderit publik ose tender publik me ankand publik nga paragrafi (1) i këtij neni, paguhet në llogari të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë.

(3) Lartësinë më të ulët e kompensimit të njehershëm nga paragrafi (1) i këtij neni si dhe mënyra e pagesës së tij e cila mund të kryhet në disa këste mujore ose vjetore, e përcakton Agjencia me vendim të miratuar nga drejtori i Agjencisë, me procedurë të zbatuar paraprakisht të debatit publik në pajtim me nenin 134 paragrafi (6) të këtij ligji dhe pas pëlqimit të marrë nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë,

(4) Vendimin nga paragrafi (3) i këtij neni Agjencia është e detyruar ta shpallë në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë” dhe në ueb faqen e vet.

(5) Gjatë përcaktimit të lartësisë më të ulët të kompensimit të njëhershëm nga paragrafi (3) i këtij neni, Agjencia duhet t’i ketë parasysh qëllimet rregullatore dhe parimet nga neni 7 i këtij ligji.

Kapitulli i katërt

MBIKËQYRJA

Neni 34

Kompetencë për kryerje të mbikëqyrjes

(1) Agjencia kryen mbikëqyrje mbi operatorët dhe personat tjerë juridikë dhe fizikë të cilët kryejnë aktivitete të sigurimit të komunikimeve elektronike, në pajtim me këtë ligj, rregullat e miratuara në bazë të tij, detyrimet e imponuara nga ana e saj, si dhe mbi harmonizimin me kushtet e përcaktuara për shfrytëzim të radiofrekuencave dhe për shfrytëzim të numrave dhe/ose serive të numrave.

(2) Agjencia ka të drejtë nga operatorët të kërkojë t’ia dorëzojnë të gjitha informatat e domosdoshme për shkak të kryerjes së mbikëqyrjes nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Drejtori i Agjencisë miraton Program vjetor për kryerjen e mbikëqyrjes dhe parashtron Raport vjetor për mbikëqyrje të zbatuar si pjesë përbërëse e Raportit vjetor për punë të Agjencisë për vitin paraprak.

Neni 35

Lloje të mbikëqyrjes

(1) Agjencia kryen:

- mbikëqyrje të rregullt,
- mbikëqyrje të jashtëzakonshme ose
- mbikëqyrje kontrolluese.

(2) Mbikëqyrja e rregullt kryhet në bazë të Programit vjetor për kryerje të mbikëqyrjes dhe përfshinë mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji, rregullat e miratuara në bazë të tij, detyrimet e imponuara nga ana e Agjencisë, si dhe mbi harmonizimin me kushtet e përcaktuara për shfrytëzimin e radiofrekuencave dhe për shfrytëzim të numrave dhe/ose serive të numrave.

(3) Mbikëqyrja e jashtëzakonshme kryhet në bazë të iniciativës me shkrim nga organe shtetërore, operatorë, persona fizik ose juridik, si dhe në rast të dyshimit me detyrë zyrtare të Agjencisë.

(4) Mbikëqyrja kontrolluese kryhet pas skadimit të afatit të përcaktuar në aktin individual të miratuar nga ana e drejtorit të Agjencisë me qëllim të përcaktohet nëse subjekti i mbikëqyrjes:

- ka vepruar sipas aktit në tërësi,
- pjesërisht ka vepruar sipas aktit ose
- nuk ka vepruar sipas aktit.

Neni 36

Raport për mbikëqyrje të kryer dhe dhënie të provimit profesional

(1) Mbikëqyrjen nga neni 34 i këtij ligji, e kryejnë të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë në pajtim me aktin për sistematizim të punëve dhe detyrave në shërbimin profesional të Agjencisë.

(2) Për çdo mbikëqyrje të kryer përpilohet raport me shkrim i cili dorëzohet te drejtori i Agjencisë në afat prej tre ditësh nga dita e mbikëqyrjes së kryer.

(3) Nëse me mbikëqyrjen është konstatuar cenim ose shkelje raporti me shkrim përmban dhe propozim masë në pajtim me këtë ligj dhe ligj tjetër.

(4) Personat nga paragrafi (1) i këtij neni, duhet të kenë arsim të lartë nga sfera e shkencave teknike, drejtësisë ose ekonomisë me së paku tre vjet përvojë pune në profesion.

(5) Personat nga paragrafi (1) i këtij neni, duhet të kenë dhënë provimin profesional dhe të posedojnë certifikatë për njohje të programeve kompjuterike për punë në zyrë.

(6) Provimi profesional nga paragrafi (5) i këtij neni jepet për kontroll të aftësisë profesionale të personave nga paragrafi (1) i këtij neni dhe për njohje dhe zbatim të dispozitave nga fushëveprimi i komunikimeve elektronike, procedura e përgjithshme administrative, procedura kundërvajtëse, mbrojtja e të dhënave personale, si dhe rregullat nga sfera e mediave.

(7) Provimi profesional nga paragrafi (5) i këtij neni e zbaton Komisioni i formuar nga drejtori i Agjencisë në përbërje prej pesë anëtarësh, nga të cilët tre anëtarë janë nga radhët e shërbimit profesional të Agjencisë, kurse dy anëtarë nga sektori i arsimit të lartë. Mënyrën e zbatimit të dhënies së provimit profesional me akt e përcakton Agjencia.

Neni 37

Kryerja e mbikëqyrjes tek subjekti i mbikëqyrjes

(1) Në rast kur mbikëqyrja nga neni 34 i këtij ligji kryhet tek subjekti i mbikëqyrjes, të njëjtin e kryejnë persona të punësuar në shërbimin profesional të Agjencisë, të cilët për atë janë të autorizuar nga drejtori i Agjencisë (në tekst të mëtejme: person i autorizuar).

(2) Agjencia personit të autorizuar i jep legjitimacion zyrtar i cili i shërben për dëshmimin e cilësisë së tij zyrtare dhe të cilin është i detyruar ta tregojë gjatë kryerjes së mbikëqyrjes.

(3) Forma dhe përmbajtja e legjitimacionit zyrtar nga paragrafi (2) i këtij neni dhe mënyra e dhënies dhe heqjes përcaktohet me akt nënligjor.

(4) Në rast kur kryhet mbikëqyrje e rregullt tek subjekti i mbikëqyrjes, Agjencia është e detyruar me shkrim për atë, ta njoftoj subjektin e mbikëqyrjes së paku një ditë para fillimit të mbikëqyrjes. Në njoftimin me shkrim Agjencia është e detyruar të japë arsyetim për shkaqet për kryerje të mbikëqyrjes.

(5) Dispozitat nga paragrafi (4) i këtij neni nuk zbatohen në raste kur me njoftimin do të zvogëlohej efikasiteti i mbikëqyrjes, kur bëhet fjalë për mbrojtje të interesit publik, kërcënim serioz për sigurinë publike, sigurinë ose shëndetin e njerëzve, ose në rast kur kryhet mbikëqyrje e jashtëzakonshme profesionale.

Neni 38

Të drejta të personit të autorizuar

Gjatë kryerjes së mbikëqyrjes personi i autorizuar ka të drejtë që:

- të kërkojë dorëzim të të dhënave dhe informatave në pajtim me nenin 55 nga ky ligj dhe të njëjtat t'i kontrollojë, si dhe të kërkojë nga subjekti i mbikëqyrjes ose të punësuarit e vet të autorizuar të përgatitin kopje të nevojshme dhe dokumente të cilat janë përpiluar në gjuhë të huaj që të përkthehen në gjuhën maqedonase dhe alfabetin e saj cirilik dhe të verifikohen nga përkthyesi i autorizuar gjyqësor,

- të kryejë mbikëqyrje në hapësira afariste dhe objekte tjera që nuk shfrytëzohen si vendbanime,

- të kontrollojë dokumente identifikimi të personave për shkak të vërtetimit të identitetit të tyre në pajtim me ligjin,

- të kërkojë nga subjekti i mbikëqyrjes ose nga të punësuarit e tij sqarim me shkrim ose me gojë në lidhje me çështjet nga fushëveprimi i mbikëqyrjes,
- të sigurojë incizime akustike dhe video të cilat mund të shfrytëzohen gjatë mbikëqyrjes,
- të kryejë vulosje të hapësirave dhe/ose mjeteve komunikuese ose pajisjes, në pajtim me nenin 47 të këtij ligji dhe
- t'i marrë përkohësisht mjetet e komunikimit ose pajisjet, në pajtim me nenin 47 të këtij ligji.

Neni 39

Njoftimi i organit kompetent

Nëse gjatë kryerjes së mbikëqyrjes, personi i autorizuar konstaton parregullsi për mënjanimin e të cilave nuk është kompetent Agjencia, të njëjtën me procesverbal e konstaton, kurse Agjencia e njofton organin kompetent.

Neni 40

Detyrimi i subjektit të mbikëqyrjes në procedurë të mbikëqyrjes

(1) Subjekti i mbikëqyrjes është i detyruar që personit të autorizuar që kryen mbikëqyrje t'i mundësojë kryerje pa pengesë të mbikëqyrjes dhe t'ia japë të gjitha informatat dhe të dhënat të nevojshme për kryerjen e mbikëqyrjes.

(2) Subjekti i mbikëqyrjes është i detyruar që personit të autorizuar që kryen mbikëqyrje t'ia sigurojë kushtet të domosdoshme për punë pa pengesa dhe përcaktim të gjendjes faktike.

(3) Subjekti i mbikëqyrjes është i detyruar që personit të autorizuar që kryen mbikëqyrje t'i mundësojë në afatin e caktuar të përcaktuar nga personi i autorizuar qasje tek hapësirat dhe dokumentet që janë lëndë e mbikëqyrjes.

Neni 41

Të drejta të subjektit të mbikëqyrjes në procedurë të mbikëqyrjes

(1) Subjekti i mbikëqyrjes ka të drejtë të japë deklarata në procesverbal dhe vërejtje në lidhje me procedurën e mbikëqyrjes, përkatësisht të personit të autorizuar që e kryen mbikëqyrjen ose saktësinë e gjendjes së përcaktuar faktike, me arsyetim për shkaqet për atë.

(2) Subjekti i mbikëqyrjes ka të drejtë të refuzojë ta nënshkruaj procesverbalin, nëse nuk pajtohet me faktet të cilat janë të theksuara në procesverbal ose nëse i është pamundësuar e drejta nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Refuzimi që të nënshkruhet procesverbali nuk e pengon udhëheqjen e mëtejme të procedurës së mbikëqyrjes.

Neni 42

Detyrime për personat tjerë

(1) Personi i cili nuk është subjekt i mbikëqyrjes në procedurën e kryerjes së mbikëqyrjes është i detyruar të mundësojë kryerje të mbikëqyrjes kur ekziston dyshim i bazuar se në hapësirat e veta dhe objektet kryhet veprimtari ose gjenden sende të cilat janë në lidhje me mbikëqyrjen.

(2) Nëse personi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk lejon kryerje të mbikëqyrjes, ndaj tij do të zbatohen autorizimet të cilat personi i autorizuar që e kryen mbikëqyrjen i ka si ndaj subjektit të mbikëqyrjes.

Neni 43

Kryerja e mbikëqyrjes pa praninë e subjekteve të mbikëqyrjes

(1) Nëse personi i autorizuar që e kryen mbikëqyrjen në ditën në të cilën e ka paralajmëruar mbikëqyrjen, nuk e has personin përgjegjës tek subjekti i mbikëqyrjes ose personin fizik tek i cili është e nevojshme të kryhet mbikëqyrje, personi i autorizuar në vendin e mbikëqyrjes do t'i lë ftesë me shkrim që në kohë të caktuar të jetë i pranishëm për shkak të kryerjes së mbikëqyrjes.

(2) Dëmtimi i mëvonshëm, asgjësimi ose mënjanimi i ftesës me shkrim nuk ndikon në rregullshmërinë e dorëzimit.

(3) Nëse personi nga paragrafi (1) i këtij neni nuk paraqitet pas ftesës me shkrim, personi i autorizuar do ta realizojë mbikëqyrjen në prani të presonit tjetër të punësuar tek subjekti i mbikëqyrjes.

Neni 44

Pengimi i personit të autorizuar që kryen mbikëqyrje

(1) Personi i autorizuar që e kryen mbikëqyrjen ka të drejtë që ta paralajmërojë ose ta largojë personin i cili e pengon kryerjen e mbikëqyrjes.

(2) Nëse personi i autorizuar që e kryen mbikëqyrjen vlerëson se mbikëqyrja nuk mund të realizohet as me marrjen e masave nga paragrafi (1) i këtij neni, do të kërkojë asistencë nga organi i administratës shtetërore në kushte dhe në procedurë të përcaktuar me ligj.

Neni 45

Procesverbal

(1) Për mbikëqyrjen e kryer, personi i autorizuar që e kryen mbikëqyrjen përpilon procesverbal në vendin e kryerjes së mbikëqyrjes.

(2) Personi i autorizuar që e kryen mbikëqyrjen dhe subjekti i mbikëqyrjes e nënshkruajnë procesverbalin pas përfundimit të mbikëqyrjes. Subjektit të mbikëqyrjes i dorëzohet ekzemplar i procesverbalit.

(3) Nëse subjekti i mbikëqyrjes refuzon ta nënshkruajë procesverbalin, personi i autorizuar që e kryen mbikëqyrjen do t'i theksojë shkaqet për refuzimin.

(4) Procesverbali duhet të përmbajë pasqyrë të gjendjes faktike të përcaktuar gjatë mbikëqyrjes së realizuar, si dhe vërejtje të konstatuara, deklarata dhe fakte tjera relevante dhe rrethana.

(5) Formularin e formës dhe elementet e detyrueshme të procesverbalit nga mbikëqyrja e realizuar i përcakton Agjencia.

(6) Personi i autorizuar që e kryen mbikëqyrjen është i detyruar më së voni në afat prej tre ditësh nga dita e mbikëqyrjes së kryer, procesverbalin nga mbikëqyrja e kryer dhe raportin me shkrim nga neni 36 i këtij ligji, t'i dorëzojë te drejtori i Agjencisë.

Neni 46

Mbikëqyrja tek subjekte të panjohura

(1) Në rastet kur personi i autorizuar që e kryen mbikëqyrjen nuk mund të përcaktojë se cili është subjekti i mbikëqyrjes në procedurë, personi i autorizuar në vendin e mbikëqyrjes do të lë ftesë me shkrim për subjekt të panjohur të mbikëqyrjes që në ditë të caktuar dhe orë të jetë i pranishëm në kryerjen e mbikëqyrjes.

(2) Nëse subjekti i panjohur i mbikëqyrjes nuk paraqitet pas ftesës nga paragrafi (1) i këtij neni mbikëqyrja do të realizohet pa prani të subjektit të mbikëqyrjes në prani të personit tjetër të punësuar tek subjekti i mbikëqyrjes.

Neni 47

**Vulosja dhe marrja e përkohshme
e sendeve**

(1) Kur personi i autorizuar që e kryen mbikëqyrjen konstaton se subjekti i mbikëqyrjes bën interferencë të dëmshme në punën dhe shfrytëzimin e rrjeteve tjera komunikuese dhe mjeteve ose nuk ka vepruar sipas masave të shqiptuara nga ana e Agjencisë në pajtim me këtë ligj edhe atë: ndalim për sigurim të rrjeteve elektronike komunikuese dhe/ose shërbimeve, ndalim për shfrytëzim të radiofrekuencave, numrave dhe/ose serive të numrave, si dhe masë të përkohshme ndalim për sigurim të ndonjë shërbimi ose pakos së shërbimeve, do të kryejë vulosje të hapësirave në të cilat janë vendosur mjetet e komunikimit dhe pajisja ose mjetet e komunikimit dhe pajisja me punën e të cilave është bërë shkelje e dispozitave të këtij ligji.

(2) Vulosja nga paragrafi (1) i këtij neni, shënohet me vulë, përmbajtjen dhe formën e së cilës e përcakton Agjencia.

(3) Me kërkesë me shkrim të subjektit të mbikëqyrjes të cilit i është kryer vulosja, personi i autorizuar në afat prej pesë ditëve nga dita e pranimit të kërkesës, nëse konstaton se janë mënjanuar parregullsitë dhe mangësitë për shkak të të cilave është bërë vulosja nga paragrafi (1) i këtij neni, do të kryejë vulosje të hapësirave në të cilat janë vendosur mjetet e komunikimit dhe pajisja ose të mjeteve të komunikimit dhe pajisjes.

(4) Personi i autorizuar që e kryen mbikëqyrjen ka të drejtë përkohësisht t'i marrë mjetet e komunikimit ose pajisjen me punën e të cilave është bërë shkelje e dispozitave të këtij ligji, për çka subjektit të mbikëqyrjes i jep vërtetim për pajisjen e marrë.

(5) Vërtetimi nga paragrafi (4) i këtij neni përmban të dhëna për emrin dhe mbiemrin, përkatësisht titullin e subjektit të mbikëqyrjes, kohën dhe vendin e marrjes së pajisjes, bazën juridike për marrjen e pajisjes, shënimin e saktë të pajisjes së marrë sipas llojit dhe sasisë, nënshkrim nga personi përgjegjës të subjektit të mbikëqyrjes dhe të dhëna tjera të nevojshme për identifikim të pajisjes së marrë dhe emrin dhe mbiemrin e personit të autorizuar.

(6) Pajisjen përkohësisht të marrë, me kërkesë përkatëse për ngritjen e procedurës kundërvajtëse, Agjencia i dorëzon te organi kompetent kundërvajtës.

(7) Agjencia është e detyruar të sigurojë kushte për ruajtje të pajisjes përkohësisht të marrë deri në dorëzimin e saj në organin kompetent kundërvajtës.

Neni 48

Masa në rast të shkeljes së rregullave

(1) Nëse Agjencia gjatë kryerjes së mbikëqyrjes përcakton se operatori gjatë punës së vet nuk është harmonizuar me një ose më shumë nga kushtet e përcaktuara me këtë ligj, rregullat e miratuara në bazë të tij, detyrimet e imponuara nga ana e Agjencisë, si dhe me kushtet e përcaktuara për shfrytëzim të radiofrekuencave dhe për shfrytëzim të numrave dhe/ose serive të numrave, ajo për këtë me shkrim do ta njoftojë operatorin dhe do t'i japë afat jo më të shkurtër se 30 ditë nga dita e pranimit të njoftimit me shkrim që ta mënjanojë mosharmonizimin e përcaktuar.

(2) Nëse operatori nuk e mënjanon mosharmonizimin e përcaktuar në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni, Agjencia do të ngrejë procedurë kundërvajtëse, kurse në rast kur bëhet fjalë për mosharmonizim me detyrimet për qasje të imponuara nga ana e Agjencisë pas analizës së bërë të tregut relevant që shkakton dëm të rëndësishëm në zhvillimin e konkurrencës, Agjencia me aktvendim do ta urdhërojë operatorin që në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit ta ndërpresë sigurimin e ndonjë shërbimi ose pakoje të shërbimeve derisa të sigurohet harmonizim me detyrimet e imponuara nga Agjencia.

(3) Në rast kur bëhet fjalë për mosharmonizim që ka të bëjë me mosdorëzimin e informatave në pajtim me nenin 55 të këtij ligji ose mosharmonizim me detyrimin për transparencë në pajtim me nenin 84 të këtij ligji, Agjencia kundër operatorit do të ngrejë procedurë kundërvajtëse pa i zbatuar me këtë rast dispozitat nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Në rast kur bëhet fjalë për mosharmonizime serioze ose të përsëritura, kurse masat që Agjencia i ka marrë në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni nuk i kanë dhënë rezultatet e pritura, drejtori i Agjencisë mund të miratojë aktvendim me të cilin operatorit do t'ia ndalojë sigurimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve komunikimeve elektronike, do t'ia revokojë të drejtën e shfrytëzimit të radiofrekuencave, si dhe të drejtën e shfrytëzimit të numrave dhe/ose serive të numrave.

(5) Pa marrë parasysh dispozitat nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni, në rast kur Agjencia ka dëshmi se ekziston mosharmonizim që paraqet kërcënim urgjent dhe serioz për sigurinë publike, sigurinë ose shëndetin e njerëzve, ose do t'u krijojë probleme serioze ekonomike ose probleme operative operatorëve tjerë ose shfrytëzuesve tjerë të radiofrekuencave, drejtori i Agjencisë do të miratojë aktvendim me të cilin operatorit do t'i shqiptojë masë urgjente të përkohshme ndalim për sigurim të ndonjë shërbimi ose pakoje të shërbimeve me qëllim që të mënjanohet mosharmonizimi. Afati për të cilin është shqiptuar masa e përkohshme nuk mund të jetë më i gjatë se tre muaj.

(6) Drejtori i Agjencisë pas miratimit të aktvendimit nga paragrafi (5) i këtij neni do t'i mundësojë operatorit në afat i cili nuk mund të jetë më i gjatë se 15 ditë nga dita e pranimit të aktvendimit ta paraqesë qëndrimin e vet në lidhje me mosharmonizimin e përcaktuar dhe të propozojë masa preventive për mënjanimin e tij.

(7) Nëse në afatin për të cilin është shqiptuar masa e përkohshme nga paragrafi (5) i këtij neni, operatori nuk e mënjanon mosharmonizimin e përcaktuar, Agjencia mund afatin për të cilin është shqiptuar masa e përkohshme ta vazhdojë për periudhë e cila nuk mund të jetë më e gjatë se tre muaj.

(8) Nëse operatori e mënjanon mosharmonizimin e përcaktuar, Agjencia në afat prej tre ditësh nga dita e skadimit të afatit për të cilin është shqiptuar masa e përkohshme do të miratojë aktvendim me të cilin do ta shfuqizojë masën e shqiptuar të përkohshme.

Neni 49

E drejta e mbrojtjes gjyqësore

(1) Aktvendimi i drejtorit të Agjencisë i miratuar në rast të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, rregullave të miratuara në bazë të tij, detyrimeve të imponuara nga ana e Agjencisë, si dhe të harmonizimit me kushtet e përcaktuara për shfrytëzim të radiofrekuencave dhe për shfrytëzim të numrave dhe serive të numrave, është përfundimtar.

(2) Kundër aktvendimit të drejtorit të Agjencisë pala e pakënaqur ka të drejtë të padisë për ngritjen e kontestit administrativ para gjykatës administrative.

(3) Padia për ngritje të kontestit administrativ parashtrohet në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit.

Kapitulli i pestë

ORGANI KUNDËRVAJTËS

Neni 50

Kompetencë për kundërvajtje

(1) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 180 dhe 181 të këtij ligji, organ kundërvajtës kompetent është gjykata kompetente.

(2) Për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 182, 183, 184 dhe 185 të këtij ligji, organ kundërvajtës kompetent është Agjencia.

(3) Procedurën kundërvajtëse para Agjencisë e udhëheq dhe sanksion kundërvajtës shqipton Komisioni për vendosje për kundërvajtje, i formuar me aktvendim të miratuar nga drejtori i Agjencisë.

(4) Komisioni për vendosje për kundërvajtje përbëhet prej tre anëtarësh nga radhët e të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë. Anëtarët e komisionit duhet të kenë arsim të lartë nga shkencat juridike dhe përvojë pune prej së paku tre vjet në sferën, nga të cilët një është jurist i diplomuar me provim të dhënë të jurisprudencës i cili është kryetar i Komisionit.

(5) Mandati i anëtarëve të Komisionit për vendosje për kundërvajtje është me kohëzgjatje prej tre vjetësh me të drejtë rizgjedhjeje.

(6) Krahas anëtarëve të Komisionit për vendosje për kundërvajtje, drejtori i Agjencisë mund të caktojë sekretar të Komisionit i cili kryen punë administrative për Komisionin dhe zëvendësanëtarë, të cilët me përjashtim, marrin pjesë në punën e Komisionit në rast të mungesës së ndonjë prej anëtarëve.

(7) Mënyra e punës së Komisionit për vendosje për kundërvajtje, mbajtja e evidencës së kundërvajtjeve, sanksionet e shqiptuara dhe vendimet e marra, si dhe mënyra e qasjes tek informatat të cilat janë të përmbajtura në evidencë, rregullohet me Rregullore për punë të Komisionit për vendosje për kundërvajtje që e miraton drejtori i Agjencisë.

(8) Kundër aktvendimeve të Komisionit për vendosje për kundërvajtje me të cilin shqiptohet sanksion kundërvajtës mund të ngrihet kontest administrativ.

(9) Anëtari i Komisionit për vendosje për kundërvajtje mund të shkarkohet:

1) me kalimin e kohës për të cilën është emëruar;

2) me kërkesë të tij;

3) me plotësimin e kushteve për pension të pleqërisë në pajtim me ligjin;

4) nëse gjykohet me aktgjykim të plotfuqishëm gjyqësor për vepër penale me dënim me burg pa kusht prej së paku gjashtë muaj;

5) nëse i konstatohet pa aftësi e përhershme;

6) nëse konstatohet shkelje e rregullave për udhëheqjen e procedurës kundërvajtëse me vendim të plotfuqishëm;

7) nëse nuk i plotëson detyrimet që dalin nga puna në Komisionin për vendosje për kundërvajtje ose

8) nëse nuk ka paraqitur ekzistim të konfliktit të interesave për rast për të cilin vendos Komisioni për vendosje për kundërvajtje.

(10) Propozim për shkarkim të anëtarit të Komisionit për vendosje për kundërvajtje për rastet nga paragrafi (9) pikat prej 3 deri në 8 të këtij neni parashtron kryetari i Komisionit te drejtori i Agjencisë.

(11) Komisioni për vendosje për kundërvajtje ka të drejtë të nxjerrë dëshmi dhe të grumbullojë të dhëna që janë të domosdoshme për përcaktimin e kundërvajtjes, si dhe të kryejë punë të tjera dhe të marrë veprime të përcaktuara me këtë ligj, Ligjin për kundërvajtje dhe/ose me ligj tjetër.

(12) Anëtarët e komisionit për vendosje për kundërvajtje janë të mëvetësishëm dhe të pavarur në punën e Komisionit dhe vendosin në bazë të njohurisë së vet profesionale dhe bindjes së mëvetësishme.

(13) Komisioni për vendosje për kundërvajtje punon në këshill, kurse vendos me shumicë votash nga numri i përgjithshëm i anëtarëve.

(14) Komisioni për vendosje për kundërvajtje udhëheq evidencë unike të kundërvajtjeve, sanksioneve të shqiptuara dhe vendimeve të marra në mënyrë të përcaktuar në Rregulloren për punë të Komisionit për vendosje për kundërvajtje.

(15) Evidenca nga paragrafi (14) i këtij neni i përmban këto të dhëna personale: emrin dhe mbiemrin, numrin unik të amzës të qytetarit (NUAQ), vendin dhe datën e lindjes, vendin e jetesës, rrugën dhe numrin, adresën e qëndrimit të përkohshëm, profesionin, shtetësinë, nëse personi fizik është i huaj, atëherë në vend të NUAQ numrin e dokumentit të udhëtimit, kurse për person përgjegjës në personin juridik edhe funksionin që e kryen në atë person juridik. Afati i ruajtjes së të dhënave personale është pesë vjet nga dita e plotfuqishmërisë së vendimit për sanksionin e shqiptuar.

Neni 51 **Barazimi**

Para parashtrimit të kërkesës për procedurë për kundërvajtje, për kundërvajtjet e përcaktuara në nenet 182, 183, 184 dhe 185 të këtij ligji, realizohet procedurë për barazim në pajtim me Ligjin për kundërvajtje.

Neni 52 **Parashkrimi**

(1) Procedura për kundërvajtje nuk mund të ngrihet as të mbahet nëse kalojnë tri vite nga dita kur është kryer shkelja e ndonjë të drejte të garantuar me këtë ligj.

(2) Parashkrimi i ndjekjes për kundërvajtje fillon nga dita kur është kuptuar për shkeljen e ndonjë të drejte të garantuar me këtë ligj.

(3) Parashkrimi nuk rrjedhë gjatë kohës për të cilën sipas ligjit ndjekja nuk mund të fillojë ose të vazhdojë.

(4) Parashkrimi ndërpritet me çdo veprim mesatar që ndërmerret për shkak të ndjekjes së kryerësit të shkeljes. Parashkrimi ndërpritet edhe kur kryerësi në kohën derisa rrjedh afati i parashkrimit kryen gjithashtu kundërvajtje të rëndë ose më të rëndë. Pas secilës ndërprerje parashkrimi fillon përsëri të rrjedh.

(5) Parashkrimi i ndjekjes për kundërvajtje ndodh në çdo rast kur do të kalojë dy herë aq kohë sa, sipas ligjit, kërkohet për parashkrim të ndjekjes për kundërvajtje.

Kapitulli i gjashtë

ZGJIDHJA E KONTESTEVE

Neni 53 **Procedura për zgjidhje të kontesteve**

(1) Agjencia mban procedurë për zgjedhje të kontesteve ndërmjet:

- operatorëve në pajtim me dispozitat e këtij ligji, rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji dhe obligimet e imponuara nga ana e Agjencisë,

- operatorëve dhe personave juridikë të cilët menaxhojnë me infrastrukturë fizike, në pajtim me këtë ligj dhe

- shfrytëzuesve përfundimtarë dhe operatorëve në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(2) Në rastet nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia fillon procedurë për zgjidhje të kontestit me kërkesë të njëjës prej palëve në kontest.

(3) Pas pranimit të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni, Agjencia para se ta fillojë procedurën për zgjidhje të kontestit është e detyruar në kontest t'ua propozojë procedurën për ndërmjetësim të përcaktuar në nenin 54 të këtij ligji.

(4) Nëse cilado prej palëve në kontest nuk e pranon procedurën për ndërmjetësim nga paragrafi (3) të këtij neni, ose nëse në procedurën për ndërmjetësim nuk ndodh lidhja e marrëveshjes ndërmjet palëve në kontest, Agjencia me kërkesë të njëjës prej palëve në kontest ose me detyrë zyrtare nëse bëhet fjalë për kontest për obligimet nga neni 73 i këtij ligji, do ta zgjidhë kontestin.

(5) Në procedurën për zgjidhje të kontesteve, Agjencia i aplikon dispozitat nga Ligji për procedurë të përgjithshme administrative, nëse me këtë ligj nuk është rregulluar ndryshe.

(6) Nëse cila do prej palëve në procedurën për zgjidhje të kontestit para Agjencisë, për të njëjtin kontest fillon procedurë gjyqësore, procedura për zgjidhje të kontestit para Agjencisë ndërpritet.

(7) Agjencia është e detyruar ta zgjidhë kontestin në afatin më të shkurtër të mundshëm kohor, kurse më së voni në afat prej katër muaj nga dita e fillimit të procedurës për zgjidhje të kontestit, përveç në rrethana të jashtëzakonshme kur i njëjti mund të vazhdohet.

(8) Agjencia është e detyruar gjatë zgjidhjes së kontesteve t'i merr parasysh edhe qëllimet e parimeve rregullatore të nenit 7 të këtij ligji. Në procedurën për zgjidhje të kontestit palët janë të detyruara në tërësi të bashkëpunojnë me Agjencinë. Operatorët, në pajtim me nenin 55 të këtij ligji në lidhje me procedurën për zgjidhje të kontestit janë të detyruar që Agjencisë, t'ia parashirojnë të gjitha informatat e grumbulluara me të cilat menaxhojnë.

(9) Agjencia është e detyruar publikisht t'i publikojë vendimet në lidhje me kontestet me ç'rast duhet ta ketë parasysh mbrojtjen e të dhënave personale dhe ndalimin për publikimin e sekreteve afariste të palëve.

Neni 54 **Ndërmjetësimi**

(1) Agjencia palëve në kontest u propozon procedurë të ndërmjetësimit me qëllim që të njëjtët ndërmjet veti të merren vesh me lidhjen e marrëveshjes.

(2) Agjencia është e detyruar në afat prej tetë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës për zgjidhjen e kontestit palëve në kontest t'u dorëzojë propozim me shkrim për zbatimin e procedurës për ndërmjetësim.

(3) Procedura për ndërmjetësim do të zbatohet nëse palët në kontest në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të propozimit me shkrim nga paragrafi (2) të këtij neni me shkrim do ta njoftojnë Agjencinë se pajtohen të zbatohet procedurë për ndërmjetësim.

(4) Në procedurën për ndërmjetësim, Agjencia ka rol të ndërmjetësuesit dhe e mban procedurën e ndërmjetësimit duke i zbatuar parimet e paanshmërisë, barazisë dhe drejtësisë dhe me këtë rast duke mbajtur llogari për plotësimin e qëllimeve dhe parimeve rregullatore nga neni 7 i këtij ligji.

(5) Gjatë zbatimit të procedurës së ndërmjetësimit të gjitha palët që janë pjesëmarrës në procedurë janë të detyruara ta respektojnë parimin e besueshmërisë.

(6) Mënyrën e zbatimit të ndërmjetësimit do ta përcaktojë Agjencia.

Kapitulli i shtatë

DORËZIMI, EVIDENCA, RUAJTJA DHE PUBLIKIMI I TË DHËNAVE DHE INFORMATAVE

Neni 55 **Dorëzimi i të dhënave dhe informatave**

(1) Operatorët janë të detyruar Agjencisë t'i dorëzojnë të dhëna dhe informata, duke përfshirë edhe dokumente dhe informata financiare, e të cilat Agjencia do t'i shfrytëzojë për kryerjen e kompetencave të përcaktuara me këtë ligj, kurse në veçanti për:

a) kontroll sistematik ose individual të harmonizimit me:
- obligimin për pagim të mjeteve në fondin për shërbime universal,
- obligimin për pagim të kompensimeve ndaj Agjencisë,
- obligimin për shfrytëzim efikas dhe efektiv të radiofrekuencave, numrave dhe/ose serive të numrave dhe

- obligimet e imponuara nga ana e Agjencisë në pajtim me këtë ligj dhe rregullat e miratuara në bazë të tij;

b) harmonizim individual me dispozitat e këtij ligji dhe rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji dhe aktet individuale të Agjencisë në rast kur:

- është parashtruar ankesë,

- Agjencia ka njohuri se janë kryer shkelje të dispozitave të këtij ligji, rregullave të miratuara në bazë të tij, obligimeve të imponuara ose kushteve për shfrytëzimin e radiofrekuencave ose kushteve për shfrytëzimin e numrave dhe/ose serive të numrave ose

- Agjencia sipas detyrës zyrtare zbaton procedurë për përcaktimin e harmonizimit të punës së operatorëve me dispozitat e këtij ligji, rregullat e miratuara në bazë të tij, obligimet e imponuara ose kushtet për shfrytëzimin e radiofrekuencave ose kushtet për shfrytëzimin e numrave dhe serive të numrave;

v) procedurën për vlerësimin e kërkesës për ndarjen e së drejtës për shfrytëzimin e resurseve të kufizuara në pajtim me këtë ligj;

g) publikimin e raporteve ose pasqyrave komparative për kualitetin dhe çmimin e shërbimeve të cilat janë të dobishme për konsumatorët;

d) qëllime statistikore qartësisht të përcaktuara;

gj) analizë të tregut;

e) mbrojtje të përdorimit efikas dhe sigurimit efikas të menaxhimit me radiofrekuencat;

zh) evaulim të zhvillimit të rrjeteve të ardhshme ose shërbimeve të cilat mund të ndikojnë në shërbimet e shitjes me shumicë që i janë të arritshme konkurrencës dhe

z) të dhënat e kontabilitetit për tregjet për shitje me pakicë të cilat janë të lidhura me tregjet për shitje me shumicë.

(2) Të dhënat dhe informatat nga paragrafi (1) pikat a), b), g), d), gj), e), zh) dhe z) të këtij neni Agjencia nuk guxon t'i kërkojë para ose si kusht për fillimin me sigurimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve komunikuese publike elektronike.

(3) Informatat të cilat i kërkon Agjencia duhet të jenë proporcionale dhe objektive me qëllimin për të cilat do të përdoren.

(4) Operatorët janë të detyruar me kërkesë me shkrim Agjencisë t'ia dorëzojnë informatat nga paragrafi (1) të këtij neni, në nivel të detajuar dhe në afat që nuk mund të jetë më i shkurtër se 15 ditë nga dita e pranimit të kërkesës, pa kompensim. Agjencia është e detyruar t'i theksojë arsyet për shfrytëzimin e informatave të kërkuara.

(5) Agjencia mund të dhënat e besueshme dhe informatat të cilat i ka marrë t'i shfrytëzojnë vetëm për qëllime për të cilat janë kërkuar me respektim të besueshmërisë së të njëjtave.

Neni 56

Evidenca dhe ruajtja e të dhënave

(1) Agjencia mban evidencë dhe ruan dokumentacion që përmban të dhëna për:

a) operatorët;

b) shfrytëzuesit e radiofrekuencave të ndara;

v) shfrytëzuesit e numrave të ndarë dhe/ose serive të numrave;

g) oferta referente për interkoneksion ose qasje nga operatorët;

d) marrëveshje për interkoneksion të lidhura nga operatorët me fuqi të konsiderueshme tregu në treg relevant të shërbimeve komunikuese;

gj) marrëveshjet për interkoneksion ndërmjet operatorëve vendas, si dhe ndërmjet operatorëve vendas dhe të huaj;

e) llogari për kompensime dhe shpenzime për sigurim të shërbimit universal dhe zh) të dhëna tjera që do t'i përcaktojë Agjencia.

(2) Agjencia mban evidencë dhe e ruan dokumentacionin nga paragrafi (1) të këtij neni në bazën e saj informative të të dhënave.

(3) Agjencia mban evidencë dhe ruan të dhëna për operatorët, që kanë të bëjnë me:

a) emrin, selinë, numrin e regjistrimit gjyqësor, NUT, emrin dhe adresën e përfaqësuesit juridik për persona juridikë;

b) notifikimin për rrjetet publike komunikuese dhe/ose shërbimet publike komunikuese;

v) datën e fillimit, ndryshimit ose ndërprerjen e sigurimit të shërbimeve komunikuese publike;

g) vendimet për përcaktim të operatorëve me fuqi të konsiderueshme tregu në treg relevant;

d) plotësimin e obligimeve të operatorëve të cilat dalin nga ky ligj dhe

gj) dënimet e shqiptuara për shkelje të dispozitave nga ky ligj.

(4) Agjencia mban evidencë dhe ruan të dhëna për shfrytëzuesit e radiofrekuencave të cilat kanë të bëjnë me:

a) emrin, selinë, numrin e regjistrimit gjyqësor, NUT për persona juridikë;

b) emrin, adresën dhe numrin unik të amzës të qytetarëve;

v) leje për shfrytëzimin e radiofrekuencave;

g) plotësimin e obligimit për pagim të kompensimit për shfrytëzimin e radiofrekuencave;

d) dënimet e shqiptuara për shkelje të kryera të dispozitave nga ky ligj dhe

gj) të dhëna tjera që do t'i përcaktojë Agjencia.

(5) Agjencia mban evidencë dhe ruan të dhëna për shfrytëzuesit e numrave dhe/ose serive të numrave të ndara të cilat kanë të bëjnë me:

a) emrin, selinë, numrin e regjistrimit gjyqësor dhe NUT dhe emrin dhe adresën e përfaqësuesit juridik për persona juridikë;

b) aktvendimet për numrat dhe/ose seritë e numrave të ndara;

v) plotësimin e obligimit për pagim të kompensimit për shfrytëzimin e numrave dhe/ose serive të numrave të ndara;

g) dënimet e shqiptuara për shkelje të kryera të dispozitave nga ky ligj dhe

d) të dhëna tjera që do t'i përcaktojë Agjencia.

(6) Të dhënat dhe dokumentacionin nga ky nen, Agjencia është e detyruar rregullisht t'i azhurnojë.

(7) Agjencia i ruan të dhënat nga paragrafi (3) të këtij neni, deri sa operatori siguron shërbim publik komunikues në pajtim me këtë ligj, kurse më pas në arkiv pesë vitet e ardhshme. Agjencia i ruan të dhënat nga paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni, derisa personi juridik ose fizik ka të drejtë ta shfrytëzojë radiofrekuencën, numrin dhe/ose serinë e numrave, kurse më pas në arkiv pesë vitet e ardhshme pas skadimit të të drejtave të tilla.

Neni 57

Publikimi i të dhënave dhe informatave

(1) Agjencia është e detyruar në ueb faqen e vet të publikojë të dhëna dhe informata për:

- marrëveshje të lidhura për interkoneksion të operatorëve me fuqi të konsiderueshme tregu,
- oferta referente të operatorëve me fuqi të konsiderueshme të tregut,
- kompensimin e përlogaritur dhe shpenzimet për sigurimin e shërbimit universal,
- lejet e lëshuara radioamatorëve,
- bartjen ose dhënien e të drejtës së shfrytëzimit të radiofrekuencave të ndara dhe numrave dhe/ose serive të numrave të ndara,
- thirrjet publike për marrjen e mendimit nga palët e interesuara,
- thirrjet publike dhe tenderët të cilët i zbaton Agjencia,

- vendimet në lidhje me zgjidhjen e kontesteve dhe
- procedurat e mbaruara të mbikëqyrjes.

(2) Agjencia në ueb faqen e vet publikon edhe të dhëna dhe informata me qëllim që të stimulohet shfrytëzimi të numrave të shërbimeve për thirrje urgjente si dhe shfrytëzimi i numrave të telefonikë 116 (xyz) që janë të dedikuar për shërbime me rëndësi shoqërore.

(3) Të dhënat dhe informatat e përcaktuara në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, Agjencia i publikon edhe në mënyrë tjetër në pajtim me këtë ligj dhe rregullat e miratuara në bazë të tij.

(4) Gjatë publikimit të të dhënave dhe informatave nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, Agjencia është e detyruar në mënyrë përkatëse të mbajë llogari për besueshmërinë e të dhënave dhe informatave si dhe mbrojtjen e të dhënave personale në pajtim me këtë ligj dhe ligj tjetër.

Neni 58

Të dhëna dhe informata që nuk janë të arritshme për publikun

(1) Publikut nuk do t'i jenë të arritshme të dhënat dhe informatat që llogariten për fshehtësi afariste, si dhe të dhënat dhe informatat në pajtim me Ligjin për informata të klasifikuara.

(2) Fshehtësi afariste do të konsiderohet në veçanti:

- çdo e dhënë dhe informatë e cila në pajtim me ligj ose rregull tjetër është e përcaktuar si fshehtësi afariste,

- çdo e dhënë dhe informatë e cila është përcaktuar si fshehtësi afariste në pajtim me akt të përgjithshëm ose akt tjetër të pronarit të të dhënës dhe

- çdo e dhënë dhe informatë e cila është përcaktuar si fshehtësi afariste në pajtim me aktin e miratuar nga ana e Agjencisë.

(3) Nëse të dhënat dhe informatat nga neni 57 paragrafi (1) të këtij ligji përmbajnë fshehtësi afariste, operatori duhet të njëjtat t'i shënojë si fshehtësi afariste.

(4) Në rastet nga paragrafi (3) të këtij neni operatori është i detyruar Agjencisë t'i dorëzojë edhe ekzemplar nga dokumentacioni i cili nuk e përmban fshehtësinë afariste. Nëse vetëm shënon se cilat të dhëna llogaritet për fshehtësi afariste, kurse nuk dorëzon ekzemplar nga shkresa dhe/ose dokumentacioni pa fshehtësi afariste, Agjencia do të kërkojë nga ai operator ta dorëzojë shkresën dhe/ose dokumentacionin pa fshehtësi afariste. Nëse operatori nuk vepron pas kërkesës së Agjencisë do të llogaritet se shkresa e tillë dhe/ose dokumentacioni nuk përmban fshehtësi afariste.

(5) Pa marrë parasysh dispozitat nga paragrafi (2) i këtij neni, për fshehtësi afariste nuk do të llogariten të dhënat ose dokumentacioni i cili në çfarëdo qoftë mënyre ka qenë i kapshëm publikisht ose publikohet në bazë të rregullave të veçanta ose vendimit të pronarit të të dhënave, si dhe rast nga paragrafi (4) të këtij neni.

(6) Anëtarët e Komisioni të Agjencisë, drejtori i Agjencisë dhe të punësuarit në shërbimin profesional të Agjencisë janë të detyruar ta ruajnë fshehtësinë afariste, pa marrë parasysh mënyrën në të cilën e kanë kuptuar. Obligimi për ruajtjen e fshehtësisë afariste zgjat pesë vite pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës në Agjenci ose pas ndërprerjes së mandatit.

Kapitulli i tetë

KUSHTE PËR SIGURIMIN E RRJETEVE DHE/OSE SHËRBIMEVE KOMUNIKUESE ELEKTRONIKE

Neni 59

Sigurimi i rrjeteve dhe/ose shërbimeve komunikuese elektronike

Personat juridikë dhe fizikë të cilët sigurojnë rrjete dhe/ose shërbime komunikuese elektronike publike, si dhe mjete shoqëruese janë të detyruar t'i plotësojnë kushtet e parapara me këtë ligj ose ligj tjetër dhe rregullat e miratuara në bazë të tyre, si dhe marrëveshjet

ndërkombëtare nga sfera e komunikimeve elektronike që i ka lidhur ose të cilat i ka pranuar Republika e Maqedonisë, dhe të mos i rrezikojnë rendin publik, jetën dhe shëndetin e njerëzve, sigurinë publike dhe mbrojtjen e vendit.

Neni 60

Procedura për notifikim

(1) Para fillimit me sigurimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve komunikuese elektronike publike dorëzohet notifikim te Agjencia.

(2) Në bazë të notifikimit nga paragrafi (1) të këtij neni, operatori ka të drejtë të sigurojë rrjete dhe/ose shërbime komunikuese elektronike publike, përkatësisht të ndërtojë, punojë dhe menaxhojë me rrjet elektronik komunikues publik apo të mundësojë qasshmëri në të, në pajtim me këtë ligj.

(3) Notifikimi nga paragrafi (1) të këtij neni përmban të dhëna të cilat Agjencia do t'i mundësojë mbajtje të evidencës zyrtare për operatorët, si dhe kryerje të mbikëqyrjes. Notifikimi përmban:

a) emrin, selinë, numrin unik tatimor dhe numrin e regjistrimit të parashtruesit të notifikimit, si dhe deklaratë nga përfaqësues juridik me emër, adresë, numër për kontakt dhe numër unik të amzës;

b) përshkrim të shkurtër të rrjeteve dhe/ose shërbimeve komunikuese publike dhe mënyrën të realizimit të tyre fizik dhe

v) datën e fillimit me sigurimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve elektronike komunikuese publike.

(4) Agjencia është e detyruar në afat prej 15 ditësh nga marrja e notifikimit i cili nuk i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme dhe dokumentacionin nga paragrafi (3) të këtij neni, ta njoftojë parashtruesin e notifikimit ta plotësojë notifikimin me të dhënat e nevojshme, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit.

(5) Agjencia kryen regjistrim të operatorit me regjistrim në evidencën zyrtare në afat prej shtatë ditësh nga marrja e notifikimit për të cilin do t'i dorëzojë vërtetim me shkrim për regjistrimin e kryer.

(6) Operatori ka për obligim ta njoftojë Agjencinë për ndryshim të të dhënave nga paragrafi (3) pika a) të këtij neni të dhëna në notifikimin në afat prej 30 ditësh nga dita e ndryshimit të ndodhur. Për ndryshim të të dhënave nga paragrafi (3) pika v) të këtij neni, operatori ka për obligim ta njoftojë Agjencinë para datës së theksuar në notifikim, përveç në rast të fuqisë madhore, kur Agjencia njoftohet në afat prej dhjetë ditësh pas datës së theksuar në notifikim. Agjencia do ta shlyejë nga evidenca e saj zyrtare operatorin i cili nuk ka filluar me punë në datën e përcaktuar në notifikim, kurse nuk e ka njoftuar Agjencinë për ndryshimin e të njëjtës, si dhe në rast të falimentimit ose likuidimit.

(7) Operatori ka për obligim ta njoftojë Agjencinë për ndërprerjen me sigurim të rrjetit dhe/ose shërbimit komunikues elektronik publik në afat jo më të gjatë se 90 ditë para datës së ndërprerjes me sigurim të rrjetit dhe/ose shërbimit komunikues elektronik publik. Në njoftimin operatori është i detyruar ta përshkruajë mënyrën në cilën do të sigurohet ruajtja e të dhënave në pajtim me këtë ligj, si dhe mënyrën e qasjes në të njëjtat.

(8) Agjencia me rregull të miratuar në bazë të këtij ligji do t'i përcaktojë përmbajtjen dhe formën e notifikimit, dokumentacionin e nevojshëm dhe vërtetimin për regjistrim.

(9) Agjencia është e detyruar në ueb faqen e vet të publikojë të dhëna për operatorët e notifikuar.

Kapitulli i nëntë

NDËRTIMI I RRJETEVE KOMUNIKUESE ELEKTRONIKE DHE MJETEVE SHOQËRUESE

Neni 61

Rregulla, standarde dhe/ose specifikime teknike

(1) Rrjetet komunikuese elektronike publike dhe mjetet, interfejsat dhe elementet tjera të rrjetit duhet të jenë të planifikuara, projektuara, ndërtuara, mirëmbajtura dhe të punojnë në pajtim me këtë ligj, rregullat e miratuara në bazë të këtij ligji, rregullat për planifikim hapësinor dhe ndërtim, rregullat për mbrojtjen e mjedisit jetësor, rregullat, standardet dhe/ose specifikimet teknike të përmbajtura në rekomandimet e Bashkimit Evropian.

(2) Nëse nuk ekzistojnë rekomandime nga paragrafi (1) të këtij neni, zbatohen standardet dhe/ose specifikimet teknike të Institutit Evropian Telekomunikues për Standardizim (ETSI), Komitetit Evropian për Standardizim (CEN), Komitetit Evropian për Standardizim Elektronik (CENELEC), Unionit Ndërkombëtar për Telekomunikime (ITU), Organizatës Ndërkombëtare për Standardizim (ISO), Komisionit Ndërkombëtar Elektroteknik (IEC) dhe Konferencës Evropiane të Administratave për Posta dhe Telekomunikime (CEPT).

(3) Nëse nuk ekzistojnë standarde përkatëse dhe/ose specifikime teknike nga paragrafi (2) të këtij neni, zbatohen normativat e Republikës së Maqedonisë.

(4) Listën e rregullave, standardeve dhe/ose specifikimeve teknike nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni, Agjencia i publikon në ueb faqen e vet.

Neni 62

Planifikimi, projektimi, ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve komunikuese elektronike publike dhe mjeteve shoqëruese

(1) Ndërtimi dhe mirëmbajtja e rrjeteve komunikuese elektronike publike dhe mjeteve shoqëruese, llogariten si punë me interes publik.

(2) Mirëmbajtja e rrjeteve komunikuese elektronike publike dhe mjeteve shoqëruese, në kuptim të rregullave nga sfera e ndërtimit, përfshin si vijon:

a) ndërtimin plotësues dhe mbindërtimin e mjeteve komunikuese ekzistuese ose pajisjen e rrjeteve komunikuese elektronike (instalim ose zëvendësim të pajisjes, rritje të kapaciteteve, instalim të kablllove komunikues në gypat ekzistues, rikonstruktim, ndryshim të lokacionit, mbrojtje dhe riparim);

b) përforcimin dhe zëvendësimin e sistemeve ekzistuese të antenës dhe uljen ose rritjen e lartësisë së tyre;

v) zëvendësimin e kontejnerëve ekzistues;

g) zgjerimin e sistemeve ekzistuese për furnizim me energji ose

d) tokëzimin ose zgjerimin e tokëzimit ekzistues për shkak të zëvendësimit të objekteve ekzistuese.

(3) Punët nga paragrafi (2) të këtij neni duhet të kryhen në mënyrë që të sigurohet mbajtje e karakteristikave themelore të rrjetit komunikues elektronik publik dhe mjeteve shoqëruese, si dhe në mënyrë që do të mundësojë pengim minimal dhe rrezikim të pronësisë.

(4) Rrjetet komunikuese elektronike publike dhe mjetet shoqëruese, përveç në rast nuk ekziston mundësi teknike, doemos duhet të ndërtohen në mënyrë që do të sigurojë qasje dhe shfrytëzim të tyre të përbashkët në pajtim me këtë ligj, e me qëllim që të sigurohet mbrojtje e mjedisit jetësor, mbrojtje e hapësirës nga intervenime të panevojshme, si dhe mbrojtje e shëndetit të njeriut dhe sigurisë. Për atë qëllim, gjatë ndërtimit të këtyre rrjeteve komunikuese elektronike

dhe mjeteve shoqëruese doemos duhet të parashihet vendosje e pikës qasëse e cila do ta mundësojë shfrytëzimin e përbashkët të pjesës qasëse të rrjetit, për çfarë Agjencia do të miratojë vendim në pajtim me nenin 75 të këtij ligji.

(5) Agjencia në bashkëpunim me ministrinë kompetente për ndërtim, me rregull në mënyrë më detajore do t'i përcaktojë edhe çështjet tjera të cilat kanë të bëjnë në implementimin e dispozitave nga paragrafi (4) të këtij neni dhe nenit 63 të këtij ligji.

Neni 63

Planifikimi, projektimi, ndërtimi i ndërtesave afariste apo banesore me infrastrukturë fizike për sigurim të rrjeteve komunikuese elektronike për transmetim me shpejtësi të mëdha

Ndërtesa afariste ose banesore, doemos duhet të jetë e planifikuar dhe e ndërtuar në mënyrë që do të përmbajë pikë të koncentrimit të vendosur brenda dhe jashtë ndërtesës, në pajtim me Ligjin për ndërtim dhe rregullat e miratuara në bazë të tij, që do të jetë e qasshme për operatorët me qëllim që atyre t'u mundësohet qasje në infrastrukturën fizike në ndërtesë për shpejtësi të mëdha.

Neni 64

Obligime tjera

(1) Rrjetet komunikuese elektronike publike dhe mjetet shoqëruese doemos duhet të planifikohen, projektohen, ndërtohen dhe vendosen në mënyrë me të cilën do të mundësohet që pajisja e tyre komutative ose orientuese, të mos vendoset jashtë Republikës së Maqedonisë.

(2) Rrjetet komunikuese elektronike publike dhe mjetet shoqëruese doemos duhet të planifikohen, projektohen, ndërtohen dhe vendosen në mënyrë me të cilën do të mundësohet dhënie e prioritetit komunikimeve nga pika qasëse të rrjetit të caktuara para komunikimeve tjera në rast të rënies së rrjetit, gjendjes së luftës ose të jashtëzakonshme ose fatkeqësisë elementare. Qeveria e Republikës së Maqedonisë i përcakton grupet e shfrytëzuesve me të drejtë të pikave përfundimtare prioritare të rrjetit.

(3) Rrjetet komunikuese elektronike publike dhe mjetet shoqëruese doemos duhet të planifikohen, projektohen, ndërtohen dhe vendosen në mënyrë me të cilën do të mundësohet me kërkesë të organit shtetëror kompetent ose trupit, pa kompensim të sigurojnë transmetim të mesazheve dhe njoftimeve në rast të gjendjes së luftës ose rrezikimit të drejtpërdrejtë të pavarësisë dhe sovranitetit të Republikës së Maqedonisë, në rast të fatkeqësive më të mëdha natyrore, fatkeqësive teknike-teknologjike dhe ekologjike dhe epidemive, kur ekziston rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe sigurinë e vendit.

(4) Rrjetet komunikuese elektronike publike dhe mjetet shoqëruese për shërbime komunikuese mobile publike doemos duhet të planifikohen, projektohen, ndërtohen dhe vendosen në mënyrë me të cilën pa kompensim do të sigurohet transmetim i porosive SMS të cilat përmbajnë informata nga Ditari elektronik (E-ditari) që e siguron Ministria e Arsimit dhe Shkencës.

Neni 65

Realizimi i punëve në zonën e rrjetit komunikues elektronik dhe mjeteve shoqëruese

(1) Për punët të cilat kryhen në hapësirë në suaza të zonës së rrjetit komunikues elektronik dhe mjeteve shoqëruese, në atë zonë të mbrojtur dhe radiokorridorin e radiostacioneve të caktuara, Agjencia:

- dorëzon mendime gjatë procedurës së përpilimit dhe miratimit të dokumenteve për rregullim hapësinor dhe

- jep pëlqim për plotësimin e kushteve të veçanta për realizimin e punëve në zonën e rrjetit komunikues elektronik dhe mjeteve shoqëruese.

(2) Mënyra e caktimit të zonës së rrjetit komunikues elektronik dhe mjeteve shoqëruese, si dhe të zonës së mbrojtur dhe radiokorridorit të radiostacioneve të caktuara më afërsisht përcaktohen me rregull që e miraton Agjencia.

Neni 66

Sigurimi i qasjes në infrastrukturën fizike të subjektit i cili menaxhon me objekte infrastrukturore

(1) Subjekti i cili menaxhon me objekte infrastrukturore të përcaktuara me Ligjin për kadastër të patundshmërive, në bazë të kërkesës së marrë me shkrim nga operatori i rrjeteve komunikuese elektronike publike është i detyruar të njëjtit, t'i mundësojë qasje në infrastrukturën e tij fizike për vendosjen e elementit të rrjeteve komunikuese elektronike për sigurimin e shpejtësive të mëdha të transmetimit, me kushte, afate dhe çmime të drejta.

(2) Subjekti nga paragrafi (1) i këtij neni, mund ta refuzojë kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni, vetëm në rastet në vijim:

- nuk ekziston mundësi teknike,
- rrezikohet integriteti dhe siguria e rrjetit,
- ekziston rrezik nga interferenca e mundshme serioze ose
- ekziston mënyrë alternative e disponueshme e tregut relevant me shitje me shumicë për qasje fizike te infrastruktura e rrjetit, e përshtatshme për mundësim të rrjetit komunikues elektronik për sigurim të transmetimit me shpejtësi të mëdha.

(3) Subjekti nga paragrafi (1) i këtij neni, është i detyruar në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, me shkrim ta njoftojë kërkuesin për refuzimin e kërkesës së tij dhe t'i theksojë arsyet për atë.

(4) Nëse kërkesa nga paragrafi (1) të këtij neni është refuzuar ose nuk është arritur marrëveshje e përbashkët për qasjen e kërkuar në afat prej dy muajve nga dita e pranimit të kërkesës, Agjencia me kërkesë të njëjës nga palët ngrit procedurë për zgjidhjen e kontestit në pajtim me nenin 53 të këtij ligji.

(5) Agjencia në procedurën për zgjidhjen e kontestit nga paragrafi (4) i këtij neni do të miratojë vendim detyruës me të cilin do ta zgjidhë kontestin, duke pasur parasysh principin e proporcionalitetit dhe me këtë rast aty ku është e përshtatshme do të përcaktojë afate, kushte dhe çmime të drejta. Gjatë përcaktimit të çmimeve, Agjencia duhet ta ketë parasysh ndikimin që do ta ketë qasja e kërkuar mbi planin afarist për investime të subjektit nga paragrafi (1) të këtij neni, kurse në veçanti kur bëhet fjalë për infrastrukturë të ndërtuar fizike për rrjete komunikuese elektronike për sigurim të transmetimit me shpejtësi të mëdha jo më të vjetër se gjashtë muaj. Agjencia do ta miratojë vendimin për zgjidhjen e kontestit, aty ku është e përshtatshme dhe në koordinim me vetëqeverisjen lokale.

Neni 67

Pika unike për informata

(1) Agjencia përmes ueb faqes siguron pikë unike për informata me qëllim që palët e interesuar, mes tjerash, të marrin informata minimale, në lidhje me ndërtimin e planifikuar të rrjetit komunikues elektronik publik dhe mjeteve nga neni 75 të këtij ligji dhe të infrastrukturës ekzistuese fizike të subjektit nga neni 66 paragrafi (1) të këtij ligji, edhe atë: të dhëna për llojin, karakteristikat themelore teknike dhe vendosjes horizontale dhe vertikale të objekteve

infrastrukture nentokësore dhe mbitokësore dhe instalacionit shoqërues, si dhe të dhëna për subjektet të cilat menaxhojnë me të njëjtat. Operatori përmes qasjes në pikën unike informative mund të marrë edhe informata për mënyrën dhe kushtet për marrjen e lejes për ndërtim, në pajtim me ligj, për çfarë Agjencia bashkëpunon me ministrinë përkatëse për ndërtim.

(2) Qasjen në pikën unike informative për marrjen e informatave minimale për sferë të caktuar, Agjencia e mundëson në formë elektronike me këtë rast duke pasur parasysh principet e proporcionalitetit dhe mosdiskriminimit. Agjencia nuk do ta mundësojë qasjen të informatat me të cilat mund të rrezikohet shëndeti publik dhe siguria publike, siguria dhe integriteti i rrjeteve, si dhe të informatat që kanë të bëjnë në fshehtësitë operative dhe afariste.

(3) Të dhënat minimale nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia i siguron në mënyrë të përcaktuar në Ligjin për kadastrë të patundshmërive, si dhe nga komunat, komunat në Qytetin e Shkupit dhe Qyteti i Shkupit.

(4) Nëse informatat minimale nga paragrafi (1) të këtij neni, nuk mund të sigurohen përmes pikës unike informative, subjektet nga neni 66 paragrafi (1) të këtij ligji janë të detyruar në afat prej një muaji nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim nga cilido operator i rrjeteve dhe/ose shërbimeve komunikuese elektronike publike t'i sigurojnë qasje tek ato informata, me kushte proporcionale, jodiskriminuese dhe transparente.

(5) Subjekti nga neni 66 paragrafi (1) të këtij ligji, është i detyruar pas kërkesës së marrë me shkrim nga operatori t'i mundësojë këqyrje në vendin e ngjarjes të elementeve nga infrastruktura e vet fizike. Kërkesa duhet të përmbajë të dhëna se për cilat elemente nga infrastruktura fizike duhet të mundësohet këqyrje, nga aspekti i vendosjes së elementeve për rrjete me shpejtësi të mëdha. Këqyrja duhet të mundësohet në afat prej një muaj nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim, me ç'rast duhet të respektohen parimi i proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe transparencës.

(6) Subjekti i nenit 66 nga paragrafi (1) të këtij ligji është i detyruar pas kërkesës së marrë me shkrim nga operatori t'ia vë në dispozicion informatat minimale në vijim të cilat kanë të bëjnë me punët ndërtimore rrjedhëse ose të planifikuara lidhur me infrastrukturën e tij fizike për të cilën është marrë leje për ndërtim, ose leja për ndërtim është procedurë për lëshim ose planifikon në gjashtë muajt e ardhshëm të parashtrijë kërkesë për marrjen e lejes për ndërtim, edhe atë:

- lokacionin dhe llojin e punëve ndërtimore,
- elementet e rrjetit të cilat do involvohen në punët ndërtimore,
- datën e paraparë të fillimit me punët ndërtimore dhe kohëzgjatjen e tyre dhe
- personat për kontakt.

(7) Subjekti në nenin 66 nga paragrafi (1) të këtij ligji është i detyruar në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim, nga paragrafi (6) të këtij neni t'i sigurojë informatat e kërkuara me kushte proporcionale jodiskriminuese dhe transparente dhe të njëjtat t'ia bëjë të arritshme Agjencisë për shkak të mundësimit të qasjes tek ato informata përmes pikë unike informative.

(8) Subjekti i nenit 66 nga paragrafi (1) të këtij ligji mund ta refuzojë kërkesën nga paragrafi (6) i këtij neni, nëse:

- informatat e kërkuara paraprakisht i ka bërë publikisht të arritshme në formë elektronike ose
- qasja tek ato informata është mundësuar përmes pikës unike informative.

(9) Në rast të kontestit në lidhje me paragrafët prej (4) deri (8) të këtij neni, Agjencia me kërkesë të njëjës prej palëve ngrit procedurë për zgjidhjen e kontestit në pajtim me nenin 53 të këtij ligji. Agjencia, do të miratojë vendim obligativ me të cilin do të zgjidhet kontesti duke e pasur parasysh principin e proporcionalitetit.

(10) Agjencia në bashkëpunim me ministrinë kompetente për ndërtim mund të miratojë akt nënligjor me të cilin do të përcaktohen përjashtime nga obligimet në pajtim me paragrafët (1), (3), (4) dhe (5) të këtij neni, e që kanë të bëjnë me rastet kur në infrastrukturë të caktuar fizike nuk është e mundshme teknikisht të vendoset rrjet komunikues elektronik publik për sigurimin e shpejtësive të mëdha për transmetim.

(11) Operatori ka të drejtë përmes pikës unike informative, në formë elektronike, të parashtrijë kërkesë për marrjen e lejes për ndërtim për vendosjen e elementeve për rrjet komunikues elektronik për sigurim të transmetimit me shpejtësi të mëdha. Me këtë do të sigurohet që kërkesa e operatorit të përcillet tek organi përkatës kompetent për lëshimin e lejes për ndërtim, si dhe të mundësohet ndjekje e respektimit të afateve për lëshimin e lejes për ndërtim nga ana e organit kompetent.

Neni 68

Koordinimi i punëve ndërtimore

(1) Personi juridik i cili realizon punë ndërtimore të cilat financohet me mjete publike është i detyruar në kushte jodiskriminuese dhe transparente, të përmbushë çdo kërkesë të arsyeshme për lidhjen e marrëveshjen për koordinim të ndërsjellë të punëve ndërtimore dorëzuar nga operatori për ndërtim dhe vendosje të rrjetit komunikues elektronik publik për sigurimin e transmetimit me shpejtësi të mëdha, me kusht që kjo të mos tërheqë kurrfarë shpenzimesh plotësuese për punë ndërtimore të parapara fillimisht. (2) Operatori është i detyruar që kërkesën për lidhjen e marrëveshjes për koordinim të ndërsjellë të punëve ndërtimore t'i dorëzojë tek personi juridik nga paragrafi (1) të këtij neni, jo më shkurt se një muaj para se ta dorëzojë dokumentacionin e nevojshëm projektues te organi kompetent për marrjen e lejes për ndërtim, në pajtim me ligj.

(3) Nëse në afat prej një muaji nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk arrihet marrëveshje për koordinim të ndërsjellë të punëve ndërtimore, cila do nga palët ka të drejtë të kërkojë nga Agjencia që ta zgjidhë kontestin.

(4) Agjencia duke i pasur parasysh principet e proporcionalitetit do të lëshojë vendim obligativ me të cilin do ta zgjidhë kontestin nga paragrafi (3) të këtij neni dhe me këtë rast do të përcaktohen afate dhe kushte të drejta dhe jodiskriminuese si dhe kompensime, ku kjo është e përshtatshme.

(5) Agjencia në bashkëpunim me vetëqeverisjen lokale, informatat për personat juridikë nga paragrafi (1) i këtij neni i publikon përmes pikës unike informative nga neni 67 i këtij ligji.

Neni 69

Sigurimi i qasjes në infrastrukturën fizike në ndërtesë për shpejtësi të mëdha

(1) Poseduesi i të drejtës për shfrytëzimin e infrastrukturës fizike në ndërtesë për shpejtësi më të mëdha, në bazë të kërkesës së marrë me shkrim nga cilido çiftë operator i rrjeteve komunikimeve publike elektronike, është i detyruar që të njëjtit, në kushte dhe afate jodiskriminuese, t'i mundësojë qasje te pika për koncentrim të ndërtesës, si dhe t'i mundësojë qasje te infrastruktura fizike në ndërtesë për shpejtësi të mëdha, në rast kur dublimi i infrastrukturës është ekonomikisht efikas ose fizikisht është jopraktik. Operatori i cili kërkon qasje është detyruar qasjen te pika e koncentrimit të ndërtesës ta sigurojë me shpenzim personal dhe me prishje minimale të pronës private.

(2) Nëse nuk ekziston infrastrukturë fizike në ndërtesë për shpejtësi të mëdha, operatori i rrjeteve komunikuese elektronike publike ka të drejtë të vendosë pika përfundimtare të rrjetit në hapësirat e parapaguesit me të cilën ka lidhur marrëveshje për sigurim të qasjes me shtrirje të gjerë tek shërbimet, që duhet të jetë me dëme minimale dhe në shpenzim personal.

(3) Nëse në afat prej një muaji nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, nuk është arritur marrëveshjet për qasje, Agjencia me kërkesës të njëjës prej palëve ngrit procedurë për zgjidhjen e kontestit në pajtim me nenin 53 të këtij ligji.

(4) Agjencia në procedurën për zgjidhjen e kontestit nga paragrafi (3) të këtij neni do të miratojë vendim obligativ me të cilin do ta zgjidhë kontestin, duke e pasur parasysh principin e proporcionalitetit.

(5) Operatori i rrjeteve komunikuese elektronike publike të cilit i është mundësuar qasja në pajtim me paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni është i detyruar në afat prej 30 ditësh nga dita e lidhjes së marrëveshjes, Agjencisë t'i dorëzojë informata në lidhje me realizimin e qasjes, për shkak të mundësimit të qasshmërisë tek ato informata përmes pikës unike informative në pajtim me nenin 67 të këtij ligji.

Neni 70

Eksproprijimi, e drejta e servitutit dhe kufizime tjera të të drejtës së pronësisë

Të drejtat pronësore dhe të drejtat tjera mbi pronën e patundshme mund të eksproprijohen, përkatësisht të vendoset e drejta e servitutit dhe kufizimeve tjera të të drejtës së pronësisë në rast të ndërtimit dhe mirëmbajtjes së rrjeteve komunikuese elektronike publike dhe mjeteve shoqëruese, në pajtim me ligj.

Neni 71

Mbikëqyrje

Agjencia në bashkëpunim me ministrinë kompetente për ndërtim kryen mbikëqyrje mbi zbatimin e dispozitave të këtij kapitulli të ligjit.

Kapitulli i dhjetë

SIGURIMI I KONKURENCËS DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 72

Persona juridikë me të drejta të veçanta ose ekskluzive

Personat juridikë të cilët sigurojnë rrjete dhe/ose shërbime komunikuese elektronike nga të cilat kanë të hyra të përgjithshme vjetore më shumë se një milion euro dhe kanë të drejta ekskluzive ose të veçanta për sigurimin e shërbimeve në sektorë tjerë ekonomikë, janë të detyruar të themelojnë person të veçantë juridik për sigurimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve komunikuese elektronike publike ose të mbajnë kontabilitet të veçantë për aktivitetet lidhur me sigurimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve komunikuese publike ashtu siç do t'i kishin mbajtur kur këto aktivitete do t'i kishin siguruar si person i veçantë juridik.

Neni 73

Obligime për interkoneksion dhe qasje

(1) Operatorët ka të drejtë, e me kërkesë të operatorit edhe obligim, ndërmjet vete të negociojnë në lidhje me interkoneksionin ose qasjen, me qëllim për sigurimin e shërbimeve komunikuese publike dhe interoperabilitetit ndërmjet shërbimeve.

(2) Për çështje teknike, financiare dhe çështje tjera lidhur me interkoneksionin ose qasjen, palët janë të detyruara të lidhin marrëveshje e cila nuk guxon të jetë në kundërshtim me këtë ligj. Nëse palët nuk arrijnë marrëveshje, Agjencia me kërkesë të njëjës prej palëve e zgjidh kontestin në pajtim me dispozitat e këtij ligji.

(3) Palët janë të detyruara ta mbrojnë besueshmërinë e të dhënave të këmbjeryera gjatë lidhjes së marrëveshjes për interkoneksion ose qasje. Të dhënat nuk guxojnë të shfrytëzohen për asnjë dedikim tjetër ose t'u barten personave të tretë të cilëve informatat e tilla do t'u mundësonin përparësi konkurruese, me këtë rast duke mbajtur llogari për obligime të caktuara me nenet 84 dhe 85 të këtij ligji.

(4) Operatori është i detyruar në afat prej dhjetë ditë pune nga dita e pranimi të kërkesës për interkoneksion ose qasje, t'i përgjigjet së njëjtës. Marrëveshja për interkoneksion ose qasje duhet të lidhet në afat prej 45 ditësh nga dita e pranimi të kërkesës për interkoneksion ose qasje.

(5) Operatorët me fuqi të konsiderueshme në treg, janë të detyruar t'i përmbushin kërkesat për interkoneksion ose qasje në cilën do pikë në rrjetet e tyre ku është teknikisht e mundshme, duke përfshirë qasje të pikave që nuk paraqesin pika përfundimtare të rrjetit, në pajtim me dispozitat e këtij ligji, obligimet e përcaktuara nga ana e Agjencisë dhe ofertat e miratuara referente.

(6) Marrëveshjet për interkoneksion ose qasje ndërmjet operatorëve me fuqi të konsiderueshme tregu në treg relevant dhe operatorit tjetër doemos duhet:

a) të jenë në formë me shkrim dhe

b) ta përmbajnë tërësisht marrëveshjen ndërmjet palëve.

(7) Operatori me fuqi të konsiderueshme tregu në treg relevant është i detyruar te Agjencia t'i dorëzojë marrëveshjet e lidhura për interkoneksion ose qasje me operatorët tjerë në Republikën e Maqedonisë, si dhe marrëveshjet e lidhura për interkoneksion ose qasje me operatorët e huaj në afat prej 15 ditësh nga dita e nënshkrimit të tyre.

(8) Marrëveshjet për interkoneksion ose qasje nga paragrafi (6) të këtij neni janë publikisht të arritshme në pajtim me nenin 57 të këtij ligji.

(9) Nëse marrëveshja e arritur është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji, ofertat e miratuara referente ose obligimet e përcaktuara paraprakisht, Agjencia me detyrë zyrtare do të miratojë vendim me të cilin në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimi të vendimit do t'i detyrojë palët që t'i harmonizojnë marrëveshjet me dispozitat e këtij ligji, ofertat e miratuara referente ose obligimet e përcaktuara paraprakisht.

Neni 74

Kompetenca e Agjencisë në lidhje me sigurimin e interkoneksionit ose qasjes

(1) Agjencia, në pajtim me qëllimet rregullatore dhe parimet e përcaktuara me këtë ligj, stimulon dhe aty ku është e përshtatshme siguron interkoneksion ose qasje interoperabilitet ndërmjet shërbimeve në mënyrë që promovon konkurrencë efikase, të qëndrueshme, investim efikas dhe inovacione dhe sigurim të volitshmërive maksimale për shfrytëzuesit përfundimtarë. Për këtë qëllim, Agjencia mundet:

- operatorëve të cilët kanë kontroll të qasjes te shfrytëzuesit përfundimtarë, e me qëllim të lidhjes së pikave përfundimtare të rrjeteve, në atë masë në të cilën është e domosdoshme, t'u imponojë obligim për interkoneksion, nëse i njëjti nuk është vendosur,

- operatorëve të cilët kanë kontroll të qasjes te shfrytëzuesit përfundimtarë, në atë masë në të cilën është e domosdoshme dhe e arsyeshme, t'u imponojë obligim për interoperabilitet ndërmjet shërbimeve të tyre ose

- operatorëve, kur është e nevojshme të sigurojnë qasje të shfrytëzuesve përfundimtarë te shërbimet për emetim digjital radio dhe televiziv, obligime të sigurojnë qasje te interfejsat programorë aplikativë dhe/ose te udhërrëfyesit elektronikë programorë në kushte fer, të drejta dhe jodiskriminuese.

(2) Obligimet dhe kushtet e përcaktuara nga paragrafi (1) i këtij neni, doemos duhet të jenë objektive, transparente, proporcionale dhe jodiskriminuese.

(3) Gjatë imponimit të obligimeve dhe kushteve nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia është e detyruar të veprojë në pajtim me nenin 13 të këtij ligji.

Neni 75

Shfrytëzimi i përbashkët i lokacionit të njëjtë (kolokacioni) dhe shfrytëzimi i përbashkët i elementeve të rrjetit dhe mjeteve shoqëruese

(1) Agjencia duke e pasur parasysh parimin e proporcionalitetit, mundet operatorit të rrjeteve komunikuese elektronike publike, i cili ka të drejtë të vendosë mjete në, mbi ose nën pronën private ose publike ose ka të drejtë për eksproprijim, të drejtë servituti ose të drejtë për shfrytëzim, mund t'i imponojë obligim për shfrytëzim të përbashkët të atyre mjeteve ose pronës (duke përfshirë shfrytëzim të përbashkët të lokacionit të njëjtë - kolokacion), e në veçanti të infrastrukturës së tij fizike ose mund t'i imponojë obligim për koordinimin e punëve ndërtimore në pajtim me nenin 68 të këtij ligji.

(2) Agjencia operatorit të rrjeteve publike elektronike komunikuese nga paragrafi (1) i këtij neni mund t'i imponojë edhe obligim për shfrytëzim të përbashkët të kabllove elektronike komunikuese në ndërtesën afër pikës së parë të koncentririmit ose afër pikës shpërndarëse, nëse ajo gjendet jashtë ndërtesës, në raste kur dublimi i infrastrukturës së këtyllë do kishte qenë ekonomikisht joefikase ose fizikisht jopraktike.

(3) Agjencia i dedikon obligimet e paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni në dobi të operatorit tjetër të rrjetit publik elektronik për komunikim me qëllim që të mbrohet mjedisi jetësor, shëndeti publik, siguria publike ose për plotësimin e qëllimeve të planifikimit urbanistik dhe hapësinor dhe në rast kur palët nuk mund të arrijnë marrëveshje për shfrytëzim të përbashkët.

(4) Obligimet e përcaktuara në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni, Agjencia i imponon duke vepruar në pajtim me nenet 13 dhe 55 të këtij ligji dhe duke i respektuar parimet e objektivitetit, transparencës, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit, dhe atje ku është e përshtatshme dhe në koordinim me vetëqeverisjen lokale. Agjencia mund të përcaktojë edhe rregulla për shpërndarjen e shpenzimeve për mjetet ose për pronën si dhe rregulla për shpërndarjen e shpenzimeve për shfrytëzim të përbashkët të kabllove elektronike komunikuese në ndërtesë duke pasur parasysh edhe rrezikun.

(5) Operatori i rrjeteve komunikuese elektronike publike nga paragrafi (1) i këtij neni është i detyruar, në afat jo më të shkurtër se një muaj dhe jo më të gjatë se gjashtë muaj para se të parashtrijë kërkesë për lëshimin e lejes për ndërtim, Agjencisë t'i dorëzojë informatë në lidhje me punët e planifikuara ndërtimore të cilat kanë të bëjnë me ndërtimin e mjeteve, për mundësim të qasjes të ato informata përmes pikës unike informative në pajtim me nenin 67 të këtij ligji.

Kapitulli i njëmbëdhjetë

RREGULLIMI I OPERATORËVE ME FUQI TË KONSIDERUESHME TREGU

Neni 76

Operatorët me fuqi të konsiderueshme tregu

(1) Operatori konsiderohet se posedon fuqi të konsiderueshme tregu në tregun e rrjeteve ose shërbimeve komunikuese publike, nëse në mënyrë të mëvetësishme, ose së bashku me operatorë tjerë ka pozitë dominuese, përkatësisht, posedon fuqi ekonomike dhe kapacitet të veprjës në përmasa të konsiderueshme pavarësisht nga konkurruesit dhe shfrytëzuesit e atij tregu.

(2) Dy ose më shumë operatorë mund të trajtohen si operatorë të cilët bashkërisht kanë pozitë dominuese në treg, madje edhe në mungesë të lidhjeve strukturore ose të lidhjeve tjera ndërmjet tyre nëse punojnë në treg i cili karakterizohet me mungesë të konkurrencës efikase dhe në të cilin asnjë operator nuk ka fuqi të konsiderueshme tregu.

(3) Kur një operator ka fuqi të konsiderueshme tregu në një treg të caktuar, mund të konsiderohet se i njëjti ka fuqi të konsiderueshme tregu edhe në një treg tjetër të afërt, nëse lidhjet ndërmjet dy tregjeve janë të atilla që lejojnë që fuqia e tregut nga njëri treg të bartet në

tregun tjetër, me çfarë përforcohet fuqia tregtare e operatorit. Me qëllim që të pengohet fuqia e atillë edhe në tregun tjetër mund të imponohen obligime në pajtim me këtë ligj. Nëse këto obligime nuk i japin rezultatet e pritura mund të imponohet edhe obligim për rregullimin e çmimeve për shitje me pakicë në pajtim me këtë ligj.

Neni 77

Kritere për përcaktimin e operatorit ose dhënësit të shërbimeve elektronike publike komunikuese me fuqi të konsiderueshme tregu

Gjatë vlerësimit nëse një operator ka fuqi të konsiderueshme tregu në një treg të caktuar në pajtim me nenin 76 paragrafi (1) të këtij ligji, Agjencia i ka parasysh në veçanti kriteret si vijojnë të cilat nuk zbatohen në mënyrë kumulative:

- pjesëmarrja që operatori e ka në tregun relevant,
- madhësia e operatorit,
- kontrolli i infrastrukturës që nuk mund të dublohet lehtë,
- përparësitë teknologjike dhe superioriteti,
- mungesa e fuqisë blerëse kompensuese,
- qasja e thjeshtë ose e privilegjuar te tregjet me kapital ose burime financiare,
- shkalla e diversifikimit (shumëllojshmërisë) të prodhimeve ose shërbimeve,
- ekonomitë e vëllimit,
- ekonomitë e integritit,
- shkalla e integritit vertikal,
- rrjeti distributiv dhe i shitjes me zhvillim të lartë,
- mungesa e konkurrencës potenciale,
- barrierat për zhvillim,
- çmimet e larta,
- hyrja e lehtë në treg dhe
- shpenzimet dhe barrierat për shfrytëzimin e shërbimeve të reja.

Neni 78

Kriteret për përcaktimin e operatorëve të cilët bashkërisht kanë pozitë dominuese në treg

Gjatë kryerjes së vlerësimit nëse dy ose më shumë operatorë bashkërisht kanë pozitë dominuese në treg në pajtim me nenin 76 paragrafi (2) të këtij ligji, Agjencia i ka parasysh në veçanti kriteret si vijojnë të cilat nuk zbatohen në mënyrë kumulative:

- elasticiteti i ulët i kërkesës,
- pjesëmarrja e ngjashme në treg,
- barrierat e larta juridike ose ekonomike për hyrje në treg,
- integrimi vertikal me refuzim të përbashkët të ofertës,
- mungesa e fuqisë blerëse kompensuese dhe
- mungesa e konkurrencës potenciale.

Neni 79

Zbatimi i analizës së tregjeve relevante

Agjencia zbaton analizë të tregjeve relevante duke i pasur parasysh rekomandimet e Komisionit Evropian për përcaktimin e tregjeve relevante të prodhimeve dhe shërbimeve dhe ku është e përshtatshme në bashkëpunim me organin kompetent për mbrojtjen e konkurrencës.

Neni 80

Përcaktimi i tregjeve relevante të prodhimeve dhe shërbimeve

(1) Agjencia mund të përcaktojë tregje relevante të prodhimeve dhe shërbimeve dhe tregje relevante gjeografike në sferën e komunikimeve elektronike në territorin e Republikës së Maqedonisë, karakteristikat e të cilave mund të jenë të atilla që do ta arsyetojnë imponimin e obligimeve rregullatore të përcaktuara me këtë ligj, duke mos i vënë në pikëpyetje tregjet të cilat në raste të caktuara mund të përcaktohen sipas Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës. Agjencia i përcakton tregjet relevante pas debatit publik të mbajtur paraprakisht në pajtim me këtë ligj.

(2) Gjatë përcaktimit të tregjeve relevante të prodhimeve dhe shërbimeve Agjencia duhet të përcaktojë se në mënyrë kumulative janë plotësuar tre kriteret si vijojnë:

- prezenca e barrierave të larta dhe ekzistuese për hyrje që mund të jenë të natyrës strukturore, juridike ose rregullatore,
- struktura e tregut i cili ka tendencë drejt konkurrencës joefektive në suaza të periudhës kohore relevante dhe
- Ligji për mbrojtjen e konkurrencës nuk mjafton që vetë t'i zgjidhë problemet e tregut.

Neni 81

Rishqyrtimi i tregut të përcaktuar relevant të prodhimeve dhe shërbimeve

Agjencia në periudha të caktuara kohore, të cilat nuk mund të jenë më të gjata se tre vite në bashkëpunim me organin kompetent për mbrojtjen e konkurrencës, është e detyruar ta rishqyrtojë tregun e përcaktuar relevant të prodhimeve dhe shërbimeve.

Neni 82

Përcaktimi i operatorit me fuqi të konsiderueshme tregu, imponimi, vazhdimi, ndryshimi ose revokimi i obligimeve

(1) Nëse Agjencia në bazë të analizës së tregut relevant përcakton se në atë treg nuk ka konkurrencë të mjaftueshme efektive, ajo ka për obligim të vendosë se cili ose cilët operatorë kanë fuqi të konsiderueshme tregu në atë treg në pajtim me nenin 76 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji. Vendimin për përcaktimin e operatorit me fuqi të konsiderueshme tregu në tregun relevant Agjencia e shpall në ueb faqen e vet në afat prej tre ditëve nga dita e miratimit të tij.

(2) Operatorit i cili është caktuar si operator me fuqi të konsiderueshme tregu në pajtim me nenin (1) të këtij neni, Agjencia mund t'i imponojë, vazhdojë ose ndryshojë disa nga obligimet ekzistuese në pajtim me këtë ligj, të cilat duhet të bazohen me natyrën e problemit të identifikuar dhe të jenë proporcionalë dhe të arsyeshëm, e në drejtim të plotësimit të qëllimeve rregullatore dhe parimeve nga neni 7 i këtij ligji.

(3) Nëse Agjencia në bazë të analizës në tregun relevant përcakton se tregu është konkurrent në mënyrë efektive, nuk do të caktojë asnjë operator si operator me fuqi të konsiderueshme tregu në pajtim me nenin 76 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji. Nëse ky treg nuk ka qenë konkurrues paraprakisht, Agjencia është e detyruar t'i revokojë të gjithë vendimet për caktimin e operatorëve me fuqi të konsiderueshme tregu në atë treg.

(4) Gjatë revokimit të vendimeve nga paragrafi (3) i këtij neni, Agjencia i liron edhe nga obligimet të cilat i kanë pasur si operatorë me fuqi të konsiderueshme tregu, në pajtim me këtë ligj.

(5) Vendimin për revokim në pajtim me paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, Agjencia e shpall në ueb faqen e vet në afat prej tre ditëve nga dita e miratimit të tij.

(6) Agjencia mund të zbatojë masa në pajtim me këtë nen, në bazë të debatit publik të zbatuar paraprakisht në pajtim me nenin 13 të këtij ligji dhe në bashkëpunim me trupin kompetent për mbrojtjen e konkurrencës.

Neni 83

Ndalimi i veçantë për marrjen e pronësisë

Operatorët me fuqi të konsiderueshme tregu në treg relevant të caktuar, të gjithë personat të cilët posedojnë më shumë se 10% të pjesëmarrjeve ose aksioneve në firma të cilat janë operatorë me fuqi të konsiderueshme tregu në treg të caktuar relevant (principale), si dhe firmat e themeluara nga operatorët me fuqi të konsiderueshme tregu në tregun relevant, nuk mund të marrin pronësi të rrjeteve komunikuese me të cilat zvogëlohet konkurrenca në treg të caktuar relevant dhe kufizohet zgjedhja e shfrytëzuesve lidhur me shërbimin e caktuar komunikues pa pëlqim të trupit për mbrojtjen e konkurrencës.

Neni 84

Obligimi për transparencë gjatë interkoneksionit ose qasjes

(1) Agjencia në pajtim me këtë ligj mundet operatorit me fuqi të konsiderueshme tregu në treg relevant t'u imponojë obligim për transparencë lidhur me interkoneksionin ose qasjen, në mënyrë që të njëjtët do t'i detyrojë që të shpallin informata për:

- kontabilitetin,
- specifikimet teknike,
- karakteristikat e rrjeteve,
- afatet dhe kushtet e ofertës dhe shfrytëzimit, duke i përfshirë edhe të gjithë kushtet me të cilat kufizohet qasja te dhe/ose përdorimi i shërbimeve dhe i aplikacioneve dhe
- çmimet.

(2) Nivelin e detajeve të informatave nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe mënyrën e shpalljes së tyre e përcakton Agjencia.

(3) Operatorit me fuqi të konsiderueshme tregu në treg relevant, i cili ka për obligim për mosdiskriminim në pajtim me nenin 85 të këtij ligji, Agjencia mundet t'i imponojë obligim në afat prej 30 ditëve nga dita e miratimit të vendimit me të cilin është caktuar si operator me fuqi të konsiderueshme tregu të dorëzojë te Agjencia propozim të ofertës referente për interkoneksion ose qasje. Oferta referente doemos duhet të jetë mjaft e hollësishme, që të sigurohet që operatorët tjerë që kërkojnë interkoneksion dhe/ose qasje, të mos paguajnë për kapacitetet, përkatësisht mjetet që nuk janë të nevojshme për shërbimin e kërkuar.

(4) Oferta referente nga paragrafi (3) i këtij neni doemos duhet të zërthehet në komponentë me përshkrim të shërbimeve të cilat i ofron operatori me fuqi të konsiderueshme tregu në tregun relevant lidhur me interkoneksionin ose qasjen në pajtim me nevojat tregtare, si dhe afatet, kushtet dhe çmimet për sigurimin e të njëjtave.

(5) Ofertën referente nga paragrafi (3) i këtij neni e miraton Agjencia në afat prej 30 ditëve nga dita e dorëzimit të saj te Agjencia, ndërsa operatori është i detyruar ta shpallë ofertën referente në ueb faqen e vet në afat prej pesë ditëve nga dita e marrjes së lejes nga Agjencia.

(6) Operatori është i detyruar çmimet në ofertën e miratuar referente nga paragrafi (3) i këtij neni t'i zbatojë ditën e parë të muajit të ardhshëm i cili vijon pas muajit në të cilin është marrë leja nga Agjencia.

(7) Agjencia me rregull, në mënyrë më të hollësishme do ta përcaktojë përmbajtjen dhe informatat të cilat duhet të shpallen në ofertën referente nga paragrafi (3) i këtij neni.

(8) Operatori me fuqi të konsiderueshme tregu nuk guxon t'u shmanget kushteve në ofertën e miratuar referente gjatë lidhjes së marrëveshjes për interkoneksion dhe/ose qasje.

(9) Drejtori i Agjencisë mund të miratojë aktvendim me të cilin do të kërkojë nga operatori me fuqi të konsiderueshme tregu, të kryejë ndryshim të ofertës së miratuar tregtare, përkatësisht të përgatisë dhe të dorëzojë ofertë referente të rinovuar dhe të azhurnuar me qëllim që të sigurohen qëllimet rregullatore dhe parimet e përcaktuara në nenin 7 të këtij ligji, ndërsa operatori mundet ta kryej atë edhe me vetiniciativë.

(10) Operatori me fuqi të konsiderueshme tregu është i detyruar të veprojë sipas aktvendimit nga paragrafi (9) i këtij neni në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të aktvendimit, ndërsa Agjencia e miraton ndryshimin e ofertës referente në afat prej 30 ditëve nga dita e dorëzimit të saj te Agjencia. Kur operatori dorëzon te Agjencia ndryshim të ofertës së miratuar referente me vetiniciativë, Agjencia është e detyruar të prononcohet për të njëjtën në afat prej 30 ditëve nga dita e dorëzimit të saj te Agjencia.

(11) Dispozitat nga paragrafët (4) dhe (5) të këtij neni të cilat kanë të bëjnë me shpalljen dhe zbatimin e ofertave referente vlejshme edhe për ndryshimet e ofertave të miratuara referente.

Neni 85

Obligimi për mosdiskriminim gjatë interkoneksionit ose qasjes

(1) Agjencia në pajtim me këtë ligj mundet operatorit me fuqi të konsiderueshme tregu në treg relevant t'i imponojë obligim për mosdiskriminim lidhur me interkoneksionin ose qasjen.

(2) Me obligimin për mosdiskriminim nga paragrafi (1) i këtij neni garantohej se operatori i caktuar me fuqi të konsiderueshme tregu do të zbatojë kushte ekuivalente në rrethana ekuivalente për operatorët tjerë të cilët japin shërbime të njëjta dhe do t'u sigurojë shërbime dhe informata operatorëve tjerë me kushtet e njëjta dhe me kualitet të njëjtë si ato që i siguron për shërbime personale ose ato për degët e tij ose partnerët.

Neni 86

Obligimi për kontabilitet të veçantë gjatë interkoneksionit ose qasjes

(1) Agjencia në pajtim me këtë ligj mundet operatorit me fuqi të konsiderueshme tregu në treg relevant t'i imponojë obligim për mbajtjen e kontabilitetit të veçantë për aktivitetet lidhur me interkoneksionin ose qasjen.

(2) Agjencia nga operatori me fuqi të konsiderueshme tregu që është kompani e integruar vertikale mund të kërkojë transparencë për çmimet për shitje me shumicë dhe për çmimet e brendshme transferuese me qëllim që të sigurohet harmonizim me obligimin për mosdiskriminim, si dhe të pengohen subvencione të kryqëzuara të mundshme të padrejta.

(3) Me qëllim që të përcaktohet harmonizimi me obligimet për transparencë dhe mosdiskriminime, operatorët me fuqi të konsiderueshme tregu në treg relevant detyrohen me kërkesë të Agjencisë, t'i dorëzojnë të dhëna të kontabilitetit, duke përfshirë edhe të dhëna për të hyrat e marra nga palët e treta.

(4) Agjencia mundet t'i shpallë informatat e atilla që të kontribuojë për treg të hapur dhe të konkurrues, njëkohësisht duke e respektuar besueshmërinë e informatave të marra në pajtim me rregullat për fshehtësi afariste.

(5) Agjencia mundet me akt nënligjor në mënyrë më të hollësishme t'i rregullojë çështjet që dalin nga zbatimi i këtij neni.

Neni 87

Obligimet për sigurimin e qasjes dhe shfrytëzimin e mjeteve specifike të rrjetit

(1) Agjencia, në pajtim me këtë ligj, mundet operatorit me fuqi të konsiderueshme tregu në treg relevant t'i imponojë obligime që t'i plotësojë të gjithë kërkesat e arsyeshme për qasje dhe shfrytëzim të elementeve specifike të rrjetit dhe mjeteve shoqëruese.

(2) Agjencia i imponon obligimet nga paragrafi (1) i këtij neni, atëherë kur konsideron se refuzimi që të jepet qasje ose vendosja e kushteve të paarsyeshme që kanë efekt të ngjashëm, do të mund ta pengojnë krijimin e tregut mjaftë konkurrues në nivel të shitjes me pakicë ose kur ajo nuk është në interes për shfrytëzuesit përfundimtarë.

(3) Agjencia, gjatë vendosjes së obligimeve nga paragrafi (1) i këtij neni nga operatori me fuqi të konsiderueshme tregu në treg relevant, mes tjerash mund të kërkojë që:

- operatorit tjetër t'i japë qasje te elementet specifike të rrjetit dhe/ose mjeteve duke përfshirë edhe qasje te elementet e rrjetit të cilat nuk janë aktive dhe/ose qasje të shkoqitur në lak lokal me qëllim, mes tjerash, të sigurohet zgjedhje dhe/ose parazgjedhje e operatorit dhe/ose ofertë për rishitjen e linjës parapaguese,

- të negociojë me vullnet të mirë me operatorët që kërkojnë qasje,

- të mos e tërheqë qasjen e dhënë te mjetet,

- operatorit tjetër t'i sigurojë shërbime të caktuara në bazë të shitjes me shumicë për rishitje,

- të miratojë qasje të hapur te interfejsat teknikë, protokollet ose teknologjitë tjera të rëndësishme që janë të domosdoshme për interoperabilitetin e shërbimeve ose për shërbimet virtuale të rrjetit,

- të sigurojë shfrytëzim të përbashkët të lokacionit të njëjtë (kolokacion) ose forma tjera të shfrytëzimit të përbashkët të mjeteve shoqëruese,

- të sigurojë shërbime të caktuara të nevojshme për mundësimin e interoperabilitetit të shërbimeve nga një pikë përfundimtare te pika tjetër përfundimtare të shfrytëzuesve, duke përfshirë edhe mjete për rrjete inteligjente ose roaming te rrjetet mobile,

- interkoneksion të rrjeteve ose të mjeteve të rrjetit,

- të sigurojë qasje te sistemi operativ për përkrahje ose sisteme tjera të softuerit që janë të nevojshme që të garantojnë konkurrencë të drejtë në sigurimin e shërbimeve dhe

- të sigurojë qasje te shërbimet shoqëruese siç janë shërbimi për identifikim, lokacion dhe prezencë.

(4) Për obligimet nga paragrafi (3) i këtij neni, Agjencia mund të shtojë edhe kushte për sigurimin e drejtësisë, arsyeshmërisë dhe përpikshmërisë.

(5) Gjatë miratimit të vendimit për përcaktimin e obligimeve nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, dhe në veçanti gjatë vlerësimit nëse obligimet e këtilla janë adekuate me parimet rregullatore dhe qëllimet nga neni 7 i këtij ligji, Agjencia duhet në veçanti t'i ketë parasysh faktet në vijim:

- aftësinë teknike dhe ekonomike për shfrytëzimin ose vendosjen e kapaciteteve konkurruese, duke pasur parasysh shkallën e zhvillimit të tregut, dhe me këtë rast duke mbajtur llogari për natyrën dhe llojin e interkoneksionit të propozuar dhe/ose qasjes, si dhe për ekzistimin e prodhimeve tjera për qasje, siç është qasja te kanalet,

- realizimin e sigurimit të qasjes së propozuar, duke pasur parasysh kapacitetet në dispozicion,

- investimin fillestar të operatorit nga paragrafi (1) i këtij neni, me këtë rast duke mbajtur llogari për cilindo investim të kryer publik dhe rreziqet për investimin e tillë,

- nevojën për mbrojtje afatgjate të konkurrencës, dhe në veçanti të konkurrencës së bazuar në infrastrukturë efikase ekonomike,

- atje ku është e përshtatshme, cilat do të drejta relevante të pronësisë intelektuale dhe

- sigurim të shërbimeve pan-evropiane.

(6) Gjatë miratimit të vendimit për përcaktimin e obligimeve nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, Agjencia mund të përcaktojë edhe kushte teknike ose operative të cilat doemos duhet t'i plotësojë operatori i cili e siguron qasjen dhe/ose operatori i cili e kërkon qasjen, kur kjo është e nevojshme për shkak të sigurimit të funksionimit normal të rrjetit. Obligimet për respektim të standardeve të veçanta teknike ose specifikeve, doemos duhet të jenë në pajtim me këtë ligj.

Neni 88

Kontrolli i çmimeve dhe obligimet për kontabilitetin e shpenzimeve

(1) Agjencia në pajtim me këtë ligj mundet operatorit me fuqi të konsiderueshme tregu në treg relevant t'i imponojë obligime lidhur me kthimin e shpenzimeve dhe kontroll të çmimeve, duke përfshirë edhe obligime për çmime të bazuara në shpenzime, si dhe obligim për mbajtjen e

kontabilitetit të shpenzimeve që ka të bëjë me sigurimin e llojeve të caktuara të interkoneksionit dhe/ose qasjes, në rastet kur në bazë të analizës së tregut do të përcaktohet mungesë e konkurrencës efektive që i mundëson operatorit t'i mbajë çmimet në nivel të lartë tejmase ose të zbatojë çmime për mënjanimin e konkurrencës, dhe me këtë në dëm të shfrytëzuesve përfundimtarë. Për shkak të stimulimit të investimeve, duke përfshirë gjeneratat e fundit të rrjeteve elektronike komunikuese, Agjencia do t'i ketë parasysh investimet e bëra nga ana e operatorit dhe do t'i mundësojë shkallë të arsyeshme për kthim të kapitalit të investuar, duke i marrë parasysh edhe rreziqet, dhe në veçanti gjatë investimit në projekte të reja të rrjetit.

(2) Agjencia do të sigurojë se të gjithë mekanizmat për kthim të shpenzimeve dhe të gjithë metodologjitë e përcaktuara për përcaktimin e çmimeve do të orientohen drejt nxitjes së konkurrencës efikase dhe të qëndrueshme, si dhe realizimin e volitshmërive më të mëdha për shfrytëzuesit përfundimtarë, me ç'rast mund të merren parasysh edhe çmimet prezente në tregjet krahasimtare konkurrencte.

(3) Operatori të cilit i është imponuar obligimi për çmimet e orientuara në shpenzime, e mban ngarkimin e dëshmisë se çmimet e shërbimeve të tyre dalin nga shpenzimet dhe përfshijnë shkallë të arsyeshme të kthimit të investimeve. Për shkak të përlogaritjes së shpenzimeve për sigurim efikas të shërbimit, Agjencia mund të zbatojë metodologji të kontabilitetit të shpenzimeve, të pavarur nga metodologjia të cilën e zbaton operatori. Agjencia mundet të kërkojë nga operatori, që i njëjti të sigurojë arsyetim të plotë për çmimet e tij, dhe ku është e përshtatshme edhe harmonizim të tyre.

(4) Në raste të imponimit të obligimit për mbajtjen e kontabilitetit të shpenzimeve për shkak të kontrollit të çmimeve, Agjencia shpall përshkrim të sistemit të kontabilitetit të shpenzimeve, i cili në veçanti duhet t'i përmbajë kategoritë kryesore sipas të cilave janë grupuar shpenzimet dhe rregullat për shpërndarjen e shpenzimeve. Kontrolli i harmonizimit të operatorit me sistemin e përcaktuar të kontabilitetit të shpenzimeve kryhet një herë në vit nga ana e revizorit të autorizuar të pavarur, ndërsa konstatimin e revizorit, Agjencia e shpall në ueb faqen e vet në afat prej shtatë ditëve nga dita e pranimit të tij.

Neni 89

Ndarja funksionale

(1) Nëse Agjencia në bazë të analizës së tregut, vlerëson se edhe krahas zbatimit adekuat të obligimeve rregullatore të përcaktuara me nenet 84, 85, 86, 87 dhe 88 të këtij ligji nuk është siguruar konkurrencë efektive, se ekzistojë vështirësi të rëndësishme dhe të përhershme në konkurrencë, dhe/ose mungesa në treg lidhur me sigurimin e shërbimeve të caktuara të shitjes me shumicë në tregun relevant për qasje, mundet si masë e jashtëzakonshme, me vendim t'i imponojë operatorit vertikal të integruar obligim që t'i ndajë aktivitetet lidhur me sigurimin e shërbimeve të caktuara të shitjes me shumicë për qasje në subjektin e veçantë të pavarur afarist.

(2) Subjekti i veçantë afarist nga paragrafi (1) i këtij neni doemos duhet t'u sigurojë prodhime dhe shërbime për qasje të gjithë operatorëve, duke i përfshirë edhe subjektet tjera afariste të operatorit nga paragrafi (1) i këtij neni edhe atë me afate dhe kushte të njëjta, duke përfshirë edhe kushtet që kanë të bëjnë me çmimet dhe nivelin e shërbimeve, si dhe përmes sistemeve dhe proceseve të njëjta.

(3) Para se ta miratojë vendimin nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia është e detyruar të veprojë në pajtim me nenin 13 të këtij ligji.

(4) Vendimi nga paragrafi (1) i këtij neni doemos duhet të përmbajë:

- natyrën e përshkruar qartë dhe nivelin e ndarjes, dhe në veçanti duke e përcaktuar statusin juridik të subjektit të veçantë afarist,

- përcaktim të pronës së subjektit të veçantë afarist, si dhe prodhimeve ose kushteve të cilat ai subjekt afarist do t'i sigurojë,

- dispozita lidhur me menaxhimin me të cilat do të sigurohet pavarësi e të punësuarve në subjektin e veçantë afarist, si dhe sistem adekuat për stimulim,
- rregulla me të cilat do të sigurohet harmonizim me obligimet,
- rregulla me të cilat do të sigurohet transparencë e procedurave operative, në veçanti lidhur me palët tjera të prekura dhe
- program për mbikëqyrje me të cilin do të sigurohet harmonizim, duke përfshirë edhe shpallje të raportit vjetor.

(5) Pas miratimit të vendimit nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia do të zbatojë analizë të tregjeve tjera relevante për qasje, dhe në bazë të analizës së zbatuar Agjencia mund të përcaktojë, mbajë, ndryshojë ose shfuqizojë ndonjë nga obligimet rregullatore të përcaktuara me këtë ligj.

(6) Operatorit të cilit i është imponuar obligimi rregullator nga paragrafi (1) i këtij neni, mund t'i imponohet cilado nga obligimet rregullatore të përcaktuara me këtë ligj, nëse përcaktohet se në tregun adekuat relevant ka fuqi të konsiderueshme tregu.

Neni 90

Ndarja vullnetare nga operatori i integruar vertikal

(1) Operatori i cili ka fuqi të konsiderueshme tregu në një ose më shumë tregje relevante është i detyruar prej më parë dhe në kohë ta njoftojë Agjencinë për qëllimin për bartjen e pronës së rrjetit të vet për qasje lokale ose pjesë të konsiderueshme të pronës personit të veçantë juridik, me pronësi të ndryshme, ose për qëllimin që të themelojë subjekt të veçantë afarist me qëllim që t'u sigurojë të gjithë operatorëve të shërbimeve për shitje me pakicë, duke përfshirë edhe njësitë personale për shitje me pakicë, në tërësi prodhime të njëjta për qasje, operatori gjithashtu, është i detyruar, ta njoftojë Agjencinë për çdo ndryshim të qëllimit, si dhe për të rezultatin përfundimtar nga procesi i ndarjes.

(2) Agjencia do ta vlerësojë efektin nga procesi i planifikuar mbi obligimet ekzistuese ligjore.

(3) Për shkak të plotësimit të vlerësimit nga paragrafi (2) i këtij neni, Agjencia do të zbatojë analizë të koordinuar të tregjeve të ndryshme relevante për qasje, dhe në bazë të analizës së zbatuar Agjencia mund të përcaktojë, mbajë, ndryshojë ose shfuqizojë nga obligimet rregullatore të përcaktuara me këtë ligj.

(4) Personit të përcaktuar juridik ose subjektit të veçantë afarist nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia mund t'i imponojë cilindo nga obligimet rregullatore të përcaktuara me këtë ligj, nëse përcaktohet se në tregun adekuat relevant ka fuqi të konsiderueshme tregu.

Neni 91

Rregullimi i çmimeve për shitje me pakicë

(1) Agjencia mundet operatorit me fuqi të konsiderueshme tregu në treg të përcaktuar për shitje me pakicë, t'i imponojë obligime adekuate rregullatore në pajtim me dispozitat nga ky nen, vetëm nëse në bazë të procedurës së zbatuar të analizës së tregut, përcakton se në atë treg me shitje me pakicë nuk ka konkurrencë efektive dhe se obligimet rregullatore nga nenet 84, 85, 86, 87 dhe 88 të këtij ligji nuk i mundësojnë realizimin e parimeve dhe qëllimeve rregullatore nga neni 7 i këtij ligji.

(2) Obligimet e imponuara në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni do të bazohen në natyrën e problemit të identifikuar dhe do të jenë proporcionale dhe të arsyeshme në pajtim me qëllimet dhe parimet rregullatore nga neni 7 i këtij ligji. Obligimet që i imponohen operatorit munden në veçanti i përmbajnë kërkesë që operatori të mos paguaj çmime shumë të larta të shërbimeve, të mos pengojë hyrje në treg ose të mos e kufizojë konkurrencën me futjen e çmimeve predatory, pa arsye të mos u japë privilegje shfrytëzuesve të caktuar përfundimtarë, ose pa arsye t'i lidhë shërbimet në pako.

(3) Për shkak stimulimit të konkurrencës efikase dhe mbrojtjes së interesave të shfrytëzuesve përfundimtarë, Agjencia mundet operatorit nga paragrafi (1) i këtij neni t'ia imponojë masat në vijim:

- kufizimin e çmimit për shitje me pakicë (Price Cap regime),
- kontroll të çmimeve individuale,
- çmime të orientuara sipas shpenzimeve ose
- çmime sipas çmimeve të tregjeve krahasimtare.

(4) Operatorit të cilit i është imponuar obligimi për rregullimin e çmimeve për shitje me pakicë ose obligimi për kontrole tjera relevante të çmimeve për shitje me pakicë, doemos duhet të implementojë sistem adekuat të shpenzimeve të kontabilitetit. Agjencia mundet ta përcaktojë formën dhe metodologjinë e kontabilitetit që do ta shfrytëzojë operatori. Harmonizimi me sistemin e kontabilitetit të shpenzimeve kryhet një herë në vit nga ana e revizorit të autorizuar të pavarur, ndërsa konstatimin e revizorit, Agjencia e shpall në ueb faqen e vet në afat prej shtatë ditëve nga dita e pranimit të tij.

(5) Agjencia mundet t'i rregullojë çmimet e shitjes me pakicë të shërbimeve në tregun relevant ku ekziston konkurrencë efektive vetëm kur është e nevojshme të sigurohet:

- qasshmëri e çmimeve të veçanta të përshtatura për nevojat e grupeve të cënueshme sociale për shfrytëzuesit përfundimtarë të shërbimeve në pajtim me ligjin dhe
- mundësi për shfrytëzuesit përfundimtarë të shërbimeve universale të mos paguajnë domosdo shpenzime plotësuese të cilat nuk janë të nevojshme për sigurimin e atyre shërbimeve.

Kapitulli i dymbëdhjetë

SIGURIMI I SHËRBIMIT UNIVERSAL

Neni 92

Qasshmëria te shërbimi universal

(1) Shërbimet e përcaktuara në këtë kapitull të ligjit duhet me kualitet të përcaktuar dhe me çmim të pranueshëm t'u jenë të qasshme të gjithë shfrytëzuesve përfundimtarë në Republikën e Maqedonisë, pa dallim të lokacionit të tyre gjeografik.

(2) Agjencia me akt nënligjor në mënyrë më të hollësishme do ta përcaktojë mënyrën e sigurimit të shërbimeve nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 93

Sigurimi i qasjes së lokacionit fiks dhe sigurimi i shërbimeve telefonike

(1) Agjencia do të caktojë së paku një dhënës të shërbimit universal që do të sigurojë lidhje të shfrytëzuesit përfundimtar në lokacionin fiks me rrjet publik komunikues, në bazë të kërkesës së tij të arsyeshme.

(2) Lidhja nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të ketë mundësi të mbështet fjalim, faksimile dhe transmetim të të dhënave me shpejtësi të mjaftueshme që të sigurohet qasje efikase në internet, në pajtim me aktin nënligjor të nenit 92 paragrafi (2) të këtij ligji.

(3) Dhënësi i shërbimit universal nga paragrafi (1) i këtij neni është i detyruar që shfrytëzuesit përfundimtar, në bazë të kërkesës së tij të arsyeshme t'i mundësojë thirrje nisëse dhe hyrëse në qarkullimin telefonik nacional (vendas) dhe ndërkombëtar.

Neni 94

Sigurimi i regjistrit të plotë telefonik dhe shërbimi i plotë telefonik për informata

(1) Agjencia me akt nga neni 92 paragrafi (2) të këtij ligji e përcakton formën dhe përmbajtjen e regjistrit të plotë telefonik ku evidentohen të gjithë parapaguesit në Republikën e Maqedonisë dhe i njëjti mund të botohet në formë të shtypur dhe/ose elektronike.

(2) Shërbimi i plotë telefonik për informata është i detyruar t'u sigurojë informata nga regjistri i plotë telefonik të gjithë shfrytëzuesve përfundimtarë në Republikën e Maqedonisë, duke i përfshirë edhe shfrytëzuesit e kabinave publike telefonike.

(3) Agjencia do të caktojë së paku një dhënës të shërbimit universal për sigurimin e regjistrit të plotë telefonik për parapaguesit në Republikën e Maqedonisë dhe do të caktojë së paku një dhënës të shërbimit universal për sigurimin e shërbimit të plotë telefonik për informata, në kushte dhe në mënyrë të përcaktuara në nenin 97 të këtij ligji.

(4) Personat juridikë dhe fizikë të cilët kryejnë veprim janë të detyruar të japin të dhëna për së paku një numër telefonik që do të shpallet në regjistrin e plotë telefonik.

(5) Të dhënat në regjistrin e plotë telefonik duhet rregullisht të azhurnohen, e së paku një herë në vit. Të dhënat që i mban shërbimi i plotë telefonik për informata duhet të azhurnohen së paku një herë në muaj.

(6) Operatorët të cilët parapaguesve u ndajnë numra telefonikë janë të detyruar të dhënat për parapaguesit e tyre t'ua dorëzojnë dhënësve të shërbimit universal, në pajtim me nenin 112 të këtij ligji.

(7) Dhënësit e shërbimit universal janë të detyruar të dhënat nga paragrafi (6) i këtij neni pa përjashtim t'i përfshijnë në regjistrin e plotë telefonik dhe në evidencën e shërbimit telefonik për informata. Dhënësit e shërbimit universal duhet menjëherë ta njoftojnë Agjencinë, nëse ndonjëri nga operatorët nuk i dorëzon të dhënat e kërkuara, me ç'rast Agjencia e detyron operatorin t'i dorëzojë të dhënat e kërkuara te dhënësit e shërbimit universal në afatin e caktuar.

Neni 95

Kabinat publike telefonike ose pikat tjera publike qasëse për sigurimin e shërbimeve telefonike të bisedave

(1) Agjencia mund të caktojë një ose më shumë dhënës të shërbimit universal për sigurimin e kabinave publike telefonike ose pikave tjera qasëse publike për sigurimin e shërbimeve telefonike për biseda me qëllim që të përmbushen nevojat e arsyeshme të shfrytëzuesve përfundimtarë në aspekt të mbulimit gjeografik, numrit të kabinave telefonike ose pikave tjera qasëse, me mundësi për qasje të shfrytëzuesve përfundimtarë me invaliditet dhe me kualitet adekuat të shërbimit në pajtim me nenin 103 të këtij ligji.

(2) Dhënësi i shërbimit universal nga paragrafi (1) i këtij neni është i detyruar të sigurojë nga kabinat publike telefonike, pa kompensim të kërkohen numrat e shërbimeve për thirrje urgjente.

(3) Agjencia në bazë të debatit publik me palët e interesuara, në pajtim me këtë ligj, mundet të vendosë të mos e imponojë obligimin nga paragrafi (1) i këtij neni në tërë territorin ose në një pjesë të territorit të Republikës së Maqedonisë, nëse vlerëson se këto mjete ose shërbime komparative janë të qasshme gjerësisht.

Neni 96

Masa për persona me invaliditet

(1) Dhënësit e shërbimit universal duhet të marrin masa të posaçme me qëllim që personave me invaliditet t'u sigurohet qasje tek shërbimi dhe pranueshmëri të çmimeve të shërbimeve të caktuara në nenet 93 paragrafi (3) dhe 94 të këtij ligji, ekuivalentë me ato që i kanë shfrytëzuesit tjerë përfundimtarë në Republikën e Maqedonisë.

(2) Dhënësit e shërbimit universal duhet të sigurojnë shërbime përkatëse, pajisje terminale për qasje tek shërbimi, transmetim të të dhënave me shpejtësi të mjaftueshme që të sigurohet qasje efikase në internet, në pajtim me aktin nënligjor nga neni 92 paragrafi (2) i këtij ligji, për nxënësit me nevoja të posaçme arsimore në shkollat e rregullta dhe të veçanta fillore dhe të mesme, në pajtim me ligjet për arsimin fillor dhe të mesëm në Republikën e Maqedonisë.

(3) Agjencia me aktin nga neni 92 paragrafi (2) i këtij ligji në mënyrë të detajuar do t'i përcaktojë masat nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni.

Neni 97

Caktimi i një ose më shumë dhënësve të shërbimit universal

(1) Të gjithë shfrytëzuesve të fundit në territorin e Republikës së Maqedonisë doemos duhet t'i kenë të kapshme të gjitha shërbimet e përfshira me shërbimin universal në pajtim me këtë ligj.

(2) Agjencia mund të caktojë një ose më shumë dhënës të shërbimeve universale që të sigurohen shërbimet e përcaktuara në nenet 93, 94, 95, 96 dhe 99 paragrafi (4) të këtij ligji me qëllim që të sigurohet që të njëjtët të jenë të kapshme në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë. Agjencia mund të caktojë dhënës ose dhënës të shërbimeve universale të cilët do të sigurojnë shërbime të ndryshme dhe/ose do të mbulojnë pjesë të ndryshme nga territori i Republikës së Maqedonisë.

(3) Për caktimin e një ose më shumë dhënësve të shërbimeve universale, Agjencia shpall tender publik për zgjedhje të një ose më shumë dhënësve të shërbimit universal.

(4) Agjencia para se ta zbatojë procedurën e tenderit publik nga paragrafi (3) i këtij neni shpall qëllim për zbatimin e të njëjtit, me qëllim që të mundësohet debat publik. Debat publik nuk guxon të zgjatë më shkurtër se 30 ditë nga dita e shpalljes të qëllimit për zbatim të procedurës së tenderit publik.

(5) Agjencia qëllimin nga paragrafi (4) i këtij neni, e shpall në së paku dy gazeta ditore nga të cilat njëra gazetë ditore është në gjuhën e bashkësisë e cila nuk është shumicë, e që e flasin së paku 20% nga qytetarët e Republikës së Maqedonisë. Para se ta shpall qëllimin, Agjencia është e detyruar të kërkojë mendim nga ministri kompetent për komunikime elektronike.

(6) Shpallja për qëllimin nga paragrafi (4) i këtij neni posaçërisht përmban:

- shërbimet e përfshira me shërbimin universal që do të jenë lëndë e tenderit publik,
- numrin e dhënësve për sigurimin e shërbimeve të përfshira me shërbimin universal që do të jenë lëndë e tenderit publik,
- mënyrën e mbulimit të territorit të Republikës së Maqedonisë me shërbimet e përfshira në shërbimin universal që do të jenë lëndë e tenderit publik,
- kriteret për zgjedhjen e dhënësit të shërbimit universal dhe
- arsyetim për qëllimin për publikimin e tenderit publik.

(7) Agjencia në ueb faqen e saj do t'i publikojë rezultatet e debatit publik, si dhe qëndrimin e saj lidhur me të njëjtat.

(8) Drejtori i Agjencisë është i detyruar në afat jo më të gjatë se 90 ditë nga dita e publikimit të qëllimit nga paragrafi (4) i këtij neni, ndërsa duke i pasur parasysh rezultatet e paragrafit (7) të këtij neni, të miratojë vendim për shpalljen e tenderit publik për zgjedhjen e një ose më shumë dhënësve të shërbimit universal. Para se ta miratojë vendimin, drejtori i Agjencisë është i detyruar të kërkojë pëlqim nga ministri kompetent për komunikime elektronike. Ministri kompetent për komunikime elektronike është i detyruar që të përgjigjet në kërkesën për pëlqim në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të kërkesës, në pajtim me Ligjin për procedurën e përgjithshme administrative.

(9) Gjatë caktimit të dhënësit ose dhënësve të shërbimit universal, Agjencia doemos duhet t'i zbatojë principet e objektivitetit, transparencës, efikasitetit dhe mosdiskriminimit me ç'rast asnjë person juridik ose fizik i cili kryen veprimtari paraprakisht nuk do të përjashtohet nga procedura e zgjedhjes së dhënësit të shërbimit universal.

(10) Agjencia për përcaktimin e kriterëve për zgjedhje të një ose më shumë dhënësve të shërbimit universal posaçërisht duhet të mbajë llogari, që sigurimi i shërbimit universal të bëhet në mënyrë shpenzuese-efikase që mund të përdoret gjatë përcaktimit të neto shpenzimeve për sigurimin e shërbimit universal konkret në pajtim me nenin 105 të këtij ligji.

(11) Nëse gjatë procedurës së tenderit nuk bëhet zgjedhja e dhënësit të shërbimit universal, Agjencia mund të miratojë vendim me të cilin do të përcaktojë një ose më shumë dhënës të shërbimit universal. Agjencia si dhënës i shërbimit universal mund ta përcaktojë operatorin me fuqi të konsiderueshme tregu të shërbimeve telefonike publike të lokacionit fiks të caktuar ose operatorit me numër më të madh të parapaguesve të shërbimeve telefonike publike të lokacionit fiks të caktuar. Gjatë miratimit të vendimit, Agjencia doemos duhet t'i zbatojë principet e efektivitetit, objektivitetit dhe transparencës.

(12) Agjencia lidh marrëveshje për periudhë prej pesë viteve me dhënësin e shërbimit universal.

(13) Agjencia në vazhdimësi e përcjell punën e dhënësit të shërbimit universal, ndërsa ofruesi është i detyruar në Agjenci të dërgojë të dhëna për punën e tij, në pajtim me këtë ligj.

(14) Agjencia është e detyruar së paku gjashtë muaj para skadimit të periudhës nga paragrafi (12) të këtij neni, ndërsa në bazë të të dhënave të marra të lidhura me sigurimin e shërbimit të përfshirë me shërbimin universal dhe mendimet e marra nga palët e interesuara që ta përcaktojë nevojën nga ridefinimi i kushteve për sigurimin e atij shërbimi.

Neni 98

Bartja e rrjetit të qasshëm lokal

(1) Ofruesi i shërbimit universal nëse ka për qëllim që t'a bartë rrjetin e tij të qasshëm lokal, në tërësi ose pjesë më të madhe të tij, personit tjetër juridik i cili ka strukturë tjetër pronësore, është i detyruar për atë paraprakisht, por jo më vonë se 60 ditë nga dita e bartjes së planifikuar me shkrim ta njoftojë Agjencinë.

(2) Agjencia pas pranimit të njoftimit nga paragrafi (1) i këtij neni përcakton nëse qëllimi i paragrafit (1) të këtij neni do të kishte ndikim në sigurimin e qasjes të lokacionit fiks dhe sigurimi i shërbimeve të qasshme telefonike publike nga neni 93 i këtij ligji. Me këtë rast, Agjencia, mundet dhënësit të shërbimit universal t'i imponojë, ndryshim ose shfuqizim të obligimeve të përcaktuara të cilat dalin nga sigurimi i shërbimit universal. Nëse për shkak të bartjes nuk sigurohet shërbimi i përfshirë me shërbimin universal në pjesë të caktuara ose në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë, Agjencia do të caktojë ofrues të ri të shërbimit universal në bazë të nenit 97 të këtij ligji.

Neni 99

Sigurimi i çmimeve të pranueshme për shërbimet e përfshira me shërbimin universal

(1) Agjencia kryen mbikëqyrje në zhvillimin dhe nivelin e çmimeve për shitje me pakicë të shërbimeve të përfshira në shërbimin universal nga nenet 93, 94, 95 dhe 96 të këtij ligji.

(2) Çmimet e shërbimeve individuale të përfshira në shërbimin universal doemos duhet të jenë të barabarta në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

(3) Agjencia mundet nga ofruesi i shërbimit universal të kërkojë që i njëjti t'i adaptojë çmimet e shërbimeve individuale që i ofron si shërbim universal, nëse në bazë të mbikëqyrjes nga paragrafi (1) i këtij neni konstaton se çmimet nuk janë të pranueshme ose se nuk janë të njëjta në tërë territorin e Republikës së Maqedonisë.

(4) Në rastet nga paragrafi (3) i këtij neni Agjencia mund ofruesve të shërbimeve universale t'u imponojë obligim për kufizimin e çmimeve për shitje me pakicë (price cap), ose formim të çmimit të njëjtë për sigurimin e shërbimit në bazë të mesatares gjeografike në territorin e Republikës së Maqedonisë.

(5) Ofruesit e shërbimit universal duhet të ofrojnë çmime të posaçme ose pako, që dallohen nga ato që sigurohen në bazë të kushteve komerciale standarde me qëllim që shfrytëzuesve përfundimtarë me status të rastit social dhe/ose shfrytëzuesve të fundit me nevoja të posaçme speciale në pajtim me ligj, t'u sigurohet shfrytëzim i shërbimeve të përfshira me shërbimin universal.

(6) Ofruesi i shërbimit universal është i detyruar që çmimet e shërbimeve individuale që i siguron si shërbim universal t'i publikojë në ueb faqen e tij dhe/ose në mënyrë në të cilën do të jenë të qasshme për publikun.

Neni 100

Kontrolli i shpenzimeve

(1) Dhënësit e shërbimit universal janë të detyruar që t'i përcaktojnë çmimet për sigurimin e shërbimit universal ashtu që parapaguesit e shërbimeve të caktuara që sigurohen si shërbim universal nuk detyrohen që të paguajnë për mjetet ose shërbimin që nuk janë të domosdoshme ose nuk janë të nevojshme për sigurimin e shërbimit universal.

(2) Dhënësi i shërbimit universal është i detyruar që parapaguesve të vet t'u sigurojë mundësi për kontroll të shpenzimeve përmes:

- llogarisë së detajuar në pajtim me nenin 101 të këtij ligji,
- ndalimit selektiv falas për thirrje nisëse ose për porosi SMS/MMS me vlerë të shtuar, ndërsa kur është teknikisht e mundur edhe për aplikime tjera të ngjashme,
- mundësisë për pagesë paraprake për qasje në rrjetit komunikues elektronik publik dhe shfrytëzimin e shërbimeve telefonike publikisht të qasshme,
- mundësisë për pagesë të prolonguar të çmimit për kyçje në rrjetin komunikues elektronik publik,
- kufizimit të qasjes të shërbimet ose shkyçje të parapaguesit në pajtim me nenin 102 të këtij ligji,
- këshilla për çmime me atë që u sigurohet mundësi parapaguesve që të marrin informata për çmimet më të ulëta alternative për shërbimin, nëse ekzistojnë dhe
- paralajmërim falas në rast të shpenzimeve të bëra të pazakonshme ose tejmase për shërbimin.

Neni 101

Obligimi për lëshimin e llogarisë detale

(1) Ofruesi i shërbimit universal është i detyruar që parapaguesve të tij tu dorëzojë llogari detale me çka do tu mundësojë kontroll të shpenzimeve për sigurimin e shërbimit.

(2) Llogaria detale e paragrafit (1) të këtij neni nuk i përfshin thirrjet e numrave falas dhe numrave të shërbimeve për thirrje urgjente.

(3) Llogaria detale e paragrafit (1) të këtij neni u jepet falas parapaguesve, përveç atyre të cilët me shkrim e kanë njoftuar ofruesin e shërbimit se duan tu dërgohet llogari jo-detale.

(4) Agjencia me akt nënligjor të nenit 92 paragrafit (2) të këtij ligji e përcakton minimumin që duhet ta përmbajnë llogaritë e paragrafëve (1) dhe (3) të këtij neni.

(5) Gjatë sigurimit të llogarive të paragrafëve (1) dhe (3) të këtij neni ofruesi i shërbimit universal është i obliguar që ta zbatojë të drejtën për mbrojtjen e të dhënave personale dhe privatësisë, në pajtim me këtë ligj dhe me ligj tjetër.

Neni 102

Kufizimi i qasjes te shërbimet ose shkyçja e parapaguesit

(1) Ofruesi i shërbimit universal mund ta kufizojë qasjen te shërbimet e tij dhe/ose mund ta përjashtojë parapaguesin dhe ta prish marrëveshjen për kyçje dhe shfrytëzim të rrjetit komunikues publik dhe /ose shërbimeve komunikuese elektronike publike të qasshme vetëm në rast kur parapaguesi ka kryer shkelje të kushteve të theksuara në marrëveshje.

(2) Ofruesi i shërbimit universal në marrëveshjen e paragrafit (1) të këtij neni është i obliguar që t'i theksojë masat të cilat ndërmerren për shkelje të caktuara, si dhe për periudhën në të cilën ato do të zbatohen, me ç'rast duhet të jenë proporcionale dhe jodiskriminuese.

(3) Në rast të shkeljes, ofruesi i shërbimit universal është i obliguar me shkrim ta njoftojë parapaguesin për shkeljen dhe masën që do ta ndërmerr dhe t'i caktojë afat të arsyeshëm për plotësimin e obligimeve të kontraktuara.

(4) Ofruesit e shërbimit universal nuk janë të obliguar paraprakisht t'i njoftojnë parapaguesit në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni, nëse me shkeljen shkaktohet kërcënim serioz dhe momental i rendit publik, sigurisë publike, shëndetit të njerëzve dhe mjedisit jetësor ose shkaktohet dëm i madh material ose operativ.

(5) Mospagesa e llogarisë nuk konsiderohet për shkelje në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni, ndërsa ofruesi i shërbimit universal është i obliguar që të veprojë në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni.

(6) Nëse është e mundur teknikisht, ofruesi i shërbimit universal duhet doemos ta kufizojë qasjen vetëm për ato shërbime të cilat parapaguesi i ka shkelur, përveç në rast të abuzimit, vonesës së vazhdueshme të pagesës ose mospagesës së faturave. Ofruesit e shërbimit universal nuk mund ta kufizojnë qasjen dhe shfrytëzimin e numrave të shërbimeve për thirrje urgjente.

Neni 103

Kualiteti i shërbimit universal

(1) Agjencia me akt nënligjor të nenit 92 të këtij ligji e përcakton kualitetin e kushteve të përfshira me shërbimin universal, e posaçërisht parametrat për kualitet, vlerat e tyre matëse dhe mënyrën e matjes së tyre, ndërsa mund të përcaktojë edhe parametra plotësues për kualitet të shërbimeve për shfrytëzues të fundit dhe konsumatorë me invaliditet.

(2) Ofruesit e shërbimit universal janë të obliguar që t'i publikojnë të dhënat për kualitetin e shërbimeve të përfshira me shërbimin universal dhe t'i publikojnë ato në Agjenci, në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni.

(3) Agjencia me aktin e paragrafit (1) të këtij neni e përcakton edhe përmbajtjen, formën, mënyrën dhe periudhën e publikimit të të dhënave për kualitetin e shërbimeve të përfshira me shërbimin universal, me qëllim që konsumatorëve dhe shpenzuesve tu sigurohet qasje te informatat e plota, krahasuese dhe të kuptueshme (user - friendly), si dhe afatin dhe mënyrën e dorëzimit të të dhënave në Agjenci.

(4) Agjencia, në pajtim me këtë ligj kryen mbikëqyrje të kualitetit të shërbimeve të përfshira me shërbimin universal.

(5) Nëse Agjencia ka dyshime elementare në vërtetësinë e të dhënave nga paragrafi (2) i këtij neni, ajo me detyrë zyrtare mund të realizojë procedurë të revizionit nëpërmjet shoqërisë së pavarur për revizion në shpenzim të ofruesit të shërbimit universal.

(6) Nëse ofruesit e shërbimit universal nuk i arrijnë parametrat për kualitet tre herë në mënyrë të njëpasnjëshme, Agjencia mund të fillojë procedurë për largim të ofruesit ekzistues dhe të caktojë ofrues të ri të shërbimit universal.

Neni 104

Shpejtësia e bartjes së të dhënave për qasje efikase në internet

(1) Agjencia me akt nënligjor të nenit 92 të këtij ligji e përcakton shpejtësinë e bartjes së të dhënave me qëllim që të sigurohet qasje efikase në internet, si dhe afat kohor në të cilin ajo do të sigurohet, i cili nuk mund të jetë më i gjatë se dy vjet. Agjencia gjatë kësaj i merr parasysh teknologjitë dhe shpejtësitë e bartjes së të dhënave që janë shfrytëzuar nga pjesa më e madhe e parapaguesve si dhe teknikën e realizimit me dëmtime minimale të tregut.

(2) Agjencia me aktin nënligjor të paragrafit (1) të këtij neni mund të përcaktojë shpejtësi tjetër të bartjes së të dhënave nëse përcakton se më së paku gjysma e ekonomive familjare në Republikën e Maqedonisë shfrytëzojnë qasje me brez të gjerë në Internet, kjo shpejtësi për bartjen e të dhënave përcaktohet si shpejtësi të cilën e shfrytëzojnë 80% ekonomive familjare në Republikën e Maqedonisë që shfrytëzojnë qasje në internet me brez të gjerë.

(3) Para se ta përcaktojë shpejtësinë e bartjes së të dhënave të paragrafit (2) të këtij neni, Agjencia duhet të bëjë analizë me qëllim që ta përcaktojë ndikimin e shpejtësisë për bartjen e të dhënave në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror, zhvillimin e tregut, konkurrencën dhe të ngjashme, ndërsa gjatë kësaj duke i pasur parasysh shpenzimet për zbatimin e të njëjtës. Analizën, së bashku me propozimin e aktit nënligjor nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia i publikon në ueb faqen e saj me qëllim që të sigurohet debat publik në pajtim me këtë ligj.

(4) Pas kalimit të afatit në paragrafin (1) të këtij neni, Agjencia përsëri i rihulumton rrethanat në bazë të të cilave është përcaktuar shpejtësia për bartjen e të dhënave dhe nëse është e nevojshme me akt nënligjor të paragrafit (1) të këtij neni do të caktojë shpejtësi të re për bartjen e të dhënave.

Neni 105

Kompensimi i neto shpenzimeve për sigurimin e shërbimit universal

(1) Ofruesi i shërbimit universal ka të drejtë kompensimi të neto shpenzimeve për sigurimin e shërbimit të përfshirë me shërbimin universal nga nenet 93, 94, 95, 96 dhe 99 paragrafi (4) të këtij ligji, nëse sigurimi i këtyre shërbimeve për atë paraqet ngarkim të padrejtë. Nëse Agjencia konstaton se ekziston ngarkim të njëjtin do ta përllogarisë si neto shpenzim për sigurimin e shërbimit konkret universal.

(2) Neto shpenzimet e paragrafit (1) të këtij neni përllogariten si dallim në mes të shpenzimeve për sigurimin e shërbimit universal dhe neto shpenzimeve të cilat ofruesi i shërbimit universal do t'i kishte pasur kur nuk do të ishte ofrues i shërbimit universal me ç'rast merret fitimi i vlerësuar dhe volitshmëritë jomateriale që i ka ofruesi i shërbimit universal gjatë sigurimit të shërbimit universal.

(3) Agjencia me akt nënligjor të nenit 92 të këtij ligji e përcakton mënyrën e përllogaritjes së neto shpenzimeve.

(4) Ofruesi i shërbimit universal është i detyruar deri më 31 maj në vitin rrjedhës te Agjencia të dorëzojë kërkesë për arkëtimin e mjeteve për kompensim të neto shpenzimeve nga paragrafi (1) i këtij neni me të cilin është i detyruar të dorëzojë të dhëna të kontabilitetit dhe /ose informata të cilat janë bazë për përllogaritjen e neto shpenzimeve për sigurimin e shërbimit universal për vitin paraprak. Në të kundërtën, ofruesi i shërbimit universal do ta humb të drejtën që të kërkojë kompensim të neto shpenzimeve për sigurimin e shërbimit universal.

(5) Agjencia ose revizori i pavarur i aprovuar nga ana e Agjencisë i revidon ose kontrollon të dhënat nga paragrafi (4) i këtij neni.

(6) Agjencia i përllogaritë neto shpenzimet për sigurimin e shërbimit universal, me ç'rast i ka parasysh dispozitat e paragrafëve (1) dhe (2) të këtij neni. Neto shpenzimet e përllogaritura dhe konkluzionet e revizionit nga paragrafi (5) i këtij neni, Agjencia i publikon në ueb faqen e saj.

(7) Nëse Agjencia, në bazë të neto shpenzimeve të përlllogaritura konstaton se ato paraqesin ngarkim të padrejtë për ofruesin e shërbimit universal, drejtori i Agjencisë do të miratojë aktvendim me të cilin do ta përcaktojë shumën e mjeteve për kompensim të ngarkimit të padrejtë i cili mund të jetë më i madh nga neto shpenzimet e përlllogaritura, të cilat ofruesit të shërbimit universal do t'i arkëtohen nga fondi kompensues për shërbim universal nga neni 106 i këtij ligji. Afati për arkëtim të neto shpenzimeve nuk mund të jetë më i gjatë se 30 ditë nga dita e miratimit të aktvendimit.

(8) Nëse ofruesi i shërbimit universal është zgjedhur në tender publik, gjatë aprovimit të neto shpenzimeve duhet të merren parasysh neto shpenzimet për sigurimin e shërbimeve universale që i ka ofruar ai ofrues i shërbimeve në tenderin publik. Agjencia do ta pranojë dallimin në neto shpenzimet, vetëm në rastet kur kushtet të cilat kanë ekzistuar gjatë kohës së tenderit publik janë ndryshuar dhe kur ofruesi i shërbimit universal e ka dëshmuar para Agjencisë arsyen e heqjes dorë nga neto shpenzimet në bazë objektive dhe transparente.

Neni 106

Fondi kompensues për shërbim universal

(1) Fondin kompensues për shërbim universal e formon Agjencia në mënyrë që hapë llogari të posaçme bankare dhe mban kontabilitet të posaçëm dhe i njëjti dedikohet për arkëtim të mjeteve për kompensim të neto shpenzimeve për sigurim të shërbimit universal në pajtim me nenin 105 të këtij ligji.

(2) Mjetet e fondit nga paragrafi (1) i këtij neni sigurohen nga operatorë në territorin e Republikës së Maqedonisë të cilët kanë minimum bruto të ardhura nga sigurimi i rrjeteve komunikuese elektronike publike, që e përcakton Agjencia me akt nënligjor nga neni 92 i këtij ligji.

(3) Agjencia me vendim i përcakton shumat e mjeteve të cilat operatorët e paragrafit (2) të këtij neni i paguajnë në fondin e paragrafit (1) të këtij neni dhe të cilët nuk mund të jenë më të larta se 0,5% nga të ardhurat e përgjithshme që i ka operatori nga sigurimi i rrjeteve dhe/ose shërbimeve rrjeteve komunikuese elektronike publike.

(4) Operatorët nga paragrafi (2) i këtij neni janë të obliguar që t'i paguajnë mjetet nga paragrafi (3) i këtij neni në afat të caktuar me vendim të Agjencisë nga paragrafi (3) i këtij neni. Afati për pagesën e shumës nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga dita e pranimit të vendimit.

(5) Deri më 31 mars çdo vit operatorët nga paragrafi (2) i këtij neni janë të obliguar që në Agjenci të dorëzojnë të dhëna për të ardhurat e realizuara nga kryerja e punëve me rrjetet komunikuese publike dhe ofrimin e shërbimeve komunikuese në Republikën e Maqedonisë në vitin paraprak. Nëse operatori nuk e bënë këtë, Agjencia do t'i shfrytëzojë të dhënat për të ardhurat e përgjithshme të operatorit nga viti paraprak të marra nga Drejtoria e të Hyrave Publike të Republikës së Maqedonisë.

(6) Nëse Agjencia fillimisht dyshon në vërtetësinë e të dhënave të dorëzuara nga operatori nga paragrafi (2) i këtij neni, Agjencia ose revizori i autorizuar i Agjencisë mund të bëjë vlerësim të të ardhurave të tij. Nëse të ardhurat e vlerësuara dukshëm dallohen nga të dhënat për të ardhurat nga paragrafi (5) i këtij neni, Agjencia në përlllogaritjen e saj i merr parasysh të ardhurat e vlerësuara.

Кapитulli i trembëdhjetë

TË DREJTAT E SHRYTËZUESVE TË FUNDIT

Neni 107

Marrëveshja për kyçje dhe shfrytëzim të rrjetit komunikues publik dhe/ose shërbimeve komunikuese elektronike publikisht të qasshme

(1) Konsumator ose shfrytëzues i fundit i cili kërkon kyçje dhe shfrytëzim të rrjetit komunikues dhe/ose shërbimeve komunikuese elektronike publikisht të qasshme ka të drejtë të lidh marrëveshje me operatorin për kyçje dhe shfrytëzim të rrjetit komunikues publik dhe/ose shërbimeve komunikuese elektronike publikisht të qasshme. Marrëveshja e cila duhet të jetë e qartë, gjithëpërfshirëse është formë e qasshme e lehtë, posaçërisht duhet të përmbajë:

(a) emrin dhe adresën e operatorit;

(b) shërbimet të cilat do të sigurohen, posaçërisht duke përfshirë:

- informata për atë nëse sigurohet shërbimi për qasje te shërbimet për thirrje urgjente dhe informata për lokacionin e personit i cili e realizon thirjen, si dhe të gjitha kufizimet për sigurimin e shërbimit për qasje te shërbimet për thirrje urgjente në pajtim me këtë ligj,

- informata për të gjitha kushtet të cilat e kufizojnë qasjen dhe/ose shfrytëzimin e shërbimeve dhe aplikimeve, në pajtim me këtë ligj ose me ligj tjetër,

- informata për nivelin minimal të kualitetit të shërbimit i cili sigurohet, posaçërisht afati për kyçjen fillestare, dhe kur është e përshtatshme, parametra tjerë për kualitetin shërbimit në pajtim me nenin 109 të këtij ligji,

- informata për cilat do procedura të përcaktuara nga operatori për matjen dhe formësimin e komunikacionit me qëllim që të mënjanohet mbingarkimi i rrjetit, si dhe informata për atë se si këto procedura do të kishin ndikuar në kualitetin e shërbimit,

- llojet e shërbimeve për mbajtjen e shërbimeve të parapara për mbështetjen e shfrytëzuesve, si dhe mënyrat për vendosjen e kontaktit me këto shërbime, dhe

- të gjitha kufizimet të imponuara nga operatori në lidhje me shfrytëzimin e pajisjes terminale;

(v) mundësi për parapaguesit që të shprehen për kyçjen në të dhënat e tyre personale dhe të cilat prej tyre do të kyçen në listat e emrave të telefonit dhe shërbimet telefonike për informata, në pajtim me nenin 112 të këtij ligji;

(g) informata për çmimet dhe tarifën, mënyrën e marrjes së informatave më të reja për të gjitha tarifën e vlefshme dhe kompensime për mbajtjen, si dhe mënyrat e mundshme për pagesë, duke i përfshirë edhe të gjitha dallimet në shpenzimet që dalin nga mënyrat e mundshme të pagesës;

(d) kohëzgjatjen e marrëveshjes nga paragrafi (1) i këtij neni dhe kushtet për ripërtëritjen dhe ndërprerjen e shërbimeve dhe të marrëveshjes, përfshirë edhe:

- afatin minimal të shfrytëzimit të shërbimeve me kushte promovuese të përcaktuara me oferta të posaçme,

- të gjitha detyrimet të lidhura me transponimin e numrave dhe identifikatorëve tjerë dhe

- të gjitha detyrimet të cilat dalin nga ndërprerja e marrëveshjes nga paragrafi (1) i këtij neni, duke përfshirë edhe kthimin e shpenzimeve në lidhje me pajisjen terminale;

(gj) të gjitha mënyrat e kompensimit dhe kthimit të mjeteve financiare në rast të mosplotësimin të nivelit kontraktues të kualitetit të shërbimit të siguruar;

(e) procedurën për zgjedhjen e ankesës në pajtim me nenin 53 të këtij ligji;

(zh) të gjitha llojet e aktiviteteve të cilat operatori mund t'i ndërmarrë me qëllim që ta ruajë sigurinë ose integritetin e tij si përgjigje e incidenteve, kërcënimeve dhe shkeljeve, në pajtim me këtë ligj;

z) mënyrën e informimit të parapaguesve për ndryshimet e planifikuara në kushtet e theksuara në marrëveshje nga paragrafi (1) i këtij neni dhe mënyrën e pranimit të kushteve të reja për vazhdimin ose ndërprerjen e marrëveshjes;

x) procedurat në rast të mospagesës ose pagesës me kohë të kompensimit të shërbimeve;

i) informatat posaçërisht të dedikuara për persona me invaliditet;

j) dispozita tjera në marrëveshje me parapaguesin.

(2) Marrëveshja e paragrafit (1) i këtij neni duhet të përmbajë edhe dispozita se parapaguesi duhet të informohet për të gjitha ndryshimet e propozuara në kushtet e përmendura në marrëveshje në afat jo më të shkurtër se 30 ditë para vendosjes së ndryshimeve, si dhe për të drejtën se në periudhën e njëjtë, pa njoftim ose pasoja mund ta ndërpresë marrëveshjen nëse nuk pajtohet me ndryshimet e propozuara. Formën dhe mënyrën e informimit të parapaguesve e përcakton Agjencia me akt nënligjor nga neni 108 paragrafi (2) të këtij ligji.

(3) Nëse operatori nuk vepron në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni, kjo nuk do t'i lirojë parapaguesit nga pagesa e obligimeve të arritura dhe të papaguara ose nga plotësimi i detyrimeve të marrëveshjes të arritura para ndryshimeve të bëra në kushtet e përmendura në marrëveshjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

(4) Marrëveshja e paragrafit (1) të këtij neni duhet të përmbajë edhe dispozita se operatori parapaguesit do t'i dorëzojë informata të cilat mund të jenë të sigurta nga organet publike përkatëse në pajtim me nenin 108 paragrafi (4) të këtij ligji.

(5) Operatorët mund t'i marrin këto të dhëna nga parapaguesit e tyre:

- emrin ose titullin e parapaguesit,

- numrin amë për personat fizikë dhe numrin tatimor dhe numrin e regjistrimit për persona juridikë,

- veprimtarinë e parapaguesit,

- adresën e parapaguesit,

- numrin parapagues,

- titulli akademik ose profesioni dhe

- në bazë të pagesës, të dhënat plotësuese, me kusht që kjo të mos i rrezikojë të drejtat e personave të tretë.

(6) Të dhënat e theksuara në paragrafin (5) të këtij neni mund të shfrytëzohen vetëm për:

- lidhjen, mbikëqyrjen dhe prishjen e marrëveshjes parapaguese,

- arkëtim të shërbimeve,

- përpilim dhe lëshim të listës së numrave të telefonit në pajtim me këtë ligj dhe

- qëllime tjera në pajtim me këtë ligj, ndërsa në bazë të pëlqimit të marrë nga parapaguesi

(7) Gjatë shfuqizimit të marrëveshjes nga paragrafi (1) i këtij neni, të dhënat e theksuara në paragrafin (5) të këtij neni ruhen për periudhë prej një viti nga dita e lëshimit të llogarisë së fundit të parapaguesit për shërbimet e siguruar.

(8) Operatorët janë të obliguar që të mbajnë evidencë për të gjitha marrëdhëniet parapaguese të vendosura (post-paid dhe pre-paid) e cila duhet të përmbajë të dhëna për emrin, mbiemrin dhe adresën, ndërsa për personin juridik emërtimin dhe selinë e personit juridik, dhe numrin amë ose numrin e dokumentit të udhëtimit, ndërsa për personin juridik numrin tatimor të personit juridik. Të dhënat e theksuara në evidencë për të gjitha marrëdhëniet parapaguese (post-paid dhe pre-paid) ruhen në afat të përcaktuar në paragrafin (7) të këtij neni.

(9) Marrëveshja fillestare nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse lidhet në kohën e caktuar të detyrueshme ajo nuk guxon të jetë më gjatë se 24 muaj. Në çdo rast parapaguesit duhet t'i jepet mundësi për lidhje të marrëveshjes me kohëzgjatje jo më gjatë se 12 muaj.

(10) Dispozitat nga paragrafi (9) i këtij neni nuk guxojnë të paraqesin kufizim ose pengesë për parapaguesin në rast kur ai kërkon bartje të numrit në rrjetin e operatorit tjetër.

Neni 108

Transparenca dhe shpallja e informatave

(1) Operatorët janë të detyruar të shpallin informata transparente, të krahasueshme, të përshtatshme dhe të azhurnuara për çmimet dhe tarifatat e zbatueshme në rast të prishjes së marrëveshjes nga neni 107 paragrafi (1) të këtij ligji, si dhe informata për kushtet e përgjithshme në lidhje me qasjen dhe shfrytëzimin e shërbimeve të komunikimeve publike që i sigurojnë. Informatat e tilla shpallen në formë të qartë, të kuptueshme dhe të lehtë për qasje.

(2) Agjencia me akt nënligjor përcakton në hollësi llojin dhe përmbajtjen e të dhënave nga paragrafi (1) i këtij neni të cilat operatorët janë të detyruar t'i publikojnë.

(3) Akti nënligjor nga paragrafi (2) i këtij neni veçanërisht duhet të përmbajë:

- Informata mbi tarifatat e aplikueshme për numrat nga Plani për numeracion ose shërbime me vlerë të shtuar në pajtim me nenin 113 të këtij ligji,

- Informata për çdo ndryshim në lidhje me qasjen të shërbimeve për thirrje urgjente ose informata për lokacionin e personit që kryen thirrjen, në lidhje me shërbimin për të cilin është lidhur marrëveshja nga neni 107 paragrafi (1) të këtij ligji,

- informata për çdo ndryshim të kushteve që e kufizojnë qasjen dhe / ose shfrytëzimin e shërbimeve dhe aplikimeve, në pajtim me ligjin,

- informata për çfarëdo procedure të përcaktuar nga operatori për matjen dhe formën të komunikacionit me qëllim që të evitohet ngarkesa ose mbingarkesa e lidhjes së rrjetit, si dhe informata rreth asaj se si këto procedura do të ndikojnë në cilësinë e shërbimit,

- informata për parapaguesit që të dhënat e tyre personale të jenë të përfshira në regjistrat telefonikë dhe shërbimet telefonike për informata, dhe

- informata të rregullta për parapaguesit me invaliditet për prodhimet dhe shërbimet e dedikuara për ta.

(4) Akti nënligjor nga paragrafi (2) i këtij neni duhet të përmbajë edhe të dhënat që operatorët i dorëzojnë parapaguesve të tyre nëpërmjet mjeteve të njëjta si ato që përdoren zakonisht për komunikim me parapaguesit e të cilat mund të sigurohen nga organet publike përkatëse në formë të standardizuar dhe kanë të bëjnë me:

- mënyrat e përdorura zakonisht të shfrytëzimit të shërbimeve të komunikimeve elektronike për kryerjet aktivitetive të paligjshme ose shpërndarjen e përmbajtjes së dëmshme, sidomos kur ajo të mund të ndikojë në të drejtat dhe liritë e personave të tjerë, duke përfshirë shkeljen e të drejtës së autorit dhe të drejtave të ngjashme dhe pasojat juridike nga ato dhe

- mënyrat për mbrojtje nga rreziqet për sigurinë personale, privatësinë dhe të dhënat personale, gjatë shfrytëzimit të shërbimeve të komunikimit elektronik.

(5) Agjencia në ueb faqen e saj publikon informata të krahasueshme me të cilat do tu mundësojë shfrytëzuesve të fundit dhe konsumatorëve të bëjnë vlerësim të pavarur të zgjedhjes së lirë të shërbimeve të komunikimit në bazë të cilësisë dhe çmimeve të shërbimeve.

(6) Në aktin nënligjor nga paragrafi (2) i këtij neni, përcaktohet edhe lloji dhe përmbajtja e të dhënave që do t'i publikojë Agjencia në pajtim me paragrafin (5) të këtij neni.

(7) Qasja të dhënat në paragrafët (1) dhe (5) të këtij neni dhe shfrytëzimi i tyre është falas dhe e lirë për publikun.

Neni 109

Cilësia e shërbimeve të komunikimit publik

(1) Operatorët janë të detyruar në mënyrë publike të shpallin informata të krahasueshme, të përshtatshme dhe të azhurnuara për kualitetin e shërbimeve të tyre dhe masat e marra për sigurinë e ekuivalencës në lidhje me qasjen e shfrytëzuesve të fundit me invaliditet. Përpara se t'i publikojë këto informata operatorët janë të detyruar t'ia dorëzojnë Agjencisë me kërkesë të saj.

(2) Agjencia, me akt nënligjor mund të përcaktojë parametrat e cilësisë së shërbimeve të cilat duhet të maten, duke përfshirë edhe mënyrat e mundshme për certifikimin e cilësisë si dhe përmbajtjen, formën dhe mënyrën e publikimit të informatave nga paragrafi (1) i këtij neni, në mënyrë që tu sigurojë shfrytëzuesve të fundit, duke përfshirë edhe personat me invaliditet qasje të informatat gjithëpërfshirëse, të krahasueshme, të sigurta dhe lehtë të të aplikueshme.

(3) Operatorët janë të detyruar të sigurojnë kushte për kontrollin dhe matjen e parametrave të cilësisë së shërbimeve të komunikimeve publike. Agjencia me akte nënligjor do t'i përcaktojë mënyrën dhe procedurën për kontrollin dhe matjen e parametrave të cilësisë.

(4) Agjencia mund ta detyrojë operatorin të sigurojë cilësi të caktuar minimale të shërbimit për të parandaluar përkeqësimin e shërbimit dhe duke penguar apo ngadalësuar transmetimin e rrjeteve të komunikacionit.

Neni 110

Sigurimi i qasjes ekuivalente dhe zgjedhja për shfrytëzuesit e fundit me aftësi të kufizuara

(1) Agjencia mundet atëherë ku është e përshtatshme të përcaktojë kërkesat teknike dhe funksionale që duhet t'i përmbushin operatorët me qëllim që personave me invaliditet tu sigurohet:

- qasje të shërbimit e komunikimit elektronik ekuivalente me atë i cili gëzon shumicën e shfrytëzuesve të fundit, dhe

- zgjedhje të operatorit dhe zgjedhje të shërbimeve që janë në dispozicion për shumicën e shfrytëzuesve të fundit.

(2) Qeveria e Republikës së Maqedonisë do të miratojë akt nënligjor me të cilin do t'i përcaktojë aktivitetet që do t'i ndërmarrë me qëllim që të inkurajojë disponueshmërinë dhe shfrytëzimin e radio pajisjes dhe pajisjes telekomunikative terminale të dedikuara për shfrytëzuesit e fundit me invaliditet.

Neni 111

Detyrimet plotësuese

Agjencia me akte nënligjor nga neni 108 paragrafi (2) të këtij ligji operatorëve të cilët sigurojnë qasje të rrjetet e komunikimit publik dhe / ose sigurojnë shërbime telefonike të arritshme për publikun, mund të përcaktojë detyrime shtesë në tërë ose në një pjesë të territorit të Republikës së Maqedonisë, si:

- mundësimin e kërkimit me ton dhe identifikimin e linjës thirrëse, nëse ajo është e mundur teknikisht dhe arsyetuar ekonomikisht dhe

- sigurimin e të gjitha ose disa nga mundësitë për të kontrolluar shpenzimet e përcaktuara në nenin 100 të këtij ligji.

Neni 112

Librat e telefonit dhe shërbimi telefonik për informata

(1) Parapaguesit e shërbimeve telefonike publike kanë të drejtë të përfshihen në librin e plotë telefonik të nenit 94 të këtij ligji si dhe të drejtë që të dhënat e tyre të jenë në dispozicion të siguroresve të shërbimit telefonik për informata dhe / ose librat e telefonit në pajtim me paragrafin (2) të këtij neni.

(2) Operatorët që parapaguesve u ndajnë numra telefonikë janë të detyruar t'i përmbushin të gjitha kërkesat e arsyeshme për marrje të të dhënave të parapaguesit e tyre nga shërbimet telefonike në dispozicion të publikut për informata dhe libra telefonikë, në formën kontraktuese paraprake dhe gjatë kësaj duhet të respektohen parimet e objektivitetit, paanësisë, mosdiskriminimit dhe çmime të orientuara drejt shpenzimit.

(3) Operatorët janë të detyruar që të gjithë shfrytëzuesve të fundit të shërbimeve telefonike publike tu sigurojnë qasje të shërbimet telefonike për informata.

(4) Agjencia, operatorëve të cilët e kontrollojnë qasjen e shfrytëzuesve të fundit mund tu imponojë detyrime dhe kushte me qëllim që të plotësohet obligimi nga paragrafi (3) i këtij neni, të cilat duhet të jenë objektive, të drejta, jo-diskriminuese dhe transparente.

(5) Operatorët të cilët parapaguesve u ndajnë numra telefonikë janë të detyruar që parapaguesve të tyre, pa pagesë dhe para se të përfshihen në librat telefonikë t'i njoftojnë për qëllimin e librit telefonik të shtypur ose elektronik që mund të merret edhe nëpërmjet shërbimit telefonik për informata, në të cilat të dhënat e tyre personale do të përfshihen, si dhe për të gjitha mundësitë e mëtejshme për shfrytëzimin e të dhënave të tyre personale.

(6) Operatorët të cilët parapaguesve u ndajnë numra telefonikë kanë të drejtë t'i përfshijnë parapaguesit e tyre dhe t'i publikojnë vetëm ato të dhëna personale të parapaguesve të tyre në librat telefonikë dhe shërbimet telefonike për informata, vetëm nëse parapaguesit më parë kanë dhënë pëlqim për këtë. Nëse të dhënat personale nga librat e telefonit do të përdoren për qëllime të ndryshme nga kërkimi i të dhënave për persona në bazë të emrit dhe të dhënat e tjera të nevojshme minimale për identifikim, nga parapaguesi, për këtë duhet të kërkohet pëlqim në mënyrë plotësuese.

(7) Parapaguesve doemos duhet tu mundësohet të caktojnë nëse dhe cilat të dhëna të tyre personale të theksuara në nenin 107 paragrafi (5) të këtij ligji do të hyjnë në librin e telefonit. Parapaguesi ka të drejtë, me kërkesë të dorëzuar paraprake te operatori, falas, t'i ndryshojë ose t'i plotësojë të dhënat personale nga paragrafi (6) i këtij neni ose të revokojë pëlqim për përfshirjen e saj në librat telefonikë dhe shërbimet telefonike për informata.

(8) Dispozitat e paragrafëve (5), (6) dhe (7) të këtij neni kanë të bëjnë vetëm për parapaguesit të cilët janë persona fizikë ndërsa nuk kryejnë veprimtari.

Neni 113

Shërbime me vlerë të shtuar

(1) Operatorët, përkatësisht dhënësit e shërbimeve me vlerë të shtuar janë të detyruar gjatë publikimit të shërbimeve të tyre të japin përshkrim të shërbimit dhe çmimin e tij në mënyrë të lehtë dhe të kuptueshme. Është e ndaluar të shfrytëzuesit e shërbimit të vihen në dyshim duke u dhënë informata të gabueshme ose të pavërteta ose me fshehjen e informatave të rëndësishme, të tilla si çmimi i shërbimit ose kufizimet për moshën e shfrytëzuesit të shërbimit.

(2) Operatorët, përkatësisht dhënësit e shërbimeve me vlerë të shtuar janë të detyruar në fillim të çdo thirrjeje drejt shërbimit me vlerë të shtuar të sigurojnë njoftim për çmimin e thirrjes dhe fillimin e pagesës, si dhe mundësimin e ndërprerjes së thirrjes pas paralajmërimit të afatit të arsyeshëm, ndërsa para fillimit të pagesës së thirrjes.

(3) Nëse parapaguesi parashtron kundërshtim te operatori në lidhje me shumën e faturës për shërbimin e siguruar me vlerë të shtuar apo kundërshtim në lidhje me cilësinë e shërbimit të siguruar, operatori është i detyruar të bëjë kontrollim të kundërshtimit dhe të njëjtin ta dërgojë te dhënësi që e siguron shërbimin me vlerë të shtuar në afat prej pesë ditëve nga dita e marrjes së kundërshtimit. Operatori, së bashku me kundërshtimin është i obliguar që dhënësit që e siguron shërbimin me vlerë të shtuar t'i dorëzojë emrin, mbiemrin dhe adresën e parapaguesit, si dhe të dhënat e verifikuara mbi llogarinë ose shërbimin e kontestuar.

(4) Dhënësi i shërbimit me vlerë të shtuar duhet të vendosë për kundërshtimin në afat prej dhjetë ditëve nga marrja e tij.

(5) Detyrimet e ndërsjella nga paragrafët (3) dhe (4) të këtij neni, më së afërmi përcaktohen me marrëveshje ndërmjet operatorit dhe dhënësit të shërbimeve me vlerë të shtuar. Dispozitat themelore të kësaj Marrëveshjeje janë pjesë përbërëse e kushteve të përgjithshme për qasje dhe shfrytëzim të shërbimeve të komunikimit publik të operatorit.

(6) Shfrytëzuesit e shërbimeve qasen te shërbimet me vlerë të shtuar nëpërmjet numrave të veçantë të ndarë në pajtim me Planin për numërtim.

(7) Mënyra dhe kushtet për sigurimin e shërbimeve me vlerë të shtuar duke përfshirë edhe masat për eliminim të mashtrimeve dhe veprimeve të paligjshme në lidhje me sigurimin e shërbimeve me vlerë të shtuar, më afër përcaktohen me rregullën nga neni 108 paragrafi (2) të këtij ligji.

Neni 114

Kufizimi i qasjes dhe shfrytëzimin e shërbimeve dhe aplikimeve

(1) Qasja te dhe shfrytëzimi i shërbimeve dhe aplikimeve nëpërmjet rrjeteve të komunikimeve elektronike publike mund të kufizohet në bazë të vendimit gjyqësor në rastet e përcaktuara me ligj të veçantë.

(2) Dispozita e paragrafit (1) të këtij neni nuk ka të bëjë me të drejtën e operatorit për ta kufizuar qasjen te dhe shfrytëzimin e shërbimeve dhe aplikimeve sipas kushteve të përcaktuara me këtë ligj.

Neni 115

Kufizimi i përkohshëm ose ndërprerja e qasjes

(1) Operatorët që sigurojnë qasje në rrjetin publik të komunikimeve elektronike, pa pëlqimin e shfrytëzuesve, mund të kufizojnë ose ndërpresin përkohësisht qasjen në shërbimet e tyre nëse kjo është e nevojshme për rekonstrukcionin, modernizimin, mirëmbajtjen ose në rast të pengesave teknike ose mangësive në rrjet.

(2) Operatorët janë të detyruar të informojnë Agjencinë dhe t'i njoftojnë shfrytëzuesit për kufizimet apo ndërprerjet që zgjasin më gjatë se 30 minuta:

- së paku 48 orë para rikonstruksionit, modernizimit dhe mirëmbajtjes së planifikuar, ose
- sa më shpejtë që të jetë e mundur, por jo më gjatë se 48 orë, te kufizimet ose ndërprerjet e shkaktuara nga pengesat teknike ose mangësitë në rrjet.

(3) Operatorët duhet t'i marrin të gjitha masat e nevojshme, që kufizimet ose ndërprerjet të zgjasin sa më pak që është mundur.

Neni 116

Bartja e numrave

(1) Bartja e numrit është e drejtë e të gjithë parapaguesve të shërbimeve telefonike publike (fikse ose celulare) ta mbajnë numrin pavarësisht operatorit i cili e siguron shërbimin:

- kur bëhet fjalë për numra gjeografikë të lokacionit të caktuar dhe
- kur bëhet fjalë për numra jogjeografikë në cilindo lokacion.

(2) Të gjithë operatorët të cilët sigurojnë shërbime telefonike publike (fikse ose celulare) janë të obliguar që tu mundësojnë parapaguesve të tyre bartje të numrave.

(3) Numrat nuk barten nga rrjetet komunikuese fikse publike në rrjetet komunikuese celulare publike dhe anasjelltas.

(4) Bartja e numrit dhe aktivizimi i tij në rrjetin e operatorit tjetër duhet patjetër të realizohet në afatin më të shkurtër të mundshëm. Ndërprerja e shërbimit në procedurën e bartjes së numrit nuk mund të zgjasë më shumë se një ditë pune.

(5) Operatori mundet për bartjen e numrave të operatorit tjetër tu arkëtojë operatorëve dhe parapaguesve ose operatorëve shumë të njehershme për mbulimin e shpenzimeve për bartjen e numrit. Shuma e njehershme për mbulimin e shpenzimeve për bartjen e numrit duhet të parashihet në marrëveshjet për interkoneksion, ndërsa shpenzimet direkte (administrative), nëse i

ka, ndërsa paguhen nga parapaguesit, nuk guxojnë të jenë distimuluese për shfrytëzimin e këtij shërbimi. Agjencia, me vendim, mund ta përcaktojë shumën maksimale të njëhershme që duhet të parashihet në marrëveshjet për interkoneksion.

(6) Operatorët janë të detyruar që t'i bartin shpenzimet për adaptimin e rrjeteve të tyre që të mundësojnë bartje të numrave dhe shpenzimeve për mbajtjen e mjeteve të tilla.

(7) Agjencia me akt nënligjor në mënyrë më detale e përcakton zbatimin e dispozitave të këtij neni.

Neni 17

Numrat e shërbimeve për thirrje urgjente dhe numri unik evropian për thirrje urgjente

(1) Të gjithë operatorët që sigurojnë fillimin e thirrjes së numrave nga Plani për numërtim, në pajtim me këtë ligj janë të obliguar që shfrytëzuesve të këtyre shërbimeve, përfshirë edhe shfrytëzuesit e fundit në kabinat telefonike publike, t'u sigurojnë mundësi për qasje falas në numrat e shërbimeve për thirrje urgjente dhe numrin unik evropian për thirrje urgjente "112".

(2) Operatorët nga paragrafi (1) i këtij neni janë të detyruar që personave me invaliditet t'u mundësojnë qasje në numrat e shërbimeve për thirrje urgjente dhe numrin unik evropian për thirrje urgjente "112" nëpërmjet shfrytëzimit të të folurit, gjuhës së shenjave ose formës tjetër të gjuhës jo të folur, përkatësisht mënyrës e cila është e mundshme teknikisht.

(3) Nëse operatori nga paragrafi (1) i këtij neni pohon se nuk ka mundësi teknike ta përmbushë detyrimin nga paragrafi (2) i këtij neni, ka për obligim që këtë t'ia tregojë Agjencisë.

(4) Operatorët nga paragrafi (1) i këtij neni janë të detyruar që organit, kompetent për pranimin e thirrjeve të numrit unik evropian për thirrje urgjente "112" t'ia dorëzojnë pa kompensim të gjitha të dhënat e disponueshme për thirrjet e realizuara në numrin 112", të cilat i përfshijnë veçanërisht të dhënat për emrin dhe mbiemrin ose emërtimin e thirrësit, prefiksionin e rrethit, kohën dhe kohëzgjatjen e thirrjes, si dhe lokacionin nga i cili vjen thirrja dhe atë menjëherë pas përcjelljes së thirrjes në numrin "112".

(5) Operatorët nga paragrafi (1) i këtij neni janë të detyruar që me thirrjet në numrin "112" të veprojnë në mënyrën e njëjtë si dhe me thirrjet tjera në numrat e shërbimeve për thirrje urgjente të cilat ende shfrytëzohen në Republikën e Maqedonisë.

(6) Mënyra dhe kushtet për shfrytëzimin e numrit unik evropian për thirrje urgjente "112" kërkesat teknike dhe kërkesat tjera për operatorët nga paragrafi (1) i këtij neni në lidhje me përmbushjen e detyrimeve të organit kompetent nga paragrafi (2) i këtij neni, si dhe matja e cilësisë së shërbimit për thirrje urgjente "112" përcaktohen më hollësisht me akt nënligjor të cilin e miraton Agjencia.

(7) Është i ndaluar çdo keqpërdorim i thirrjeve të numrave të shërbimeve për thirrje urgjente dhe numrit unik evropian për thirrje urgjente "112", që i përfshin veçanërisht të gjitha llojet e thirrjeve qëllimkëqija ose shqetësuese. Me aktin nënligjor nga paragrafi (6) i këtij neni përcaktohen më afërsisht mënyra dhe kushtet për realizimin e shkyçjes së përkohshme dhe të përhershme të pajisjes terminale parapaguese ose shfrytëzuese nga rrjeti i komunikimit elektronik në rast të keqpërdorimit të konstatuar të thirrjeve të numrave të shërbimeve për thirrje urgjente dhe numrit unik evropian për thirrje urgjente "112".

(8) Agjencia në bashkëpunim me organin kompetent nga paragrafi (4) i këtij neni në mënyrë adekuate dhe publike i informon dhe i njofton qytetarët për qëllimin dhe mënyrën e shfrytëzimit të numrave të shërbimeve për thirrje urgjente dhe numrin unik evropian për thirrje urgjente "112".

Neni 118

Qasje te numrat dhe shërbimet

(1) Thirrjet ndërkombëtare dhe thirrjet në shërbimet telefonike ndërkombëtare dhe rrjetet telefonike ndërkombëtare realizohen me shfrytëzimin e prefiksit ndërkombëtar "00" para kodit të shtetit i ndarë nga Unioni Ndërkombëtar i Telekomunikimeve (ITU) dhe numrit nacional nga Plani i numërtimit, në pajtim me këtë ligj.

(2) Të gjithë operatorët që sigurojnë fillimin e thirrjes në numrat nga Plani i numërtimit, në pajtim me këtë ligj, kur kjo është e mundshme teknikisht dhe ekonomikisht dhe kur parapaguesi i thirrur për shkaqe komerciale nuk e ka kufizuar qasjen e thirrësve nga zona të caktuara gjeografike janë të detyruar që shfrytëzuesve të fundit t'u sigurojnë:

- qasje dhe shfrytëzim të shërbimeve me shfrytëzim të numrave jogjeografikë, përfshirë edhe të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe

- qasje në të gjitha numrat nga Plani i numeracionit, në pajtim me këtë ligj, pa marrë parasysh teknologjinë dhe aparatet që shfrytëzohen nga ana e operatorit.

(3) Operatorët nga paragrafi (2) i këtij neni mund që në bazë individuale ta pamundësojnë qasjen në numrat ose shërbimet kur ekziston dyshim i arsyeshëm për mashtrim ose keqpërdorim. Në këtë rast Agjencia do të sjellë vendim me të cilin operatorit do t'i urdhërojë t'i mbajë të ardhurat përkatëse nga interkoneksioni ose nga shërbimet tjera.

(4) Operatorët nga paragrafi (2) i këtij neni janë të detyruar që shfrytëzuesve të shërbimeve nga shtetet tjera t'u mundësojnë të kenë qasje në numrat jogjeografikë nga Plani i numërtimit, në pajtim me këtë ligj, nëse kjo është mundshme teknikisht dhe ekonomikisht, përveç në raste kur parapaguesi i thirrur për shkaqe komerciale e ka kufizuar qasjen e thirrësve nga zonat e caktuara gjeografike.

Neni 119

Numrat evropianë për shërbime me vlerë sociale

(1) Të gjithë operatorët që sigurojnë fillimin e thirrjes në numrat nga Plani i numërtimit, në pajtim me këtë ligj janë të detyruar të mundësojnë vendosje të të gjithë thirrjeve të numrave nga seria e numrave e cila fillon me numrin 116 dhe është e dedikuar për shërbime me vlerë të veçantë sociale në pajtim me Planin e numërtimit, e veçanërisht në numrin 116 000 i cili është i dedikuar për shërbimin kompetent për paraqitjen e fëmijëve të humbur.

(2) Operatorët nga paragrafi (1) i këtij neni janë të detyruar që në masë më të madhe të mundshme personave me invaliditet t'u mundësojnë qasje në numrat nga seria e numrave që fillon me numrin 116.

(3) Agjencia në mënyrë adekuate dhe publike i informon dhe i njofton qytetarët për qëllimin dhe mënyrën e shfrytëzimit të numrave për shërbime me vlerë sociale nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 120

E drejta e kundërshtimit dhe padisë

(1) Parapaguesi ka të drejtë që te operatori të parashtrojë kundërshtim në lidhje me sigurimin e shërbimeve, kundërshtim për shumën me të cilën është i detyruar për shërbimin e siguruar, kundërshtim për cilësinë e shërbimit të siguruar, si dhe kundërshtim për shkeljen e dispozitave nga marrëveshja e lidhur për kyçe dhe shfrytëzim të rrjetit të komunikimit publik dhe/ose shërbimeve të komunikimit elektronik të arritshme publikisht.

(2) Kundërshtimin nga paragrafi (1) i këtij neni parapaguesi ia parashton operatorit në formë të shkruar. Kundërshtimi doemos duhet t'i përmbajë faktet dhe dëshmitë në të cilat bazohet.

(3) Parapaguesi mund ta parashtrojë kundërshtimin në afat prej 15 ditësh nga dita e ndodhjes së shkeljes në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni.

(4) Në rast të parashtrimit të kundërshtimit nga paragrafi (1) i këtij neni operatori doemos duhet ta kontrollojë shumën për të cilën është i detyruar parapaguesi ose cilësia e shërbimit të siguruar, dhe në bazë të kontrollit të kryer administrativ dhe/ose teknik ta vërtetojë shumën ose cilësinë e shërbimit të siguruar. Në rast të refuzimit të kundërshtimit si i pabazë, operatori është i detyruar që parapaguesit t'i lëshojë vërtetim për kontrollin e kryer me elemente të shënuara saktë dhe qartë nga kontrolli administrativ dhe/ose teknik. Operatori në tërësi është përgjegjës për autenticitetin e të gjitha konstatimeve të dhëna në vërtetim.

(5) Nëse parapaguesi parashtron kundërshtim te operatori, e pastaj edhe kërkesë për zgjidhjen e kontestit në Agjenci, në lidhje me shumën e llogarisë, operatori nuk guxon të veprojë në pajtim me nenin 102 paragrafin (1) të këtij ligji deri në miratimin e vendimit final në pajtim me nenin 53 të këtij ligji, ndërsa parapaguesi është i detyruar që ta paguajë shumën e parapagimit mujor në afatin e caktuar. Nëse parapaguesi nuk e paguan shumën e parapagimit mujor në afatin e caktuar, operatori ka të drejtë të veprojë në pajtim me nenin 102 paragrafin (1) të këtij ligji.

(6) Nëse operatori tashmë ia ka ndërprerë parapaguesit sigurimin e shërbimit ose e ka shkyçur pajisjen temrinale parapaguese nga rrjeti i komunikimit elektronik, para se të pranojë nga parapaguesi ose nga Agjencia njoftim se ka filluar procedura për zgjidhjen e kontestit në pajtim me nenin 53 të këtij ligji, është i detyruar që pa prolongim dhe pa kompensim përsëri të fillojë dhe ta vazhdojë sigurimin e shërbimit deri në fund të procedurës për zgjidhjen e kontestit në Agjenci, përveç në rast kur parapaguesi e ka prishur marrëveshjen.

(7) Nëse konstatohet se operatori i ka shkelur dispozitat nga marrëveshja e lidhur ose në mënyrë të paarsyeshme parapaguesit ia ka ndërprerë sigurimin e shërbimit i cili ka parashtruar kundërshtim nga paragrafi (1) i këtij neni për shkak të shkeljes së dispozitave të marrëveshjes së lidhur ose kundërshtimit për ndërprerje të paarsyeshme në sigurimin e shërbimit, parapaguesi ka të drejtë ta prishë marrëveshjen pa kompensim, si dhe të drejtë kthimi të të gjithë mjeteve të paguara të paarsyeshme monetare.

(8) Operatori është i detyruar që parapaguesit t'i dorëzojë përgjigje me shkrim për bazën e kundërshtimit të parashtruar nga paragrafi (1) i këtij neni në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kundërshtimit.

(9) Nëse parapaguesi nuk është i kënaqur nga vendimi i miratuar për kundërshtimin ka të drejtë që në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tij në Agjenci të dorëzojë kërkesë për zgjidhjen e kontestit, në pajtim me nenin 53 të këtij ligji.

(10) Nëse operatori nuk vepron për kundërshtimin në afatin e përcaktuar në paragrafin (8) të këtij neni, parapaguesi ka të drejtë që në Agjenci të dorëzojë kërkesë për zgjidhjen e kontestit në afat prej 35 ditësh nga dita e parashtrimit të kundërshtimit në operatorin.

Kapitulli katërmëdhjetë

SPEKTRI I RADIOFREKUENCËS

Neni 121

Menaxhimi me spektrin e radiofrekuencës

(1) Spektri i radiofrekuencës është resurs i kufizuar natyror, me vlerë të rëndësishme, sociale, kulturore dhe ekonomike.

(2) Organet shtetërore, në pajtim me rregullat ndërkombëtare që zbatohen në Republikën e Maqedonisë, e veçanërisht me rregullat e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacioneve, sigurojnë shfrytëzim efikas dhe të pandërprerë të spektrit radiofrekuentues dhe i sigurojnë të drejtat e Republikës së Maqedonisë në pozicione të orbitës.

(3) Me spektrin e radiofrekuencës të Republikës së Maqedonisë, menaxhon Agjencia në pajtim me këtë ligj.

Neni 122

Planifikimi dhe koordinimi strategjik i spektrit radiofrekuentues

Agjencia dhe organet shtetërore kompetente të Republikës së Maqedonisë bashkëpunojnë me Komisionin Evropian, Unionin ndërkombëtar të telekomunikacioneve dhe organet kompetente të shteteve tjera në lidhje me planifikimin dhe koordinimin strategjik të spektrit radiofrekuentues. Gjithashtu, duhet, ndër të tjera, të kihet parasysh, interesi publik ekonomik, i sigurisë, shëndetësor, liria e të shprehurit, aspektet kulturore, shkencore, sociale dhe teknike të politikave të Republikës së Maqedonisë dhe interesat e ndryshme të shfrytëzuesve të spektrit radiofrekuentues me qëllim që të optimizohet shfrytëzimi i spektrit radiofrekuentues dhe shmangia e interferencave të dëmshme.

Neni 123

Plani për dedikim të brezave radiofrekuentues

(1) Plani për dedikim të brezave radiofrekuentues, që e miraton Agjencia pas pëlqimit të marrë paraprak nga Qeveria e Republikës së Maqedonisë përgatitet në pajtim me aktet ndërkombëtare nga sfera e radiokomunikimeve.

(2) Me planin nga paragrafi (1) i këtij neni veçanërisht përcaktohen kufijtë e brezave radiofrekuentues, shërbimet e radiokomunikimit që do të sigurohen në brezat përkatëse radiofrekuentues, si dhe çështje tjera lidhur me shfrytëzimin e brezave radiofrekuentuese.

Neni 124

Plani për ndarjen dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave

Me planin për ndarjen dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave që e miraton Agjencia, përcaktohet më afërsisht mënyra e ndarjes dhe shfrytëzimit të radiofrekuencave në brezat e caktuara radiofrekuentuese, të përcaktuara në Planin për dedikim të brezave të radiofrekuencave nga ky ligj, mundësia për bartjen ose lëshimin e të drejtës së shfrytëzimit të radiofrekuencave, e ku në mënyrë përkatëse përcaktohen edhe parametrat teknike për shfrytëzimin e radiofrekuencave.

Neni 125

Koordinimi gjatë miratimit të Planit për dedikim të brezave radiofrekuentues dhe Planit për ndarjen dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave

(1) Gjatë miratimit të Planit për dedikim të brezave radiofrekuentues dhe Planit për ndarjen dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave, Agjencia i koordinon aktivitetet me:

- organet shtetërore dhe institucionet kompetente për lundrim ajror civil në lidhje me pjesë nga Plani që u referohet frekuencave që shfrytëzohen për sigurinë në aviokomunikacionin,
- organet shtetërore kompetente për planifikimin dhe menaxhimin me radiofrekuencat në lidhje me pjesën e Planit që ka të bëjë me shfrytëzimin e radiofrekuencave për nevojat e sigurisë dhe mbrojtjes nacionale dhe
- organ rregullator kompetent për punët nga sfera e radiodifuzionit në lidhje me pjesën e planit që ka të bëjë me radiofrekuencat që shfrytëzohen në radiodifuzion.

(2) Agjencia gjatë miratimit të Planit për dedikim të brezave të radiofrekuencave dhe Planit për ndarje dhe shfrytëzim të radiofrekuencave i ka parasysh nevojat për siguri dhe mbrojtje nacionale, mbrojtjen nga fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi tjera elementare dhe nevojat për siguri në komunikacionin ajror.

Neni 126

Neutraliteti në lidhje me teknologjitë

(1) Të gjitha llojet e teknologjive me të cilat sigurohen shërbimet e komunikimit elektronik publik dhe të cilat i përmbushin kërkesat teknike minimale të përcaktuara në Planin për ndarjen dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave, mund të shfrytëzohen në brezat e radiofrekuencave në pajtim me Planin për dedikim të brezave të radiofrekuencave.

(2) Me përjashtim të dispozitës nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia, në Planin për ndarje dhe shfrytëzim të radiofrekuencave mund të përcaktojë kufizime proporcionale dhe jodiskriminuese për lloje të caktuara të teknologjive për rrjete radio dhe qasje pa tel të cilat shfrytëzohen për sigurim të shërbimeve të komunikimit elektronik, nëse kjo është e nevojshme për:

- t'u parandaluar paraqitja interferencave të dëmshme; - të mbrohet shëndeti publik nga fushat elektromagnetike,
- të sigurohet cilësi teknike e shërbimit,
- të sigurohet maksimizim i shfrytëzimit të përbashkët të radiofrekuencave,
- të mbrohet shfrytëzimi efikas i spektrit radiofrekuentues ose
- të sigurohet përmbushje e qëllimeve me interes të përgjithshëm në pajtim me nenin 127 të këtij ligji.

Neni 127

Neutraliteti në lidhje me shërbimet

(1) Në brezat e radiofrekuencës të cilat në Planin për dedikim të brezave radiofrekuentues janë caktuar për sigurim të shërbimeve të komunikimit elektronik publik mund të sigurohen gjithë shërbimet e komunikimit elektronik publik të cilat i përmbushin kërkesat teknike minimale të përcaktuara në Planin për ndarje dhe shfrytëzim të radiofrekuencave.

(2) Me përjashtim të dispozitës nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia, në Planin për ndarje dhe shfrytëzim të radiofrekuencave mund të përcaktojë kufizime proporcionale dhe jodiskriminuese për lloje të caktuara të shërbimeve të komunikimit elektronike, nëse kjo është e nevojshme për përmbushjen e ndonjë kërkesë në pajtim me rregullativën e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikimeve.

(3) Me përjashtim të dispozitës nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia, në Planin për ndarje dhe shfrytëzim të radiofrekuencave mund të përcaktojë sigurim të shërbimit të komunikimit elektronik në brezin e caktuar radiofrekuentues, nëse kjo është e nevojshme për:

- sigurinë e jetës,
- nxitjen e bashkimit social, rajonal ose territorial;
- shmangie të përdorimit joefikas të radiofrekuencave, ose
- nxitje të diversitetit kulturor dhe gjuhësor dhe pluralizmit të mediave, për shembull për sigurimin e transmetimit televiziv dhe të radios.

(4) Agjencia, në Planin për ndarje dhe shfrytëzim të radiofrekuencave mund të ndalojë sigurim të cilido shërbim të komunikimit elektronik publik në brezin e caktuar radiofrekuentues, nëse kjo është e nevojshme për sigurinë e jetës.

Neni 128

Rishqyrtimi i mundësisë nga kufizimi për neutralitet në lidhje me teknologjitë dhe për neutralitet në lidhje me shërbimet

(1) Agjencia është e detyruar që në periudha të caktuara kohore të cilat nuk mund të jenë më të gjata se dy vjet të kryejë rishqyrtim të nevojës për kufizimet për neutralitet lidhur me teknologjitë dhe për neutralitet në lidhje me shërbimet, të përcaktuara në nenin 126 dhe në nenin 127 të këtij ligji.

(2) Nëse me rishqyrtimin e kryer nga paragrafi (1) i këtij neni konstatohet nevojë për ndryshimin e Planit për dedikim të brezave radiofrekuentuese ose Planit për ndarjen dhe shpërndarjen e radiofrekuencave, Agjencia do të bëjë ndryshimin në mënyrën e përcaktuar në nenin 146 të këtij ligji.

Neni 129

Shfrytëzimi i radiofrekuencave

(1) Personi juridik ose fizik mund të shfrytëzojë radiofrekuenca në Republikën e Maqedonisë në bazë të lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave që e lëshon Agjencia, e që është në pajtim me Planin për dedikim të radiofrekuencave dhe Planit për ndarjen dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave me qëllim që të:

- shmangët paraqitja e interferencave të dëmshme,
- të sigurohet cilësi teknike e shërbimit,
- të mbrohet përdorimi efikas i spektrit radiofrekuentues ose
- të përmbushen qëllimet me interes publik nëpërmjet ndarjes së radiofrekuencave për ushtrimin e veprimtarisë radiodifuzive.

(2) Për radiofrekuencat të cilat me Planin për dedikim të brezave radiofrekuentuese dhe Planit për ndarjen dhe shfrytëzimin e radiofrekuencave janë paraparë për nevojat për siguri dhe mbrojtje nacionale, mbrojtjen nga fatkeqësisë natyrore dhe fatkeqësitë tjera elementare dhe nevojat për siguri në komunikacionin ajror, si dhe për radiofrekuenca tjera të cilat në pajtim me Planin për ndarje dhe shfrytëzim të radiofrekuencave mund të shfrytëzohen pa leje për shfrytëzim të radiofrekuencave, Agjencia nuk lëshon leje për shfrytëzim të radiofrekuencave.

(3) Radiofrekuencat që mund të shfrytëzohen pa leje për shfrytëzim të radiofrekuencave, më hollësisht i përcakton Agjencia me akt nënligjor.

Neni 130

Regjistri i radiofrekuencave të ndara

(1) Agjencia mban Regjistër të radiofrekuencave të ndara që shfrytëzohen në Republikën e Maqedonisë.

Regjistri i radiofrekuencave të ndara përmban të dhëna për persona fizikë dhe juridikë të cilëve u janë ndarë radiofrekuencat, me përjashtim të radiofrekuencave që shfrytëzohen për nevojat për siguri nacionale dhe mbrojtje dhe për mbrojtjen nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera elementare. Regjistri i përmban të dhënat personale në vijim: emrin dhe mbiemrin dhe numrin unik amë të qytetarit (NUAQ). Afati i ruajtjes së të dhënave personale është pesë vjet nga dita e shfuqizimit të lejes për shfrytëzimin e radiofrekuencave.

(2) Agjencia rregullisht e azhuron Regjistrin e radiofrekuencave të ndara.

(3) Agjencia në ueb faqen e saj e publikon Regjistrin nga paragrafi (1) i këtij neni, ndërsa duke i zbatuar rregullat për mbrojtje të të dhënave personale.

Neni 131

Shfrytëzimi i radiofrekuencave për nevojat e radioamatorëve

(1) Radioamatorët mund të shfrytëzojnë radiofrekuenca të cilat me Planin për ndarje dhe shfrytëzim të radiofrekuencave janë paraparë për sigurim të shërbimeve radioamatorike dhe/ose shërbimeve satelitore radioamatorike dhe të cilëve Agjencia u ka lëshuar leje për shfrytëzimin e radiofrekuencave.

(2) Radioamatorët që nuk janë shtetas të Republikës së Maqedonisë kanë të drejtë t'i shfrytëzojnë radiofrekuencat nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse posedojnë leje të vlefshme radioamatorike CERT.

(3) Agjencia lëshon leje për shfrytëzimin e radiofrekuencave për nevojat e radioamatorëve, me kërkesë të radioamatorëve me provim të dhënë radioamatorik.

(4) Mënyrën e dhënies së provimit radioamatorik, si dhe klasat radioamatorike i përcakton Agjencia.

(5) Dhënia e provimit radioamatorik nga paragrafi (4) i këtij neni bëhet në pajtim me Programin për dhënie të provimit radioamatorik, që publikohet në ueb faqen e Agjencisë.

(6) Leja për shfrytëzimin e radiofrekuencave për nevojat e radioamatorëve, ndër të tjera duhet ta përmbajë edhe shenjën e ndarë për identifikim, si dhe klasën e radioamatorit.

(7) Radioamatorët nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni nuk paguajnë kompensim vjetor për shfrytëzimin e radiofrekuencave në pajtim me këtë ligj.

Neni 132

Lëshimi i lejes për shfrytëzimin e radiofrekuencave

(1) Agjencia u lëshon leje për shfrytëzim të radiofrekuencave personave fizikë dhe juridikë për sigurim të shërbimeve të komunikimeve elektronike.

(2) Gjatë lëshimit të lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave, Agjencia duhet doemos t'i respektojë parimet e objektivizmit, transparencës, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit, ndërsa gjatë lëshimit të lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave për sigurim të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike duhet doemos të mbajë llogari edhe për realizimin e qëllimeve dhe parimeve rregullatore të përcaktuara me këtë ligj.

(3) Agjencia lëshon leje për shfrytëzimin e radiofrekuencave me kërkesë për shfrytëzimin e radiofrekuencave, pas procedurës së zbatuar të tenderit publik ose pas procedurës së zbatuar të tenderit publik me ankand publik.

Neni 133

Lëshimi i lejes për shfrytëzimin e radiofrekuencave me kërkesë

(1) Agjencia lëshon leje për shfrytëzimin e radiofrekuencave në bazë të kërkesës së dorëzuar për shfrytëzim të radiofrekuencave në rastet në vijim:

- për nevojat personale të institucioneve shtetërore dhe ndërmarrjeve publike lidhur me kompetencat e tyre dhe të përfaqësive diplomatike ose të organizatave tjera që kanë status të misioneve diplomatike,

- për sigurimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike që nuk janë publike,

- për radiofrekuencat që shfrytëzohen në kuadër të rrjetit të komunikimit elektronik publik, kur nuk është e nevojshme të bëhet kufizimi i numrit të lejeve për shfrytëzimin e radiofrekuencave,

- për shfrytëzimin e radiofrekuencave të dedikuara për radiodifuzion digjital, të radiodifuzerit i cili është i vetëm në zonën e caktuar lokale të servisit në bazë të vendimit për ndarjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë radiodifuzive dhe është botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë",

- për shfrytëzimin e radiofrekuencave të radiodifuzerit për radiodifuzion analog radio - pas vendimit të miratuar paraprak për ndarjen e lejes për ushtrimin e veprimtarisë radiodifuzive - emetim të servisit të radioprogramit të miratuar dhe botuar në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë",

- për Ndërmarrjen Publike Radiodifuzioni Maqedonas për Radiofrekuencat për ndërtim dhe punë të rrjetit të komunikimit elektronik për transmetim tokësor digjital nëpërmjet dy sistemeve multiplekse digjitale nacionale dhe

- për lëshimin e lejes së përkohshme për shfrytëzimin e radiofrekuencave, në pajtim me këtë ligj.

(2) Kërkesa për lëshimin e lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave veçanërisht duhet t'i përmbajë të dhënat në vijim:

- emrin dhe mbiemrin, adresën dhe numrin unik amë të qytetarëve,

- titullin, selinë, numrin tatimor dhe numrin e xhirlogarisë, numrin e regjistrimit dhe deklaratën për përfaqësues ligjor për persona juridikë,

- përshkrim të shkurtër për nevojat dhe dedikimin për shfrytëzimin e radiofrekuencave të kërkuara,

- përshkrim të karakteristikave teknike të rrjetit të komunikimit elektronik dhe mjetet shoqëruese;

- datën e fillimit të shfrytëzimit të radiofrekuencave,

- periudhën kohore në të cilën do të shfrytëzohen radiofrekuencat e kërkuara dhe

- të dhënat e personit për kontakt.

(3) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, si dhe dokumentacionin e nevojshëm që dorëzohet me kërkesën, më detajisht i përcakton Agjencia me akt nënligjor.

(4) Në rast kur kërkesa për shfrytëzimin e radiofrekuencave nuk i përmban të dhënat dhe dokumentacionin në pajtim me këtë nen të ligjit, Agjencia për këtë me shkrim do ta njoftojë parashtruesin e kërkesës dhe do t'i japë afat prej shtatë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit ta plotësojë kërkesën. Nëse parashtruesi i kërkesës në afatin e përcaktuar nuk vepron sipas njoftimit të Agjencisë, do të konsiderohet sikur kërkesa nuk është parashtruar.

(5) Agjencia me aktvendim do ta refuzojë kërkesën për shfrytëzimin e radiofrekuencave, nëse konstaton se:

- kërkesat e radiofrekuencave nuk janë të lira,

- shfrytëzimi i radiofrekuencave të kërkuara do ta rrezikojë sigurinë nacionale ose është në kundërshtim me marrëveshjet ndërkombëtare që i ka përcaktuar ose të cilëve u është qasur Republika e Maqedonisë,

- kërkuuesi është në procedurë falimentimi ose likuidimi,

- kërkuuesit i është shqiptuar masë sigurie-ndalim për sigurimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimit elektronik publik,

- kërkuuesit i është hequr leja e lëshuar paraprake për shfrytëzimin e radiofrekuencave për llojin e njëjtë të shërbimit sipas fajit të tij në vitin e fundit, ose

- puna e radioaparaturave të kërkuuesit do të shkaktojë interferenca të dëmshme në punën e radioaparaturave dhe pajisjeve tjera, radiomarrësve, sistemeve elektrike ose elektronike.

(6) Poseduesi i lejes për shfrytëzimin e radiofrekuencave është i detyruar që ta njoftojë Agjencinë për çdo ndryshim të të dhënave të përcaktuara në paragrafin (2) të këtij neni në afat prej 14 ditësh nga dita kur është bërë ndryshimi.

(7) Agjencia do t'i lëshojë lejet për shfrytëzimin e radiofrekuencave sipas programit të dorëzimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, ndërsa në varësi nga mundësitë e disponueshme teknike, Agjencia mund t'i pranojë kërkesat edhe në formë elektronike.

(8) Agjencia është e detyruar ta lëshojë lejen për shfrytëzimin e radiofrekuencave në afat prej 42 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 134

Lëshimi i lejes për shfrytëzimin e radiofrekuencave me procedurë të tenderit publik ose me procedurë të tenderit publik me ankand publik

(1) Agjencia zbaton procedurë të tenderit publik ose procedurë të tenderit publik me ankand publik për lëshimin e lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave kur është e nevojshme të bëhet kufizimi i numrit të lejeve për shfrytëzimin e radiofrekuencave.

(2) Numri i lejeve për shfrytëzim të radiofrekuencave është i nevojshëm të kufizohet me qëllim që të sigurohet shfrytëzimi efikas i spektrit radiofrekuentues, të sigurohen volitshmëri maksimale për shfrytëzuesit dhe të nxitet konkurrenca.

(3) Agjencia me iniciativë të saj ose me kërkesë të palës së interesuar shpall qëllim për zbatimin e procedurës së tenderit publik ose procedurës së tenderit publik me ankand publik për lëshimin e numrit të kufizuar të lejeve për shfrytëzimin e radiofrekuencave me qëllim që të mundësojë debat publik për numrin e publikuar të lejeve për shfrytëzimin e radiofrekuencave. Debatit publik nuk guxon të zgjasë më pak se 30 ditë nga dita e shpalljes së qëllimit për zbatimin e procedurës së tenderit publik ose procedurës së tenderit publik me ankand publik.

(4) Agjencia shpalljen për qëllimin nga paragrafi (3) i këtij neni e publikon së paku në dy gazeta ditore nga të cilat njëra gazetë ditore është në gjuhën e komunitetit i cili nuk është shumicë, ndërsa e flasin së paku 20% nga qytetarët në Republikën e Maqedonisë dhe në ueb faqen e saj.

(5) Shpallja për qëllimin nga paragrafi (3) i këtij neni veçanërisht përmban:

1) spektrin e radiofrekuencës për të cilin do të lëshohet leja për shfrytëzimin e radiofrekuencave;

2) numrin e lejeve për shfrytëzimin e radiofrekuencave që do të lëshohet;

3) arsyetimin për shkaqet për numrin e kufizuar të publikuar të lejeve për shfrytëzimin e radiofrekuencave që do të lëshohen;

4) afatet dhe kushtet në të cilat do të shfrytëzohen radiofrekuencat;

5) lartësinë dhe mënyrën e pagesës së shumës më të ulët të kompensimit të njëhershëm për shfrytëzimin e radiofrekuencave dhe

6) dorëzimin e shkresave për paraqitjen e interesit për shfrytëzimin e radiofrekuencave të shpallura në afat që nuk mund të jetë më i shkurtër se afati i përcaktuar për kohëzgjatjen e debatit publik nga paragrafi (3) i këtij neni.

(6) Agjencia në ueb faqen e saj do t'i publikojë rezultatet nga debati publik, si dhe qëndrimin e saj për to, me ç'rast Agjencia:

- do të shpallë tender publik ose tender publik me ankand publik kur numri i pranuar i shkresave për paraqitjen e interesit nga paragrafi (5) pika 6 e këtij neni është më i madh se numri i publikuar i lejeve për shfrytëzimin e radiofrekuencave që do të lëshohen;

- do të zbatojë procedurë për lëshimin e lejeve për shfrytëzimin e radiofrekuencave në bazë të kërkesës së shfrytëzimit të radiofrekuencave në pajtim me nenin 133 të këtij ligji në afat të përcaktuar nga Agjencia, kur numri i pranuar i shkresave për paraqitjen e interesit nga paragrafi (5) pika 6 e këtij neni është më i vogël ose i barabartë me numrin e publikuar të lejeve për shfrytëzimin e radiofrekuencave që do të lëshohen.

(7) Agjencia është e detyruar që të marrë vendim për shpalljen e tenderit publik pse tenderit publik me ankand publik në afat prej 21 ditësh pas kalimit të afatit për dorëzim të shkresave për paraqitjen e interesit.

(8) Agjencia, së paku njëherë në vit ose në bazë të kërkesës së bazuar të pranuar nga pala e interesuar, doemos duhet t'i rishqyrtojë shkaqet për numrin e kufizuar të lejeve për shfrytëzimin e radiofrekuencave nga paragrafi (5) pika 2 e këtij neni, në mënyrë që do të mundësojë debat publik me të gjitha palët e interesuara.

(9) Agjencia mund ta revokojë kufizimin lidhur me numrin e lejeve për shfrytëzimin e radiofrekuencave, nëse nga debati publik nga paragrafi (8) i këtij neni del se shkaqet për të cilat Agjencia ka bërë kufizimin e numrit të lejeve për shfrytëzimin e radiofrekuencave kanë pushuar së ekzistuesi ose se kjo është e nevojshme të sigurohen volitshmëri më të mira për shfrytëzuesit dhe të nxitet konkurrenca.

Neni 135

Mënyra e lëshimit të lejes për shfrytëzimin e radiofrekuencave nëpërmjet tenderit publik

(1) Agjencia zbaton procedurë të tenderit publik për lëshimin e lejes për shfrytëzimin e radiofrekuencave në bazë të vendimit për shpalle të tenderit publik që e miraton drejtori i Agjencisë.

(2) Vendimi nga paragrafi (1) i këtij neni veçanërisht përmban:

- dedikimin e radiofrekuencave që janë lëndë e tenderit publik, shërbimet e radiokomunikimit që duhet të sigurohen dhe sferat ose lokacionet ku radiofrekuencat e tilla duhet të shfrytëzohen,
- numrin e lejeve për shfrytëzimin e radiofrekuencave që do të ndahen;
- kushtet, kërkesat dhe kualifikimet që duhet t'i përmbushin ofertuesit, të cilët doemos duhet të jenë në pajtim me rregullativën dhe rregullat ligjore për planifikim hapësinor,
- kriteret për zgjedhje të ofertës më të mirë, mënyrën e zbatimit të tyre dhe kufizimet tjera të mundshme që duhet të merren parasysh gjatë vlerësimit të ofertave,
- shumën fillestare të vlerës tregtare të radiofrekuencave, si dhe kompensimin e njëhershëm për marrjen e lejes për shfrytëzimin e radiofrekuencave dhe mënyrën e pagesës,
- afatin dhe mënyrën e parashtrimit të ofertave,
- adresën, vendin, datën dhe kohën e hapjes publike të ofertave,
- vendin, kohën dhe personin për kontakt nga i cili palët e interesuara mund ta marrin dokumentacionin e tenderit, çmimin e dokumentacionit të tenderit dhe mënyrën e pagesës së tij.
- personi për kontakt nga i cili ofertuesit mund të marrin informata plotësuese, dhe
- afatin në të cilin ofertuesit do të njoftohen për vendimin e miratuar.

(3) Kriteret për zgjedhje në bazë të të cilit do të miratohet vendim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm doemos duhet të bazohen në parimet e objektivizmit, transparencës, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit, me ç'rast duhet të mbahet llogari edhe për realizimin e qëllimeve dhe parimeve rregullatore të përcaktuara me këtë ligj.

(4) Agjencia vendimin nga paragrafi (1) i këtij neni e boton në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".

(5) Procedura e tenderit publik nga paragrafi (1) i këtij neni zbatohet nëpërmjet komisionit të veçantë të cilin e formon drejtori i Agjencisë nga radhët e të punësuarve në shërbimin profesional të Agjencisë. Një nga anëtarët e komisionit duhet doemos të jetë me fakultet të kryer juridik.

(6) Për parandalimin e konfliktit të interesave në procedurat për lëshimin e lejes për shfrytëzimin e radiofrekuencave nëpërmjet tenderit publik në mënyrë adekuate zbatohen dispozitat e Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave.

(7) Kryetari, zëvendëskryetari, anëtarët dhe zëvendësanëtarët e komisionit nga paragrafi (5) i këtij neni, si dhe drejtori i Agjencisë nënshkruajnë deklaratë për mosekzistimin e konfliktit të interesave, si dhe për atë se për periudhën prej një viti nga dita e miratimit të vendimit për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm nuk do të punësohen në organet e menaxhimit të ofertuesit të zgjedhur. Deklarata paraqet pjesë të dosjes nga procedura e zbatuar.

(8) Në rast të konfliktit të interesave te kryetari, zëvendësi tij, anëtarët dhe zëvendësanëtarët e tyre në komisionin nga paragrafi (5) i këtij neni, të njëjtët tërhiqen nga puna e komisionit dhe zëvendësohen me persona tjerë.

Neni 136

Afati i parashtrimit të ofertave

(1) Afati për parashtrimin e ofertave nuk guxon të jetë më i shkurtër se 30 ditë nga dita e publikimit të vendimit për shpalljen e tenderit publik.

(2) Agjencia nuk do t'i pranojë ofertat, ndryshimet ose plotësimet e tyre, të cilat kanë arritur pas kalimit të afatit nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Nëse ofertat nga paragrafi (2) i këtij neni janë dërguar me postë, ato duhet doemos t'i kthehen dërguesit të vulosur pa u hapur paraprakisht.

(4) Agjencia është e detyruar që t'i ruajë sekret listën e ofertuesve dhe ofertat e paraqitura deri në kalimin e afatit nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 137

Dokumentacioni i tenderit

Agjencia është e detyruar që në dokumentacionin e tenderit t'i sqarojë të gjitha dispozitat nga vendimi për shpalljen e tenderit publik, duke i theksuar kriteret për zgjedhje, si dhe dokumentacion plotësues që duhet doemos të sigurohet që ofertat të konsiderohen si të pranueshme.

Neni 138

Procedura për hapje publike të ofertave

(1) Hapja e ofertave është publike.

(2) Komisioni nga neni 135 paragrafi (5) i këtij ligji mban procesverbal për procedurën e hapjes së ofertave, i cili ndër të tjera duhet të përmbajë numër arkivor të ofertës, të dhënat për ofertuesit dhe çmimin e ofruar, ndërsa nëse tenderi është anonim, të dhënat për titullin ose shifrën e ofertuesve.

(3) Gjatë gjithë procedurës duhet të mbahet llogari që sekretet afariste të ofertuesve të mos publikohen.

(4) Në hapjen publike përcaktohet nëse ofertuesit i përmbajnë të gjitha dokumentet e nevojshme sipas dokumentacionit të tenderit, por njëkohësisht nuk shqyrtohet përmbajtje e dokumentacionit të parashtruar.

(5) Vetëm ofertat që janë dorëzuar në afatin e caktuar kohor dhe të cilat janë rregullisht të kompletuara dhe të etiketuara do të hapen.

(6) Tenderi publik është i suksesshëm, nëse është pranuar së paku një ofertë në kohë dhe e rregullt që i përmbush kushtet e tenderit.

(7) Në vendimin për tender publik, Agjencia mund të konstatojë se tenderi publik konsiderohet i suksesshëm, nëse është pranuar numër tjetër minimal i ofertave që i përmbushin kushtet e tenderit.

Neni 139

Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave

(1) Pas përfundimit të hapjes publike të ofertave, Komisioni nga neni 135 paragrafi (5) i këtij ligji fillimisht konstaton nëse të gjitha dokumentet nga oferta i përmbushin kushtet e tenderit dhe nëse ato janë në pajtim me ligjin.

(2) Komisioni nga neni 135 paragrafi (5) i këtij neni do t'i refuzojë nga procedura e mëtutjeshme ofertat që nuk janë në pajtim me ligjin dhe dokumentacionin e tenderit.

(3) Pas shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave të zbatuara, Komisioni nga neni 135 paragrafi (5) të këtij ligji përpilon raport në të cilin i prezanton vlerësimet e ofertave dhe përpilon rang listë të ofertave sipas përmbushjes së kushteve nga dokumentacioni i tenderit.

(4) Komisioni nga neni 135 paragrafi (5) i këtij ligji gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave doemos duhet t'i marrë parasysh vetëm ato kritere për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm që janë përcaktuar me ligj dhe me vendimin nga neni 135 paragrafi (2) të këtij ligji dhe dokumentacionin e tenderit, e veçanërisht ato që mundësojnë shfrytëzim më efikas të spektrit të radiofrekuencës dhe avancim dhe mbrojtje të konkurrencës.

(5) Drejtori i Agjencisë, në pajtim me Raportin e Komisionit nga neni 135 paragrafi (5) i këtij ligji, në afat prej dhjetë ditësh nga dita e pranimit të Raportit do të miratojë Vendim për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm. Drejtori i Agjencisë në pajtim me Vendimin për zgjedhje të ofertuesit më të volitshëm do të lëshojë një ose më shumë leje për shfrytëzimin e radiofrekuencave jo më vonë se 60 ditë nga kalimi i afatit kohor për dorëzimin e ofertave.

(6) Vendimi për zgjedhjen e ofertuesit nga paragrafi (5) i këtij neni, dorëzohet te të gjithë ofertuesit që kanë marrë pjesë në tenderin publik në afat prej pesë ditësh nga dita e miratimit të tij dhe të njëjtin Agjencia e publikon në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë dhe në ueb faqen e saj.

Neni 140

Mënyra e lëshimit të lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave në formë të tenderit publik me ankand publik

(1) Agjencia lëshon leje të veçantë për shfrytëzimin e radiofrekuencave nëpërmjet procedurës së zbatuar paraprakisht të tenderit publik me ankand publik kur, si kriter i vetëm për zgjedhjen e ofruesit më të volitshëm është çmimi.

(2) Drejtori i Agjencisë miraton vendim për zbatim të procedurës së tenderit publik me ankand publik dhe kjo duhet të përmbajë:

- radiofrekuenca që janë lëndë të tenderit publik, shërbime radiokomunikuese që duhet të sigurohen dhe sferat apo lokacionet ku radiofrekuencat duhet të shfrytëzohen,
- numrin e lejeve për shfrytëzim të radiofrekuencave që do të ndahen;
- kushtet dhe kërkesat që duhet të plotësohen nga ofruesit që të kualifikohen për procedurën e ankandit publik,

- numrin minimal të ofruesve, i cili duhet së paku të jetë për një më i madh se numri i lejeve për shfrytëzim të radiofrekuencave të përcaktuara në paragrafin (2) pika b) të këtij neni,

- shumën fillestare të vlerës së tregut të radiofrekuencave si kompensim i njëfishtë për marrjen e lejes për shfrytëzimin e radiofrekuencave dhe mënyrën e pagesës, me ç'rast ofruesit nuk guxojnë të ofrojnë shumë më të vogël apo shumë të njëjtë fillestare,

- shuma e depozitës që duhet të paguhet, që nuk mund të jetë më e lartë se 10% nga shuma fillestare e vlerës së tregut të radiofrekuencave, si dhe mënyra dhe afati për pagesën e tij me vërejtje se ofruesi që nuk do të zgjidhet ofrues më i volitshëm në procedurën e ankandit publik depozita e paguar i kthehet në afat prej pesë ditësh nga dita e mbarimit të ankandit publik, kurse ofruesit që do të zgjidhet si ofrues më i volitshëm depozita e paguar nuk i kthehet, por ky bëhet pjesë përbërëse e çmimit të ofruar të zgjedhur nga ankandi publik,

- mënyrën dhe afatin për pagesën e çmimit më të lartë të ofruar të përcaktuar gjatë ankandit publik,

- rregulla për zbatim të procedurës për ankand publik në pajtim me këtë ligj dhe

- afatin në të cilin Agjencia do ta miratojë vendimin për zgjedhjen e një apo më tepër ofruesve që nuk mund të jetë më i gjatë se 10 ditë nga dita e mbarimit të ankandit publik.

(3) Ankandi publik mund të mbarojë nëse për lejen e njëjtë për shfrytëzim të radiofrekuencave që është lëndë e tenderit publik me ankand publik kualifikohen së paku dy ofrues.

(4) Nëse në procedurën e tenderit publik me ankand publik për lejen e njëjtë për shfrytëzim të radiofrekuencave që është lëndë e tenderit publik me ankand publik kualifikohet vetëm një ofrues, drejtori i Agjencisë, në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të raportit të komisionit për zbatim të tenderit publik me ankand publik do të miratojë vendim me të cilin do të përcaktojë se procedura sipas tenderit publik me ankand publik ka mbaruar.

(5) Drejtori i Agjencisë në afat prej dhjetë ditësh nga dita e miratimit të vendimit nga paragrafi (4) i këtij neni do të miratojë vendim për lëshim të lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave të ofruesit të kualifikuar nga paragrafi (4) i këtij neni.

(6) Nëse në procedurën e tenderit publik me ankand publik për lejen e njëjtë për shfrytëzim të radiofrekuencave që është lëndë e tenderit publik me ankand publik kualifikohen së paku dy ofrues, drejtori i Agjencisë, në propozim të komisionit për zbatim të tenderit publik me ankand publik në afat prej tri ditësh nga dita e pranimit të propozimit miraton vendim për zgjedhje të ofruesve që do të marrin pjesë në procedurën e ankandit publik. Në vendimin përcaktohet vendi dhe koha e mbajtjes së ankandit publik që nuk mund të jetë më e shkurtër se 14 ditë dhe më e gjatë se 30 ditë nga dita e miratimit të vendimit. Vendimi me ofertën për pjesëmarrje për ankand publik dorëzohet njëkohësisht të gjithë ofruesit e kualifikuar në afat prej tri ditësh nga dita e miratimit të tij.

(7) Agjencia vendimet nga paragrafët (2), (4) dhe (5) të këtij neni i boton në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë" dhe në ueb faqen e saj.

(8) Dispozitat nga neni 135 paragrafët (5), (6), (7), (8) dhe (9), si dhe dispozitat nga nenet 136, 137, 138 dhe 139 të këtij ligji në mënyrë përkatëse zbatohen edhe në procedurën për zbatim të tenderit publik me ankand publik.

Neni 141

Mënyra e zbatimit të ankandit publik

(1) Ankandin publik e zbaton kryetari apo zëvendëskryetari i Komisionit për zbatim të tenderit publik me ankand publik, në pajtim me këtë ligj.

(2) Ankandi publik mbahet në hapësirat e Agjencisë në formë të ankandit gojor.

(3) Ankandi publik mund të kryhet edhe nëpërmjet mënyrës tjetër përkatëse të përcaktuar nga Agjencia në vendim nga neni 140 paragrafi (2) të këtij ligji, me ç'rast duhet të sigurohet secili ofrues drejtpërdrejtë dhe në vijimësi ta ndjek ankandin publik të ofruesve tjerë dhe të mund pa kurrfarë pengesash të dorëzojë oferta të tij.

(4) Në procedurën e ankandit publik ofruesit gjatë secilit ankand nuk mund të ofrojnë rritjen e ofertës më të ulët se tre përqind nga shuma fillestare e vlerës së tregut të radiofrekuencave nga neni 140 të këtij ligji.

(5) Në procedurën e ankandit publik kryetari apo zëvendëskryetari i Komisionit nga neni 140 të këtij ligji e publikon shumën fillestare të vlerës së tregut të radiofrekuencave dhe i fton ofruesit të fillojnë me ofrimin e ofertave më të larta. Para se ta përcaktojë ofertën më të lartë kryetari apo zëvendëskryetari i Komisionit duhet tri herë t'i ftoj ofruesit të dorëzojnë ofertë më të lartë.

(6) Nëse edhe pas herës së tretë për dorëzimin e ofertës më të lartë, nuk dorëzohet oferta më e lartë nga oferta ekzistuese, kryetari apo zëvendëskryetari i Komisionit publikon se oferta ekzistuese është më e larta, pas së cilës nuk mund të dorëzohen oferta të reja.

(7) Nëse në zbatimin e procedurës së ankandit publik kryetari apo zëvendëskryetari i Komisionit, përcaktojnë se dy apo më tepër ofrues kontraktohen apo në mënyrë të ndërsjellë koordinohen për mënyrën dhe lartësinë e shumës së ankandit publik, këta mund të mënjahohen nga procedura e mëtejshme e ankandit publik.

(8) Për procedurën e zbatuar të ankandit publik Komisioni nga neni 140 të këtij ligji mban procesverbal në bazë të të cilit drejtori i Agjencisë miraton vendim për zgjedhjen e ofruesit më të volitshëm.

(9) Agjencia në pajtim me vendimin për zgjedhjen e ofruesit më të volitshëm do të lëshojë një apo më tepër leje për shfrytëzimin e radiofrekuencave jo më vonë se 90 ditë nga kalimi i afatit kohor për dorëzimin e ofertave.

(10) Vendimi për zgjedhjen e ofruesit më të volitshëm nga paragrafi (9) të këtij neni, dorëzohet te të gjithë ofruesit që kanë marrë pjesë në ankandin publik në afat prej pesë ditësh nga dita e miratimit të tij dhe këtë Agjencia e publikon në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë dhe në ueb faqen e saj.

(11) Nëse ofruesi i zgjedhur refuzon t'i lëshohet leja për shfrytëzimin e radiofrekuencave apo nuk e paguan çmimin e ofruar të ankandit publik në mënyrën dhe në afatin e përcaktuar në vendim nga neni 140 paragrafi (2) të këtij ligji, leja për shfrytëzimin e radiofrekuencave do t'i ofrohet ofruesit të ranguar të dytë. Nëse edhe ofruesi i ranguar i dytë refuzon t'i lëshohet leja për shfrytëzim të radiofrekuencave, procedura e tenderit publik me ankand publik mbaron pa lëshim të lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave.

(12) Nëse në procedurën për lëshim të lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave në formë të tenderit publik me ankand publik nuk bëhet zgjedhja e ofruesit më të volitshëm apo nuk lëshohet leja për shfrytëzim të radiofrekuencave, lëshimi i lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave të pandara do të bëhet me procedurën në pajtim me nenin 134 të këtij ligji.

Neni 142

Përmbajtja e lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave

(1) Leja për shfrytëzim të radiofrekuencave përmban:

- a) të dhëna për bartësin e lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave;
- b) radiofrekuenca të ndara;
- v) obligim për sigurim të shërimit apo për shfrytëzim të llojit të teknologjisë për të cilat janë ndarë radiofrekuencat, duke i përfshirë edhe kërkesat për mbulim dhe cilësi, aty ku është e zbatueshme;
- g) kushte për shfrytëzim efektiv dhe efikas të radiofrekuencave të ndara;
- d) kushte teknike dhe operative që duhet të plotësohen që t'u shmangen interferencave të dëmshme dhe që të kufizohet ekspozimi në opinion në fushat elektromagnetike, aty ku kushtet e këtilla janë të ndryshme nga ato të përcaktuara me këtë ligj;
- gj) mbulim territorial, aty ku është e zbatueshme;
- e) datën e lëshimit, kohëzgjatjen e vlefshmërisë së lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave, kurse aty ku është e zbatueshme edhe të dhënat për identifikim në eter;
- zh) mundësinë dhe kushte për bartje apo lëshim të së drejtës për shfrytëzim të radiofrekuencave të ndara;
- z) kompensim për shfrytëzim të radiofrekuencave në pajtim me këtë ligj;
- x) të gjitha obligimet që i ka marrë pronari i lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave nëse kjo lëshohet sipas procedurës së tenderit publik apo tenderit publik me ankand publik;
- i) obligime që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare që i referohen shfrytëzimit të radiofrekuencave, aty ku është e zbatueshme;
- j) kushte të posaçme për shfrytëzim eksperimental të radiofrekuencave, dhe
- k) kushte që duhet të plotësohen gjatë shfrytëzimit të radiofrekuencave të ndara.

(2) Pronari i lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave detyrohet ta njoftojë Agjencinë për ndryshimin në të dhënat nga paragrafi (1) pika a) të këtij neni, në afat prej 30 ditësh nga dita e bërjes së ndryshimit.

Neni 143

Kohëzgjatja e vlefshmërisë së lejes

(1) Agjencia lëshon leje për shfrytëzim të radiofrekuencave për kohë jo më të gjatë se 20 vjet.

(2) Agjencia lëshon leje për shfrytëzim të radiofrekuencave për objekte aviacioni dhe objekte lundrimi me vlefshmëri deri në pushimin e përdorimit të tyre.

(3) Agjencia lëshon leje të përkohshme për shfrytëzim të radiofrekuencave për sferën e kufizuar të mbulimit, dedikimeve për shqyrtim, matjeve dhe atestimit të pajisjes radiokomunikuese, për kohë jo më të gjatë se 90 ditë.

(4) Agjencia lëshon leje të përkohshme për shfrytëzim të radiofrekuencave të dedikuara për ngjarje të posaçme për kohë jo më të gjatë se 60 ditë.

(5) Agjencia lëshon leje të përkohshme për shfrytëzim të radiofrekuencave për qëllime eksperimentale, për sferën e kufizuar të mbulimit, për shkak të futjes së teknologjive të reja, për kohë jo më të gjatë se një vit dhe nëse me këtë nuk do të shkaktohet interferencë e dëmshme.

Neni 144

Vazhdimi i kohëzgjatjes së vlefshmërisë së lejes

(1) Kohëzgjatja e vlefshmërisë së lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave mund të vazhdohet me kërkesë të pronarit të saj.

(2) Kërkesa për vazhdim të vlefshmërisë së lejes dorëzohet te Agjencia, në afat jo më të shkurtër se 30 ditë dhe jo më të gjatë se gjashtë muaj, para kalimit të vlefshmërisë së saj.

(3) Gjatë shqyrtimit të kërkesës nga paragrafi (2) i këtij neni, Agjencia duhet t'i ketë parasysh:

1) volitshmëritë për shfrytëzuesit;

2) nevojën nga nxitja e konkurrencës dhe zhvillimi i teknologjive të reja, dhe

3) politikën rregullatore lidhur me shfrytëzimin e radiofrekuencave.

(4) Nëse vlerësohet se janë plotësuar kushtet nga paragrafi (3) të këtij neni, drejtori i Agjencisë në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (2) të këtij neni do të miratojë vendim për vazhdim të vlefshmërisë së lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave. Në këtë rast Agjencia lëshon leje të re, për kohë jo më të gjatë se njëzet vjet.

(5) Vlefshmëria e lejeve të përkohshme për shfrytëzim të radiofrekuencave nga neni 143 paragrafët (3), (4) dhe (5) të këtij ligji nuk mund të vazhdohet.

Neni 145

Bartja apo lëshimi i të drejtës së shfrytëzimit të radiofrekuencave

(1) Pronari i lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave, të drejtën e tij për shfrytëzim të këtyre radiofrekuencave, mund t'ia bart apo t'ia lëshojë personit tjetër fizik apo juridik, nëse e drejta e këtyre për këto radiofrekuenca parashihet në Planin për ndarje dhe shfrytëzim të radiofrekuencave dhe në lejen për shfrytëzim të radiofrekuencave, e me vendim e marrë paraprakisht për pajtimin nga Agjencia.

(2) Për bartjen apo lëshimin e të drejtës për shfrytëzim të radiofrekuencave nga paragrafi (1) i këtij neni pronari i lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave te Agjencia dorëzon kërkesë me shkrim. Agjencia kërkesën e publikon në ueb faqen e saj në afat prej tre ditësh nga dita e pranimit të kërkesës.

(3) Pas kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia përcakton nëse kërkuesi i ka paguar të gjitha kompensimet që në pajtim me këtë ligj ka qenë i detyruar t'i paguajë dhe nëse personi fizik apo juridik të cilit i propozohet të bartet apo lëshohet e drejta e shfrytëzimit të radiofrekuencave i plotëson të gjitha kushtet e përcaktuara me këtë ligj, rregullat e miratuara në bazë të tij dhe kushtet për shfrytëzim të radiofrekuencave në lejen për shfrytëzim të radiofrekuencave, si dhe ajo nëse me bartjen apo lëshimin e të drejtës për shfrytëzim të radiofrekuencave do të prishet konkurrenca.

(4) Në rast të bartjes së të drejtës për shfrytëzim të radiofrekuencave, Agjencia personit tjetër fizik apo juridik i lëshon leje të re për shfrytëzim të radiofrekuencave me vlefshmëri të lejes deri në kalimin e kohëzgjatjes së lejes ekzistuese për shfrytëzim të radiofrekuencave. Lejen e re për

shfrytëzim të radiofrekuencave Agjencia e lëshon pa zbatim të procedurës së tenderit publik apo procedurës së tenderit publik me ankand publik. Kushtet për shfrytëzimin e radiofrekuencave të përmbajtura në lejen ekzistuese për shfrytëzim të radiofrekuencave barten edhe në lejen e re, përveç, nëse Agjencia nuk vendos ndryshe.

(5) Dispozitat e këtij neni nuk zbatohen në të drejtën e shfrytëzimit të radiofrekuencave që dedikohen për kryerje të veprimtarisë radiodifuzive.

Neni 146

Ndryshimi i lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave

(1) Agjencia, me detyrë zyrtare, mund ta ndryshojë lejen për shfrytëzim të radiofrekuencave, në rast të:

- a) ndryshimeve të të dhënave të pronarit të lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave;
- b) garantimit të sigurisë publike;
- v) ndryshimeve të Planit për dedikim të sferë veprimeve radiofrekuencave, Planit për ndarje dhe shfrytëzim të radiofrekuencave apo rregullave për kushtet për shfrytëzim të radiofrekuencave;
- g) shmangies së interferencës së dëmshme që nuk mund t'i shmanget në mënyrën tjetër;
- d) harmonizimit me aktet e të drejtës ndërkombëtare të zbatueshme në Republikën e Maqedonisë;
- gj) ekzistimit të interesit publik që nuk mund të plotësohet në mënyrë ndryshe;
- e) sigurimit të shfrytëzimit efikas të spektrit të radiofrekuencës, apo
- zh) sigurimit të shërbimit universal;

(2) Në rastet në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni pikat a), b), v), g) dhe d) të këtij neni Agjencia miraton aktvendim për ndryshim të lejes së lëshuar dhe mund të caktojë afat të arsyeshëm kohor i cili nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë gjatë të cilit pronari i lejes mund ta përshtatë punën e saj.

(3) Në rastet nga paragrafi (1) pikat gj), e) dhe zh) të këtij neni, Agjencia para se të miratojë aktvendim për ndryshimin e lejes së lëshuar me shkrim do ta njoftojë pronarin e lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave dhe do t'i japë mundësi në afat prej 14 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit ta shpreh mendimin e tij lidhur me ndryshimin e propozuar të lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave.

(4) Në rastet nga paragrafi (1) pikat gj), e) dhe zh) të këtij neni, ndërsa nëse bëhet fjalë për ndryshim të rëndësishëm të lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave, Agjencia detyrohet që ndryshimin e propozuar të lejes ta publikojë në ueb faqen e saj me qëllim të mundësojë debat publik me të gjitha palët e interesuara, në pajtim me këtë ligj. Në këtë rast Agjencia e revokon lejen ekzistuese dhe lëshon leje të re për shfrytëzim të radiofrekuencave, në afat prej 30 ditësh nga dita e miratimit të aktvendimit me të cilën është revokuar leja ekzistuese. Vlefshmëria e lejes së re për shfrytëzim të radiofrekuencave është deri në kalimin e kohëzgjatjes së lejes ekzistuese për shfrytëzim të radiofrekuencave.

(5) Ndryshimi i lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave mund të bëhet edhe me kërkesë të pronarit të lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave.

(6) Nëse kërkesa nga paragrafi (5) të këtij neni u referohet rasteve në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni pikat a), b), v), g) dhe d) të këtij neni, Agjencia do të miratojë aktvendim për ndryshimin e lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave në afat jo më të gjatë se 30 ditë nga dita e pranimit të kërkesës.

(7) Nëse kërkesa nga paragrafi (5) i këtij neni u referohet rasteve në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni pikat gj), e) dhe zh) të këtij neni, Agjencia do të miratojë aktvendim për ndryshimin e lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave në afat jo më të gjatë se 60 ditë nga dita e pranimit të kërkesës, ndërsa pas zbatimit të procedurës në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni.

(8) Nëse kërkesa nga paragrafi (5) i këtij neni u referohet rasteve në pajtim me paragrafin (1) të këtij neni pikat gj), e) dhe zh) të këtij neni, dhe bëhet fjalë për ndryshim të rëndësishëm të lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave, Agjencia do të veprojë në pajtim me paragrafin (4) të këtij neni.

Neni 147

Revokimi i lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave

(1) Agjencia mund të revokojë lejen për shfrytëzim të radiofrekuencave me kërkesë të pronarit të lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave.

(2) Agjencia do të miratojë aktvendim me të cilin do të revokohet leja për shfrytëzim të radiofrekuencave në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (1) i këtij neni.

(3) Agjencia mund ta revokojë lejen për shfrytëzim të radiofrekuencave me detyrë zyrtare sipas procedurës së përcaktuar në nenin 48 të këtij ligji nëse përcaktohet se:

a) leja për shfrytëzim të radiofrekuencave përmban të dhëna të pasakta të cilat janë theksuar në kërkesën për lëshim të lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave;

b) nuk plotësohen obligimet që i ka marrë pranuesi i lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave, në procedurën e tenderit publik apo tenderit publik me ankand publik;

v) shkelen disa nga kushtet për shfrytëzim të radiofrekuencave të përcaktuara në lejen për shfrytëzim të radiofrekuencave në pajtim me këtë ligj dhe rregullat e miratuara në bazë të tij;

g) është bartur apo lëshuar e drejta e shfrytëzimit të radiofrekuencave pa marrjen paraprake të pëlqimit nga Agjencia;

d) nuk janë paguar kompensimet për shfrytëzim të radiofrekuencave, dhe pas dorëzimit të njoftimit me shkrim në pajtim me këtë ligj;

gj) në mënyrën tjetër nuk mund t'i shmanget interferencës së dëmshme të shkaktuar nga sinjalet e pajisjeve radiokomunikuese ndaj pajisjeve, receptorëve, sistemeve elektrike apo elektronike tjera apo

e) nëse bartësi i lejes nuk ka filluar t'i shfrytëzojë radiofrekuencat në afat prej një viti nga lëshimi i lejes, përveç nëse ndryshe nuk parashihet me këtë.

(4) Agjencia do të miratojë aktvendim me të cilin do të revokohet leja për shfrytëzim të radiofrekuencave dhe me njoftim me shkrim për marrjen e lejes për emetim televiziv apo të radios nga trupi rregullator që është kompetent për radiodifuzion. Agjencia do ta miratojë aktvendimin në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të njoftimit.

(5) Kompensimet për shfrytëzim të radiofrekuencave që janë paguar për vitin në të cilën është revokuar leja nuk kthehen, në rastet nga paragrafi (3) i këtij neni.

(6) Agjencia do t'i shlyejë nga regjistri i radiofrekuencave të ndara nga neni 130 të këtij ligji të dhënat për pronarin e lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave të cilit kjo i revokohet në pajtim me dispozitat e këtij neni. Aktvendimin me të cilën revokohet leja për shfrytëzim të radiofrekuencave, Agjencia e publikon në ueb faqen e saj në afat prej pesë ditësh nga dita e miratimit të tij.

Neni 148

Shfuqizimi i lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave me fuqinë e ligjit

(1) Lejet për shfrytëzim të radiofrekuencave me fuqinë e ligji shfuqizohen:

a) pas kalimit të afatit kohor për të cilën këto janë lëshuar;

b) nëse pronari i lejes ka pushuar të ekzistojë;

v) nëse pronari i lejes është në procedurën e falimentimit apo likuidimit;

gj) nëse pronarit të lejes i shqiptohet masë e sigurisë - ndalim për ushtrim të veprimtarisë apo

d) me shfuqizimin e lejes për emetim televiziv apo të radios me fuqinë e ligjit.

(2) Agjencia do t'i shlyejë nga regjistri i radiofrekuencave të ndara nga neni 130 i këtij ligji të dhënat për pronarin e lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave që është shfuqizuar me fuqinë e ligjit në pajtim me dispozitat e këtij neni. Aktvendimin me të cilin përcaktohet shfuqizimi i lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave, me fuqinë e ligjit, Agjencia e publikon në ueb faqen e saj në afat prej pesë ditësh nga dita e miratimit të tij.

(3) Kompensimet për shfrytëzim të radiofrekuencave që janë paguar për vitin në të cilin është shfuqizuar leja, me përjashtim të paragrafit (1) pika a) nuk kthehen.

Kreu i pesëmbëdhjetë

NUMËRTIMI

Neni 149

Plani për numërtim

(1) Plani për numërtim e përcakton strukturën, gjatësinë dhe dedikimin e numrave dhe serive të numrave që i shfrytëzojnë operatorët dhe personat tjerë juridikë të përcaktuara në nenin 151 të këtij ligji me qëllim të sigurohet identifikimi, kursi dhe arkëtimi.

(2) Planin për numërtim nga paragrafi (1) i këtij neni e miraton Agjencia në pajtim me këtë ligj dhe marrëveshjet ndërkombëtare që i ka lidhur apo të cilave u është qasur Republika e Maqedonisë me qëllim:

a) të sigurohet strukturimi efikas dhe përdorimi i numrave dhe serive të numrave;

b) të plotësohen kushtet e operatorëve dhe personave tjerë juridikë që kanë të drejtë të ndarjes së numrave dhe/apo serive të numrave në pajtim me këtë ligj dhe

v) të sigurohet ndarja dhe shfrytëzimi i numrave dhe/apo serive të numrave në mënyrën objektive, jodiskriminuese dhe transparente.

(3) Në rast të ndryshimit të Planit për numërtim nga paragrafi (1) të këtij neni, që do të shkaktojë ndryshime të rëndësishme në sistemin e numërimit dhe teknologjisë ekzistuese me të cilën sigurohen shërbimet komunikuese elektronike publike, ndryshimi i Planit nuk guxon të zbatohet në afat më të shkurtër prej dy vitesh nga dita e miratimit të tij.

(4) Agjencia mban regjistrin e numrave të ndarë dhe/apo serive të numrave dhe pronarëve të numrave të ndarë dhe/apo serive të numrave dhe këtë e publikon në ueb faqen e saj. Formën dhe përmbajtjen e regjistrit i përcakton Agjencia.

Neni 150

Shfrytëzimi i numrave

(1) Agjencia me aktvendim u ndanë numra dhe/apo seri të numrave nga Plani për numërtim operatorëve dhe personave tjerë juridikë të përcaktuar në nenin 151 të këtij ligji.

(2) Operatorët i shfrytëzojnë numrat e ndarë dhe/apo seritë e numrave në pajtim me aktvendimin nga paragrafi (1) i këtij neni dhe dispozitat nga neni 116 të këtij ligji.

(3) Agjencia i ndanë numrat dhe/apo seritë e numrave nga Plani për numërtim në kohë të pacaktuar.

Neni 151

Procedura për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave

(1) Agjencia i ndanë numrat dhe/apo seritë e numrave nga Plani për numërtim në bazë të kërkesës së parashtruar me shkrim. Kërkesë për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave mund të parashtrrojë operatori, të cilit Agjencia i ka lëshuar vërtetim për regjistrim në pajtim me këtë ligj, dhënësi i shërbimit universal, si dhe personat tjerë juridikë që në pajtim me këtë ligj apo ligjin tjetër ushtrojnë veprimtari me interes publik.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni i përmban të dhënat në vijim:

a) emrin, selinë, dëshminë për regjistrim të veprimtarisë dhe të dhënat për përfaqësuesin ligjor;

b) dëshminë se kërkuesi ka të drejtë të ndarjes së numrave dhe/apo serive të numrave në pajtim me këtë ligj;

v) të dhënat për llojin, sasinë dhe qëllimin e shfrytëzimit të numrave dhe/apo serive të numrave që kërkohen;

g) planin për vlerësim të nevojave për vitin e ardhshëm, nëse kërkuesi planifikon në këtë periudhë të shfrytëzojë numër më të madh të numrave dhe/apo serive të numrave dhe

d) datën e planifikuar për fillimin me shfrytëzim të numrave të ndarë dhe/apo serive të numrave.

(3) Agjencia me akt më hollësisht e përcakton procedurën për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave, përmbajtjen dhe formën e kërkesës si dhe të dhënat që i bashkëngjiten kërkesës.

(4) Agjencia mund të refuzojë kërkesën për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave, nëse:

a) kërkesa për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave përmban të dhëna të pasakta;

b) personi që e ka parashtruar kërkesën nuk ka të drejtë t'i ndahen numrat dhe/apo seritë e numrave në pajtim me këtë ligj,

v) parashtruesit të kërkesës i është marrë aktvendimi për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave në pesë vitet e fundit me detyrë zyrtare, dhe

g) përdorimi i planifikuar nuk e arsyeton ndarjen e sasisë së kërkuar apo llojin e numrave dhe/apo serive të numrave.

(5) Drejtori i Agjencisë do të miratojë aktvendim për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave nga Plani për numërtim në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të tërë kërkesës për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave.

(6) Agjencia në bazë të debatit publik të zbatuar me të gjitha palët e interesuara mund të vendos që numra të caktuara dhe/apo seri të numrave nga Plani për numërtim që kanë vlerë të rëndësishme ekonomike t'i ndajë sipas procedurës së tenderit publik apo tenderit publik me ankand publik. Në këtë rast në mënyrë përkatëse zbatohen dispozitat nga nenet 134, 135 dhe 140 të këtij ligji.

(7) Operatorët në pajtim me aktvendimin për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave, numrat e ndarë dhe/apo seritë e numrave ua japin në shfrytëzim shfrytëzuesve të tyre të fundit.

(8) Operatorët në pajtim me aktvendimin për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave mund t'u ndajnë numra dhe/apo seri të numrave të siguriesve të shërbimeve tjera në bazë të marrëveshjes së lidhur me çmim që duhet t'i mbulojë vetëm shpenzimet reale të operatorit, me ç'rast operatori duhet ta respektojë parimin e jodiskriminimit.

(9) Marrëveshjet e lidhura nga paragrafi (8) të këtij neni operatori detyrohet t'i dorëzojë te Agjencia në afat prej pesë ditësh nga dita e lidhjes së tyre.

Neni 152

Përmbajtja e aktvendimit për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave

(1) Aktvendimi për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave nga neni 151 paragrafi (6) të këtij ligji duhet të përmbajë:

1) të dhëna për pronarin e të drejtës për shfrytëzim të numrave dhe/apo serive të numrave;

2) numra dhe/apo seri të numrave të ndarë, dhe

3) kushte për shfrytëzim të numrave dhe/apo serive të numrave në pajtim me nenin 153 të këtij ligji.

(2) Pronari i aktvendimit për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave detyrohet ta njoftojë Agjencinë për secilin ndryshim të të dhënave nga paragrafi (1) pika 1 të këtij neni në afat prej 30 ditësh nga dita e ndryshimit të bërë.

Neni 153

Kushtet për shfrytëzim të numrave dhe/apo serive të numrave

Kushtet për shfrytëzim të numrave dhe/apo serive të numrave nga neni 152 paragrafi (1) pika 3 të këtij ligji që mund të përcaktohen në aktvendim për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave janë:

a) caktimi i shërbimit për të cilën do të shfrytëzohet numri dhe/apo seria e numrave të ndarë, duke i përfshirë edhe kërkesat për sigurim të këtij shërbimi që t'u shmangen çfarëdo dyshimesh, tarifash dhe çmimesh maksimale që mund të zbatohen për numra dhe/apo seri të caktuara të numrave, me qëllim të sigurohet mbrojtja e shfrytëzuesve;

b) shfrytëzimi efektiv dhe efikas i numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë;

v) obligimet që dalin nga sigurimi i shërbimit të bartjes së numrit;

g) obligimi për dorëzimin e informatave të nevojshme për sigurim të listës së plotë të emrave telefonike në pajtim me këtë ligj;

d) kohëzgjatja maksimale e shfrytëzimit të numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë, që nuk mund të jetë më e shkurtër se një vit;

gj) bartja e të drejtës për shfrytëzim të numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë;

e) lartësia e kompensimit vjetor për shfrytëzim të numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë;

zh) obligimet që dalin nga procedura e tenderit publik apo tenderit publik me ankand publik, nëse kjo zbatohet, dhe

z) obligimet që dalin nga marrëveshjet ndërkombëtare që i ka lidhur apo të cilave u ka qasur Republika e Maqedonisë.

Neni 154

Ndryshimi i aktvendimit për ndarjen e numrave

(1) Agjenci, me detyrë zyrtare, mund të ndryshojë aktvendimin e miratuar paraprakisht për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave në rast të ndryshimit të Planit për numërtim në afat prej 30 ditësh nga dita e zbatimit të ndryshimit të Planit për numërtim. Në rastin e këtillë pronarët e të drejtës për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave nuk kanë të drejtë të kompensimit përkatës.

(2) Agjencia, nëse është e mundur teknikisht, mund të ndryshojë aktvendimin për ndarje të numrave edhe në kërkesë të pronarit të saj.

Neni 155

Bartja e të drejtës për shfrytëzim të numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë

(1) Pronari i aktvendimit për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave mund të drejtën e tij për shfrytëzim të numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë ta bart te personi tjetër juridik pas pëlqimit të marrë paraprakisht nga Agjencia.

(2) Për bartjen e të drejtës për shfrytëzim të numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë nga paragrafi (1) i këtij neni pronari i aktvendimit për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave te Agjencia dorëzon kërkesë me shkrim, në përbërjen e të cilit është edhe pëlqimi me shkrim nga personi juridik të cilit duhet t'i barten numrat e ndarë.

(3) Pas kërkesës nga paragrafi (2) të këtij neni, Agjencia përcakton se kërkuesi i ka paguar të gjitha kompensimet që në pajtim me këtë ligj ka qenë i detyruar t'i paguajë dhe nëse personi juridik të cilit i propozohet t'i bartet e drejta e shfrytëzimit të numrave dhe/apo serive të ndarë i plotëson kushtet për ndarje të numrave, në pajtim me nenin 153 paragrafin (1) të këtij ligji.

(4) Drejtori i Agjencisë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (2) të këtij neni miraton aktvendim me të cilën ia merr të drejtën e shfrytëzimit të numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë pronarit të aktvendimit për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave nga paragrafi (1) të këtij neni, kurse personit tjetër juridik të cilit i është bartur e drejta për shfrytëzim të numrave të ndarë, në afatin e njëjtë, i lëshohet aktvendim i ri për ndarje të atyre numrave dhe/apo serive të numrave.

Neni 156

Marrja e të drejtës për shfrytëzim të numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë

(1) Agjencia, me detyrë zyrtare e merr të drejtën e shfrytëzimit të numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë me procedurë të përcaktuar në nenin 48 të këtij ligji nëse përcakton se:

a) kërkesa për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave përmban të dhëna të pasakta;

b) pronari i të drejtës së shfrytëzimit të numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë më nuk i plotëson kushtet në pajtim me këtë ligj dhe aktvendimin e ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave;

v) pronari i aktvendimit për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave në pajtim me këtë ligj ia ka bartur të drejtën e shfrytëzimit personit tjetër juridik;

g) kompensimi vjetor për shfrytëzim të numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë nuk është paguar në afatin e caktuar, apo

d) pronari i të drejtës së shfrytëzimit të numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë nuk ka filluar t'i shfrytëzojë numrat dhe/apo seritë e numrave të ndarë në afat prej një viti nga dita e ndarjes.

(2) Agjencia e merr të drejtën e shfrytëzimit të numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë edhe pas kërkesës së pronarit të të drejtës për shfrytëzim të numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë.

(3) Drejtori i Agjencisë do të miratojë aktvendim për marrjen e të drejtës së shfrytëzimit të numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë në afat prej pesë ditësh nga dita e pranimit të kërkesës nga paragrafi (2) të këtij neni.

(4) Agjencia do t'i shlyejë nga regjistri i numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë të dhënat për numrat dhe/apo seritë e numrave të ndarë edhe për pronarin e aktvendimit për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave të cilit i është marrë e drejta për shfrytëzim të numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë në pajtim me dispozitat e këtij neni. Aktvendimin me të cilin është marrë e drejta për shfrytëzim të numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë, Agjencia e publikon në ueb faqen e saj në afat prej pesë ditësh nga dita e miratimit të tij.

Neni 157

Shfuqizimi i aktvendimit për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave me fuqinë e ligjit

(1) Aktvendimi për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave shfuqizohet me fuqinë e ligjit në rastet në vijim:

a) nëse pronari i aktvendimit për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave pushon të ekzistojë;

b) nëse pronari i aktvendimit për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave është në procedurën e falimentimit dhe likuidimit, apo

v) nëse pronarit të aktvendimit për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave i është shqiptuar masa e sigurisë - ndalim për ushtrim të veprimtarisë.

(2) Agjencia do t'i shlyejë nga regjistri i numrave dhe/apo serive të numrave të ndarë të dhënat për numrat dhe/apo serive të numrave të ndarë edhe për pronarin e aktvendimit për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave që është shfuqizuar me fuqinë e ligjit në pajtim me dispozitat e këtij neni. Aktvendimin me të cilën përcaktohet shfuqizimi i aktvendimit për ndarje të numrave dhe/apo serive të numrave, me fuqinë e ligjit, Agjencia e publikon në ueb faqen e saj në afat prej pesë ditësh nga dita e miratimit të tij.

Kreu i gjashtëmbëdhjetë

SHËRBIME DIGJITALE TË RADIOS DHE TELEVISIONIT

Neni 158

Shërbime digjitale të radios dhe televisionit, interoperabiliteti i shërbimeve televizive interaktive digjitale dhe interoperabiliteti i pajisjes televizive digjitale

(1) Rrjetet komunikuese publike nëpërmjet të cilave sigurohet bartja e shërbimeve televizive digjitale duhet t planifikohen në mënyrën me të cilën do të sigurohet bartja e shërbimeve dhe programeve televizive me format të ekranit të gjerë.

(2) Operatorët e rrjeteve komunikuese publike nga paragrafi (1) të këtij neni detyrohen gjatë pranimit dhe bartjes së sërishme të shërbimeve apo programeve televizive me ekran të gjerë ta mbajnë formatin e tyre.

(3) Siguruesit e shërbimeve televizive interaktive digjitale, pa marrë parasysh mënyrën e bartjes detyrohen të shfrytëzojnë API të hapur.

(4) Siguruesit e pajisjes televizive digjitale moderne të dedikuar për pranim të shërbimeve televizive interaktive digjitale nga platformat televizive digjitale interaktive duhet të shfrytëzohen API të hapura me kërkesat minimale të standardeve apo sprcifikave relevante.

(5) Agjencia operatorit mund t'i imponojë obligim të sigurojë qasje në API dhe udhëheqësit elektronik të programit me kushte të drejta, përkatëse dhe jodiskriminuese.

(6) Agjencia me akt nënligjor i përcakton kërkesat për interoperabilitet të shërbimeve televizive interaktive digjitale dhe kërkesave për interoperabilitet të pajisjes televizive digjitale që shfrytëzohet nga konsumatorët, me ç'rast duhet ta ketë parasysh sigurimin e interoperabilitetit të shërbimeve televizive për shfrytëzuesit e fundit me invaliditet.

Neni 159

Emetimi nëpërmjet sistemit terestrial digjital

(1) Operatori i multipleksit terestrial digjital të cilit Agjencia i ka lëshuar leje për shfrytëzim të radiofrekuencave për emetim të serviseve të programit të radiodifuzerëve që nga trupi rregullator kompetent për punët nga sfera e radiodifuzionit kanë marrë leje për emetim nëpërmjet multipleksit të tij terestrial digjital detyrohet t'i zbatojë parimet e objektivitetit, transparencës, proporcionalitetit dhe jodiskriminimit të barabartë ndaj të gjithë radiodifuzerëve.

(2) Operatori nga paragrafi (1) i këtij neni detyrohet të punojë në pajtim me këtë ligj dhe rregullat që dalin prej tij, si dhe në pajtim me Planin për dedikimin dhe shpërndarjen e kapaciteteve bartëse të multipleksit terestrial digjital që e miraton trupi rregullator kompetent për punët nga sfera e radiodifuzionit.

(3) Operatori nga paragrafi (1) i këtij neni detyrohet të gjitha kushtet dhe çmimet për emetim digjital t'i publikojë në ueb faqen e tij dhe t'i dorëzojë te Agjencia.

(4) Nëse operatori nga paragrafi (1) i këtij neni planifikon të bëjë ndryshime në kushtet dhe çmimet nga paragrafi (3) i këtij neni, detyrohet të Agjencia të dorëzojë njoftim me shkrim me arsyetim të hollësishëm për ndryshimet e planifikuara, në afatin që nuk mund të jetë më i shkurtër se 60 ditë nga dita e ndryshimit të planifikuar, me qëllim kjo të zbatojë aktivitete që të përcaktohet arsyetimi ekonomik për kushtet dhe çmimet dhe nëse nevojitet të merr masa në pajtim me këtë ligj dhe rregullat e miratuara në bazë të tij.

(5) Operatori nga paragrafi (1) i këtij neni detyrohet në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të njoftimit nga trupi rregullator kompetent për punët nga sfera e radiodifuzionit për lejet e ndara të radiodifuzerëve për emetim nëpërmjet multipleksit të tij terestrial të lidh marrëveshje me radiodifuzerin për emetim digjital në pajtim me kushtet dhe çmimet e përcaktuara në paragrafin (3) të këtij neni, kushtet në lejen e radiodifuzerit dhe të filloj në mënyrë digjitale ta emetojë servisin e tij të programit. Agjencia do ta përcaktojë formularin e marrëveshjes dhe këtë do ta publikojë në ueb faqen e saj.

(6) Marrëveshja nga paragrafi (5) i këtij neni lidhet për periudhën kohore që nuk mund të jetë më e shkurtër se periudha kohore për të cilën radiodifuzeri ka marrë lejen, kurse operatori detyrohet në afat prej shtatë ditësh nga dita e lidhjes së marrëveshjes këtë ta dorëzojë te Agjencia.

(7) Nëse marrëveshja nuk lidhet në afatin e përcaktuar në paragrafin (5) të këtij neni cilado qoftë nga palët ka të drejtë të kërkojë nga Agjencia ta zgjidh kontestin.

(8) Operatori nga paragrafi (1) i këtij neni detyrohet të mbajë kontabilitet të posaçëm për aktivitetet lidhur me emetimin digjital.

Neni 160

Sistemet me qasje të kushtëzuar

(1) Sistemet për qasje të kushtëzuar të shërbime televizive digjitale apo shërbimet e radios që shfrytëzohen në Republikën e Maqedonisë duhet të sigurojnë aftësi teknike që operatorëve dhe/apo dhënësve të shërbimeve komunikuese publike do t'u mundësojnë kontroll të shpenzimeve, përkatësisht kontroll të shërbimeve që sigurohen nëpërmjet këtyre sistemeve në nivel lokal apo rajonal.

(2) Operatorët që ofrojnë kushte të qasjes së kushtëzuar, me të cilat mundësohet qasje të shërbimet televizive digjitale apo shërbimet e radios detyrohen, me kushte të drejta, të arsyeshme dhe jodiskriminuese, të gjithë radiodifuzerëve t'u sigurojnë shërbime teknike që do të mundësojnë servise të programit të radiodifuzerëve që emetohen në mënyrë digjitale të pranohen nga shikuesit apo dëgjuesit, nëpërmjet shfrytëzimit të dekoderëve.

(3) Operatorët që ofrojnë shërbime të qasjes së kushtëzuar detyrohen të mbajnë kontabilitet të posaçëm për shërbimet me qasje të kushtëzuar veçmas nga aktivitetet tjera.

(4) Agjencia bashkëpunon me Inspektoratin Shtetëror të Tregut lidhur me punët që u referohen mjeteve për qasje të kushtëzuar.

Kreu i shtatëmbëdhjetë

RADIO PAJISJE DHE PAJISJE TERMINALE TELEKOMUNIKIMI

Neni 161

Lëshimi në treg dhe vënia në përdorim të radio pajisjes dhe pajisje terminale telekomunikimi

(1) Lëshimi në treg dhe vënia në përdorim të radio pajisjes dhe pajisjes terminale për telekomunikime është në pajtim me Ligjin për siguri të produkteve dhe dispozitave të miratuara në bazë të tij.

(2) Importi, prodhimitaria, shitja, huazimi dhe shfrytëzimi i radio pajisjes që shkakton pengesa në radiofrekuencat e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, nuk lejohen në përveç në raste kur atë e kërkojnë, interesat e mbrojtje ose sigurisë nacionale.

Neni 162

Publikimi i specifikimeve të interfejsave

(1) Operatorët e rrjeteve të komunikimeve publike në Republikën e Maqedonisë para se të fillojnë me sigurimin e shërbimeve të komunikimeve publike janë të obliguar në ueb faqen e tyre të publikojnë dhe azhurnojnë llojin dhe specifikimet teknike të interfejsit në rrjetet e tyre të komunikimeve publike.

(2) Specifikimet teknike nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të jenë mjaft të detajuara, për të mundësuar dizajnimin e pajisjes terminale të telekomunikimit që do t'i mundësojë të gjitha shërbimet, të siguruara nëpërmjet interfejsave adekuate. Specifikimet teknike veçanërisht duhet t'i përmbajnë të gjitha informatat të cilat do t'u mundësojnë prodhuesve me zgjedhjen e tyre të zbatojnë teste adekuate në aspekt të kërkesave esenciale, të aplikueshme për pajisje terminale për telekomunikime.

Neni 163

Paraqitje të radio pajisjes

(1) Para se të lëshojë në treg ose të fut në përdorim radio pajisje, e cila përdor diapazone radiofrekuentive, që nuk janë të harmonizuara në nivel të Bashkimit Evropian, prodhuesi ose përfaqësuesi i tij i autorizuar ose personi përgjegjës për lëshim të kësaj pajisjes në treg dhe përdorim, është i obliguar të kërkojë pajtim nga Agjencia. Kërkesa për pajtim parashtrohet në Agjencinë në afat jo më të shkurtë se 30 ditë nga data e planifikuar në lëshim të tregut ose vënie në përdorim të radio pajisjes.

(2) Kërkesa nga paragrafi (1) i këtij neni veçanërisht përmban:

- emrin dhe adresën e kërkuarit,
- titullin e radio përgatitjes, prodhuesit, dedikimi dhe parametrat e saj teknike,
- diapazonet radiofrekuentive, shpërndarja në kanale, lloji i modulimit dhe fuqia maksimale e transmetuesit dhe
- numrin e identifikimit të trupit të autorizuar për përputhshmëri.

(3) Formën dhe përmbajtjen e kërkesës nga paragrafi (2) të këtij neni, në mënyrë më të hollësishme e cakton Agjencia.

(4) Agjencia vendos për kërkesën nga paragrafi (1) i këtij neni në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të saj.

(5) Drejtori i Agjencisë mund të miratojë aktvendim me të cilin do ta refuzojë kërkesën, përkatësisht nuk do të jepet pajtimi nga paragrafi (1) i këtij neni, nëse konstatohet se lëshimi në tre ose vënie në përdorim të pajisjes radiofrekuentive nga paragrafi (1) i këtij neni është në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe dispozitat e miratuara në bazë të tij.

Neni 164

Lidhje e radio pajisjes dhe pajisjes terminale për telekomunikime

(1) Nëse radio pajisja dhe/ose pajisja terminale për telekomunikime i plotëson kushtet e caktuara në Ligjin për siguri të produkteve, dispozitat e miratuara në bazë të tij dhe të këtij ligji, operatorët e rrjeteve publike të komunikimit dhe/ose shërbimeve nuk u lejohet të refuzojnë lidhjen e pajisjes së tillë.

(2) Nëse radio pajisja dhe/ose pajisja terminale e telekomunikimeve e cila i plotëson kushtet nga paragrafi (1) i këtij neni shkakton dëmtime të rrjetit ose bën pengesa të dëmshme ose i dëmton funksionimin e rrjetit, operatori i rrjetit publik të komunikimeve mund të refuzojë pajisjen e tillë, të deaktivizojë ose të tërheq nga përdorimi dhe për atë ta informojë Agjencinë.

(3) Në raste të caktuara urgjente nëse është e domosdoshme të mbrohet rrjeti, operatori pa prolongim mund të deaktivizojë pajisjen nga paragrafi (1) i këtij neni dhe nëse shfrytëzuesi pa prolongim dhe pa shpenzime për atë mund t'i ofrojë zgjidhje tjetër adekuate, për çka menjëherë e informon Agjencinë.

(4) Shfrytëzuesve nuk u lejohet të kyçin rrjet publik telekomunikimi ose pajisje terminale për telekomunikime, që nuk është në pajtim me kushtet e përcaktuara në Ligjin për siguri të produkteve, dispozitave të miratuara në bazë të tij dhe të këtij ligji.

Neni 165

Regjistri për pajisje terminale telekomunikimi

(1) Agjencia jep mendime dhe bashkëpunon me institucionet kompetente në lidhje me çështjet për importin dhe përdorimin e radio pajisjes dhe pajisjes terminale për telekomunikime.

(2) Agjencia mban regjistër elektronik të pajisjes terminale për telekomunikimeve të dedikuar për shërbime publike komunikimit publik.

(3) Formën, përmbajtjen dhe mënyrën e mbajtjes së regjistrit nga paragrafi (2) të këtij neni, si dhe llojin e të dhënave dhe mënyrën e parashtrimit të të dhënave të nevojshme për mbajtjen e regjistrit, i përcakton Agjencia.

(4) Operatori, personat juridik ose fizik për shitje të pajisjes terminale për telekomunikime, si dhe persona juridik ose fizik të cilët kanë blerë pajisje terminale telekomunikimi të dedikuar për shërbimet mobile publike ose të njëjtën e kanë fituar si dhuratë ose donacion nga personat jashtë territorit të Republikës së Maqedonisë janë të obliguar Agjencisë t'i parashtrojnë të dhëna në pajtim me aktin nga paragrafi (3) i këtij neni.

(5) Operatorët janë të obliguar me kërkesë të Agjencisë ta përjashtojnë nga rrjeti mobil i komunikimeve pajisjen terminale të telekomunikimit që nuk është e evidentuar në regjistrin nga paragrafi (2) i këtij neni.

Kreu i tetëmbëdhjetë

SIGURIA DHE INTEGRITETI I RRJETEVE PUBLIKE TË KOMUNIKIMEVE DHE SHËRBIMEVE DHE MBROJTJE E TË DHËNAVE PERSONALE

Neni 166

Siguria dhe integriteti i rrjeteve publike të komunikimeve dhe shërbimeve elektronike

(1) Operatorët janë të obliguar të ndërmarrin masa teknike dhe organizative me qëllim të menaxhojnë me rreziqet për siguri të rrjeteve dhe shërbimeve. Duke pasur parasysh progresin teknik, këto masa duhet të sigurojnë nivel të sigurisë që është në përputhje me rrezikun e paraqitur. Këto masa veçanërisht duhet të ndërmerren për tu penguar dhe minimizuar incidentet e sigurisë mbi shfrytëzuesit dhe rrjeteve të lidhura ndërmjet veti.

(2) Operatorët e rrjeteve elektronike publike duhet t'i ndërmarrin të gjitha hapat përkatës për të siguruar integritetin e rrjeteve të tyre dhe njëkohësisht, kontinuitetin e shërbimeve të cilat i sigurojnë me ato rrjete.

(3) Për shkak të sigurimit të dispozitave nga paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni operatorët e komunikimeve elektronike publike ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike duhet të miratojnë dhe implementojnë politikë për siguri me të cilën do të caktohet ceneshmëria e sistemit, mbikëqyrja dhe zbatimi i masave parandaluese dhe korrigjuese, si dhe masa për zbutje të incidenteve për sigurinë dhe integritetin e rrjeteve.

(4) Operatorët janë të obliguar menjëherë, por jo më vonë se 24 orë nga momenti i cenimit të sigurisë ose humbjes së integritetit që ka pasur ndikim të konsiderueshëm mbi funksionimin e rrjeteve ose shërbimeve, në mënyrë elektronike Agjencisë do t'i dërgojnë njoftim. Nëse kjo është e përshtatshme, Agjencia, për këtë, mund t'i informojë trupat nacionalë rregullatorë nga shtetet tjera, si dhe Agjencinë Evropiane për siguri të rrjeteve dhe informatave (AESRRI). Nëse e njëjta është në interes të publikut, Agjencia mund ta informojë publikun të kërkojë ose të kërkojë nga operatori të bëjë atë. Po ashtu, nëse kjo është e përshtatshme dhe varet nga shkalla e cenimit të sigurisë ose integritetit të rrjeteve ose shërbimeve, Agjencia për këtë do ta informojë trupin kompetent për ballafaqim me incidentet kompjuterike në Republikën e Maqedonisë.

(5) Agjencia është e obliguar Agjencisë Evropiane për Siguri të Rrjeteve dhe Informatave (AESRRI) t'i parashtojë raport vjetor përmbledhës për njoftimet e pranuar nga ana e operatorëve, si dhe për aktivitetet ndërmarra në pajtim me paragrafin (3) të këtij neni.

(6) Në rast të rrezikut të konsiderueshëm nga cenimi i sigurisë së rrjetit, operatori i shërbimeve publike të komunikimeve elektronike është i obliguar t'i informojë parapaguesit për atë rrezik dhe nëse ai është jashtë diapazonit të masave të cilat i ndërmer operatori, t'i informojë edhe për zgjidhjet e mundshme për menjanim të rrezikut si dhe për shpenzimet e mundshme për zgjidhjet e tilla.

(7) Agjencia në pajtim me Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale do të miratojë akt nënligjor me të cilin do të përcaktojë mënyrën në të cilën operatorët janë të obliguar t'i zbatojnë dispozitat e këtij neni, nëpërmjet instruksioneve obligative, formën, përmbajtjen dhe mënyrën e parashtrimit të njoftimeve të caktuara me këtë nen dhe neni 167 të këtij ligji, si dhe formën dhe përmbajtjen e regjistrit të cenimeve të sigurisë së të dhënave personale dhe mënyrën e mbajtjes së vet nga neni 167 paragrafi (6) të këtij ligji.

(8) Agjencia nga operatorët e paragrafit (1) të këtij neni mund të kërkojë:

(a) t'i parashtrojnë informata për vlerësim të sigurisë dhe/ose integritetit të shërbimeve dhe rrjeteve të tyre, duke përfshirë edhe politikat e miratuara për siguri dhe

b) të sigurojnë revizion sigurie të cilën e kryen trup i kualifikuar dhe i pavarur ose organ kompetent shtetëror dhe rezultatet nga e njëjta t'i bëjnë të arritshme për Agjencinë. Shpenzimet për revizionin i paguan operatori.

(9) Agjencia ka të drejtë t'i shqyrtojë rastet e mos harmonizimit dhe efektet nga e njëjta mbi sigurinë dhe integritetin e rrjeteve.

Neni 167

Cenimi i sigurisë së të dhënave personale

(1) Në rast të cenimit të sigurisë së të dhënave personale, operatori i shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, është i obliguar, menjëherë, por jo më vonë se 24 orë nga momenti i konstatimit të cenimit të sigurisë së të dhënave personale, në Agjenci dhe Drejtorinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të dërgojë njoftim për cenimin e sigurisë së të dhënave personale.

(2) Nëse cenimi i sigurisë së të dhënave personale mund të ndikojë negativisht në të dhënat personale ose privatësinë e parapaguesit ose personit tjetër fizik, operatori i shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, është i obliguar, po ashtu, për atë, në afatin e caktuar në paragrafin (1) të këtij neni, ta njoftojë parapaguesit ose personin fizik në fjalë.

(3) Njoftimi nga paragrafi (2) i këtij neni duhet veçanërisht të përmbajë natyrën e cenimit të sigurisë së të dhënave personale dhe pikat për kontakt ku mund të fitohen më shumë informata, si dhe masat tjera që rekomandohen për zbutjen e ndikimeve të mundshme negative të shkaktuara nga cenimi i sigurisë së të dhënave personale, kurse njoftimi nga paragrafi (1) i këtij neni duhet të përmbajë edhe përshkrim të pasojave nga cenimi i sigurisë së të dhënave personale, si dhe masat e propozuara ose të ndërmarra nga ana e operatorit për mënjanim të cenimit të sigurisë së të dhënave personale.

(4) Operatori nuk duhet ta njoftojë parapaguesin ose personin tjetër fizik për cenimin e sigurisë së të dhënave personale nga paragrafi (2) i këtij neni, nëse pas njoftimit të pranuar nga paragrafi (1) i këtij neni Agjencia sjell mendim me të cilin do të konstatojë se operatori, për të dhënat personale me të cilat ka të bëjë cenimi, i ka implementuar masat teknike adekuate për mbrojtjen e të njëjtave, në mënyrë me të cilën i ka siguruar të dhënat personale të jenë të pakuptueshme për cilin do person i cili nuk ka të drejtë për qasje te ato. Agjencia parashtron mendimin te operatori dhe Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

(5) Drejtoria për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pavarësisht nga mendimi i pranuar nga paragrafi (4) i këtij neni, mund të kërkojë nga operatori i paragrafit (1) të këtij neni të informojë parapaguesit ose personin tjetër fizik për cenimin e sigurisë së të dhënave personale, duke marrë parasysh efektet e mundshme negative të sigurisë së të dhënave personale.

(6) Operatorët e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike janë të obliguar të mbajnë regjistër të cenimit të sigurisë së të dhënave personale që i përmban faktet dhe shkaqet për cenimin e sigurisë së të dhënave personale, pasojat e shkaktuara nga cenimi i tillë, si dhe masat e ndërmarra për sigurinë e të dhënave personale, që i mundëson Agjencisë dhe Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale të kontrollojnë harmonizimin e operatorit me dispozitat e këtij neni.

Neni 168

Besueshmëria e komunikimeve

(1) Besueshmëria e komunikimeve ka të bëjë me:

- a) përmbajtjen e komunikimeve;
- b) të dhënat për komunikacion komunikimi dhe të dhënat për lokacion të cilat nuk janë të dhëna për komunikacion komunikimi, dhe
- v) faktet dhe rrethanat për ndërprerjen e koneksionit ose për përpjekje të dështuara për themelimin e koneksionit.

(2) Janë ndaluar të gjitha format e dëgjimi, përcjellje, ruajtjes, incizimit, mbajtjes ose çdo formë tjetër e asistimit ose mbikëqyrjes së komunikimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, pa pajtim paraprakisht të pranuar nga shfrytëzuesit për të cilët bëhet fjalët, përveç në rastet e caktuara në nenet 175 dhe 176 të këtij ligji.

(3) Ndalimi nga paragrafi (2) i këtij neni nuk vlen për ruajtjen teknike të të dhënave të domosdoshme për transmetim të komunikimeve.

(4) Dispozitat nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni nuk vlejné për incizimin e komunikimeve dhe të dhënave përkatëse për komunikacion komunikimi për shkak të sigurimit të provave për transaksione komerciale ose çfarëdo lloj komunikimi tjetër afarist.

(5) Ruajtja e informatave ose pranimi i qasjes në informatat të cilat janë ruajtur në pajisjen terminale të parapaguesit ose shfrytëzuesit është e lejuar vetëm me kusht kur parapaguesi ose shfrytëzuesi të ketë dhënë pajtimin e tij pasi, paraprakisht ka pranuar informata të qarta dhe gjithëpërfshirëse dhe atë veçanërisht për qëllimet për përpunimin e atyre të dhënave, në pajtim me dispozitat për mbrojtjen e të dhënave personale. Me këtë nuk duhet të pengohet ruajtja teknike ose qasja në informatat për shkak të mundësimit të transmetimit të komunikimeve nëpërmjet rrjetit publik të komunikimeve elektronike ose nëse është e domosdoshme për shkak të sigurimit të shërbimit të shoqërisë informatike që është kërkuar në mënyrë eksplicite nga parapaguesi ose shfrytëzuesi i shërbimit.

Neni 169

Të dhënat për komunikacion komunikimi

(1) Të dhënat për komunikacion komunikimi që kanë të bëjnë me parapaguesit dhe shfrytëzuesit e shërbimeve që janë të përpunuara dhe të ruajtura nga operatori duhet të fshihen ose të bëhen anonime atëherë kur nuk do të jenë të nevojshme për transmetim të komunikimit, përveç në rastet nga paragrafët 2, 3 dhe 5 të këtij neni dhe nga nenet 175 dhe 176 të këtij ligji.

(2) Lejohet të përpunohen vetëm të dhënat për komunikacion komunikimi të cilat janë të nevojshme për llogaritje të shpenzimeve të parapaguesit për shfrytëzim të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike dhe për shpenzimet për interkoneksion të rrjeteve, por vetëm deri në kalimin e afateve ligjore në të cilat mund të kontestohet llogaria ose të bëhet pagimi.

(3) Për shkak të marketingut të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike ose për shkak të sigurimit të shërbimeve me vlerë të shtuar, operatori mund t'i përpunojë të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni, deri në shkallën dhe kohëzgjatjen të nevojshme për ato shërbime ose marketing, nëse parapaguesi ose shfrytëzuesi për të cilin kanë vlerë të dhënave ka dhënë pajtim paraprak për atë. Shfrytëzuesit ose parapaguesit duhet të kenë mundësi në çdo kohë të tërheqin pajtimin për përpunimin e të dhënave për komunikacion komunikimi.

(4) Operatori i shërbimeve publike të komunikimeve elektronike është i obliguar të informojë parapaguesin ose shfrytëzuesin e shërbimeve për atë cilat lloje të të dhënave për komunikacion komunikimi përpunohen dhe cila është kohëzgjatja e përpunimit të të dhënave për qëllimet e përmendura në paragrafin (2) të këtij neni dhe, para se të fitojë pajtim, për qëllimet e përmendura në paragrafin (3) të këtij neni.

(5) Qasja në përpunimin e të dhënave për komunikacion komunikimi, në pajtim me paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni u lejohet vetëm personave të autorizuar të operatorit të cilët punojnë në llogaritjen e shpenzimeve të parapaguesve dhe shpenzimeve për interkoneksion, menaxhim me komunikacion komunikimi, kërkesa të konsumatorëve, zbulim të mashtimeve, marketing të shërbimeve publike të komunikimeve elektronike ose sigurim të shërbimeve me vlerë të shtuar dhe duhet të kufizohet në atë që është e domosdoshme për atë punë.

(6) Operatorët janë të obliguar t'i sigurojnë të dhënat për komunikacionin e komunikimeve, për shkak të zgjidhjes së kontesteve në lidhje me llogaritjen e shpenzimeve të parapaguesve dhe shpenzimeve për interkoneksion.

(7) Operatorët janë të obliguar të dhënat për komunikacion komunikimi nga paragrafët (2) dhe (3) të këtij neni t'i ruajnë në Republikën e Maqedonisë.

Neni 170

Paraqitja dhe kufizimi i identifikimit të linjës që thërret dhe linjës që thirret

(1) Operatori i shërbimeve të komunikimeve publike elektronike që siguron mundësi për paraqitje të identifikimit të linjës që thërret, është i obliguar t'i mundësojë shfrytëzuesit të fundit i cili ka bërë thirrjen, thjeshtë dhe falas të parandalojë identifikimin e linjës thirrëse për çdo thirrje individuale.

(2) Operatori nga paragrafi (1) i këtij neni është i obliguar t'i mundësojë parapaguesit të thirrur thjeshtë dhe falas të parandalojë paraqitjen e identifikimit të linjës së thirrjes në thirrjet që vijnë, me shfrytëzim racional të kësaj mundësie.

(3) Operatori nga paragrafi (1) i këtij neni i cili i siguron mundësi linjës thirrëse të paraqitet para themelimit të lidhjes është i obliguar, t'i mundësojë parapaguesit të thirrur në mënyrë të thjeshtë të mund t'i refuzojë thirrjet që vijnë, në rast kur parapaguesi ose shfrytëzuesi i cili ka bërë thirrjen ka parandaluar paraqitjen e linjës së tij thirrëse.

(4) Operatori i shërbimeve të komunikimeve publike elektronike që siguron mundësi për paraqitje të identifikimit të linjës që thirret, është i obliguar t'i mundësojë shfrytëzuesit të fundit i cili ka bërë thirrjen, thjeshtë dhe falas të parandalojë identifikimin e linjës së thirrur.

(5) Dispozitat e këtij neni kanë të bëjnë edhe me thirrjet hyrëse dhe dalëse ndaj shteteve tjera.

(6) Operatorët e shërbimeve publike të komunikimeve elektronike të cilët e sigurojnë mundësinë për paraqitje të identifikimit të linjës thirrëse dhe/ose linjës së thirrur, janë të obliguar të informojnë publikun në mënyrë adekuate dhe në mënyrë publikisht të arritshme për këto shërbime dhe për mundësitë nga paragrafët (1), (2), (3) dhe (4) të këtij neni.

Neni 171

Të dhënat për lokacion

(1) Të dhënat për lokacionin të cilat nuk janë të dhëna për komunikacion komunikimi të cilat kanë të bëjnë me parapaguesit ose shfrytëzuesit e rrjeteve publike të komunikimeve elektronike ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike mund të përpunohen vetëm në rast kur janë bërë anonime ose shfrytëzuesi i shërbimeve, në atë masë dhe në kohëzgjatje të nevojshme për sigurim të shërbimeve me vlerë të shtuar.

(2) Operatori, para se të fitojë pajtimin paraprak nga paragrafi (1) i këtij neni, është i obliguar të njoftojë parapaguesin ose shfrytëzuesin e shërbimeve për llojin e të dhënave për lokacion të cilat do të përpunohen, për qëllimet dhe kohëzgjatjen e përpunimit, si dhe për rastet kur ato të dhëna do tu dërgohen palëve të treta për sigurim të shërbimeve me vlerë të shtuar. Parapaguesit ose shfrytëzuesit e shërbimeve, në çdo kohë, duhet t'i jepet mundësi të tërheq pajtimin e tij që e ka dhënë për përpunimin e të dhënave për lokacion.

(3) Kur nga parapaguesi ose shfrytëzuesi i shërbimeve është fituar pajtimi paraprak nga paragrafi (1) i këtij neni, të njëjtit duhet t'i sigurohet vazhdimisht të ketë mundësi në mënyrë të thjeshtë dhe falas, përkohësisht të refuzojë përpunimin e të dhënave për lokacion, për çdo kyçje në rrjetin publik të komunikimeve elektronike ose për çdo transmetim të komunikimeve.

(4) Qasja në përpunimin e të dhënave për lokacion, në pajtim me dispozitat nga paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij neni është e lejuar vetëm për persona të autorizuar nga operatori i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, ose të personave të autorizuar nga palët e treta të cilët e sigurojnë shërbimin me vlerë të shtuar dhe duhet të kufizohet në atë që është e domosdoshme për sigurim të shërbimit me vlerë të shtuar.

Neni 172

Përrjashtimet

(1) Në rast kur parapaguesi në formë të shkruar do ta informojë operatorin se merr thirrje shqetësuese ose me qëllime negative, operatori është i obliguar në kohë, por jo më gjatë se tre muaj nga dita e pranimit të njoftimit, të mënjanojë mundësinë për parandalimin e paraqitjes së identifikimit të linjës thirrëse në pajtim me këtë ligj.

(2) Operatori është i obliguar, në kohë t'i ruajë, por jo më gjatë se tre muaj nga dita e pranimit të njoftimit nga paragrafi (1) i këtij neni, të gjitha thirrjet hyrëse dhe dalëse të parapaguesit nga paragrafi (1) i këtij neni, duke përfshirë edhe për ato thirrje për të cilat shfrytëzuesit i është siguruar mundësi të parandalojë paraqitjen e identifikimit të linjës për thirrje, kurse me kërkesë të organit kompetent ato t'i vë në dispozicion, në pajtim me ligjin.

(3) Kur bëhet fjalë për thirrje drejt shërbimeve për shërbime urgjente në pajtim me Planin për numërtim të rrjeteve dhe shërbimeve të komunikimeve publike, operatori i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike dhe/ose është i obliguar të mënjanojë mundësinë për parandalimin e identifikimit të linjës thirrëse në pajtim me këtë ligj ka të drejtë t'i përpunojë të dhënat për lokacion dhe në rast kur parapaguesi ose shfrytëzuesi përkohësisht ka refuzuar përpunimin e të dhënave për lokacion ose nuk ka dhënë pajtim për përpunim të të dhënave për lokacion, në pajtim me nenin 171 të këtij ligji.

Neni 173

Ridestnimi automatik i thirrjeve

Operatori është i obliguar secilit parapagues t'i sigurojë mundësi, falas dhe duke shfrytëzuar mjete të zakonshme, ta ndërpresë ridestinin automatik të thirrjes nga pala e tretë deri në pajisjen e tij terminale.

Neni 174

Komunikimet e pakërkuara

(1) Shfrytëzimi i thirrjes automatike dhe të sistemeve të komunikimeve për thirrje të numrave telefonikë të parapaguar pa intervenim njerëzor (makina automatike për thirrje, SMS, MMS), faks aparate ose postë elektronike, për shkak të kryerjes së marketingut të drejtpërdrejtë, mund të lejohet vetëm nëse parapaguesit paraprakisht janë pajtuar për këtë.

(2) Personat fizikë dhe juridikë mund t'i shfrytëzojnë të dhënat e kontakteve elektronike për postë elektronike të pranuar nga konsumatorët e produkteve ose shërbimeve të tyre, për marketing dhe shitje të drejtpërdrejtë vetëm të produkteve dhe shërbimeve të tyre të ngjashme, me kusht që atyre konsumatorëve tu sigurojnë mundësi të qartë dhe pa ekuivoqe, falas dhe në mënyrë të thjeshtë të kundërshtojnë për atë mënyrë të përdorimit të të dhënave të kontaktit elektronik gjatë pranimit të tyre dhe gjatë pranimit të secilës porosi, në rast kur konsumatori paraprakisht nuk ka refuzuar atë shfrytëzim të të dhënave të kontaktit elektronik.

(3) Komunikime që nuk kërkohen për qëllimet e marketingut të drejtpërdrejtë ndryshe nga ato të përmendura në paragrafët (1) dhe (2) të këtij neni (për shembull thirrje telefonike), lejohen vetëm kur parapaguesit ose shfrytëzuesit kanë dhënë pajtim për atë, në mënyrë falas.

(4) Ndalohet dërgimi i postës elektronike për marketing të drejtpërdrejtë ose për stimulim të vizitës në ueb faqe të caktuara, me mbulim ose fshehje të identitetit të dërguesit në emër të të cilit është bërë komunikimi, pa adresë valide në të cilën pranuesi i komunikimit mund të dërgojë kërkesë për ndërprerjen e atij komunikimi.

(5) Paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni aplikohen vetëm për parapaguesit të cilët janë persona fizikë.

Neni 175

Përcjellja e komunikimeve

(1) Operatorët janë të obliguar t'i sigurojnë të gjitha kushtet e domosdoshme teknike për të mundësuar përcjellje të komunikimeve në rrjetet e tyre, në pajtim me Ligjin për përcjelljen e komunikimeve.

(2) Operatorët janë të obliguar me shpenzim të tyre të sigurojnë dhe të mirëmbajnë pajisje, interfejs adekuat dhe të vendosin përçues elektronik të komunikimeve për transmetim te organi i autorizuar për përcjelljen e komunikimeve, me qëllim që të mundësohet përcjellja e komunikimeve në rrjetin e tyre, në pajtim me Ligjin për përcjelljen e komunikimeve.

(3) Gjatë blerjes së pajisjes dhe interfejsit nga paragrafi (2) i këtij neni, operatorët janë të obliguar te organi i autorizuar për përcjelljen e komunikimeve të kërkojnë specifikim teknik për llojin dhe karakteristikat e tyre.

(4) Organi i autorizuar për përcjellje të komunikimeve nga paragrafi (2) i këtij neni i cakton masat dhe standardet për siguri informative, të cilat duhet t'i aplikojë operatori i rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike në lidhje me obligimet e tij për përcjelljen e komunikimeve nga paragrafi (2) i këtij neni.

(5) Në rast kur operatorët kanë instaluar kompresion ose kriptombrojtje të komunikacionit të komunikimeve, janë të obliguar të mënjanojnë atë, para se të parashtrojnë përmbajtjen e shërbimit të përcjellë të komunikimit te organi i autorizuar për përcjellje të komunikimeve.

(6) Operatorët kanë për obligim t'i mundësojnë organit të autorizuar për përcjellje të komunikimeve, përcjellje të komunikimeve në kohë reale. Informata për komunikimin e përcjellë duhet të jetë në dispozicion menjëherë pas përfundimit të komunikimit, kurse përcjellja e komunikimit duhet të jetë e pandërprerë në kohëzgjatjen e vet.

(7) Operatorët kanë për obligim të sigurojnë lidhje të saktë dhe të njëqëllim të informatës për komunikimin e përcjellë me përmbajtjen e komunikimit që përcillet.

(8) Operatorët duhet të sigurojnë që personi komunikimet e të cilit përcillen ose personi tjetër i paautorizuar të mos vërejë çfarëdo lloj ndryshimi në cilësinë e shërbimit të komunikimeve që mund të shkaktohet me aplikimin e masës përcjellje e komunikimeve. Funksionimi i shërbimit të përcjellur të komunikimeve duhet të mbetet i pandryshuar për personin komunikimet e të cilit përcillen.

(9) Operatorët duhet të garantojnë siguri dhe cilësi të njëjtë ose më të madhe të shërbimit të komunikimit të përcjellë nga siguria dhe cilësia e shërbimeve të komunikimeve të cilat i janë mundësuar personit komunikimet e të cilit përcillen.

(10) Agjencia do të zbatojë procedurë të mbikëqyrjes mbi operatorin, në lidhje me përmbushjen e obligimeve të caktuara me këtë nen, me kërkesë të organit të autorizuar për përcjellje të komunikimeve.

Neni 176

Obligimi për mbajtje të të dhënave

(1) Operatorët janë të obliguar t'i mbajnë të dhënat për komunikimet elektronike nga neni 178 të këtij ligj, që janë krijuar ose përpunuar prej tyre gjatë sigurimit të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike me qëllim që të mundësohet arritje e këtyre të dhënave për shkak të parandalimit ose zbulimit të veprave penale, për shkak të mbajtjes së procedurës penale ose kur atë e kërkojnë interesat e sigurisë dhe mbrojtjes së Republikës së Maqedonisë.

(2) Operatorët kanë për obligim t'i mbajnë ato të dhëna nga paragrafi (1) i këtij neni të cilat ata vet nuk i kanë krijuar ose përpunuar.

(3) Operatorët janë të obliguar të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni dhe të gjitha informatat tjera të domosdoshme që kanë të bëjnë me ato të dhëna, me kërkesë t'ua parashtrojnë organeve kompetente, me kushte dhe procedurë të caktuara me ligj.

(4) Operatorët e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike janë të obliguar t'i sigurojnë të gjitha mjetet e domosdoshme teknike dhe masat organizative të të dhënave për komunikimet elektronike nga neni 178 të këtij ligji, në shpenzimin e tyre.

(5) Të gjitha mjetet e domosdoshme teknike nga paragrafi (4) i këtij neni nuk guxojnë të themelohen jashtë Republikës së Maqedonisë.

Neni 177

Mbrojtja dhe siguria e të dhënave

Operatorët janë të obliguar, veçanërisht t'i respektojnë parimet në vijim për siguri të të dhënave nga neni 178 i këtij ligji, dhe atë:

1) të dhënat janë me cilësi të njëjtë dhe janë lëndë e sigurisë dhe mbrojtjes së njëjtë si edhe të dhënat në rrjetin elektronik të komunikimeve;

2) për të dhënat aplikohen masa adekuate teknike dhe organizative për mbrojtje nga shkatërrimi i rastësishëm ose joligjor, humbje ose ndryshim i rastësishëm, ose ruajtje, përpunim, qasje ose zbulim i paautorizuar ose joligjor;

3) për të dhënat aplikohen masa adekuate teknike dhe organizative për tu siguruar se në ato mund të kenë qasje vetëm persona të autorizuar të operatorit, dhe

4) të dhënat me përjashtim të atyre të cilat ka ekzistuar qasje dhe kanë qenë të ruajtura shkatërrohen pas kalimit të periudhës për mbajtjen e tyre të caktuar në nenin 176 paragrafin (3) të këtij ligji.

Neni 178

Lloje të të dhënave që mbahen

(1) Operatorët janë të obliguar t'i mbajnë llojet e të dhënave në vijim:

A) të dhënat që janë të nevojshme për përcjellje dhe identifikim të burimit të komunikimit:

1) gjatë sigurimit të shërbimeve telefonike nëpërmjet rrjetit publik fiks ose mobil të komunikimeve elektronike:

- numri telefonik i thirrjes;

- emri dhe adresa e parapaguesit ose shfrytëzuesit të regjistruar;

2) gjatë sigurimit të qasjes në internet, postë elektronike dhe shërbimet telefonike nëpërmjet internetit:

- kodi i dhënë i shfrytëzuesit për identifikim;

- kodi shfrytëzues për identifikim dhe numri telefonik i ndarë për çfarëdo lloj komunikimi gjatë qasjes në rrjetin publik telefonik;

- emri dhe adresa e parapaguesit ose shfrytëzuesit të regjistruar të cilit i është dhënë adresë për internet protokoll (IP), kod shfrytëzues për identifikim ose numër telefonik gjatë kohës së komunikimit;

B) të dhënat që janë të nevojshme për identifikim të destinimit të komunikimit:

1) gjatë sigurimit të shërbimeve telefonike nëpërmjet rrjetit publik fiks ose mobil të komunikimeve elektronike:

- numrat e thirrur telefonikë edhe, kur bëhet fjalë për shërbime shtesë siç janë përcjellja e thirrjes ose ridestinimit të thirrjes, numri ose numrat ku ridestinohet thirrja;

- emri dhe adresa e parapaguesit ose shfrytëzuesit të regjistruar;

2) gjatë sigurimit të postës elektronike dhe shërbimeve telefonike nëpërmjet internetit:

3) kodi shfrytëzues për identifikim ose numri telefonik i pranuesit të thirrjes telefonike nëpërmjet internetit;

- emri dhe adresa e parapaguesit ose shfrytëzuesit të regjistruar dhe kodi i shfrytëzuesit për identifikim të pranuesit të thirrjes telefonike nëpërmjet internetit;

B) të dhëna që janë të nevojshme për identifikim të datës, orës dhe kohëzgjatjes së komunikimit:

1) gjatë sigurimit të shërbimeve telefonike nëpërmjet rrjetit publik fiks ose mobil të komunikimeve elektronike, data dhe ora e fillimit dhe fundit të komunikimit;

2) gjatë sigurimit të qasjes në internet, postë elektronike dhe shërbimeve telefonike nëpërmjet internetit:

- data dhe koha e regjistrimit dhe çregjistrimit të një zone të caktuar kohore, bashkë me IP-adresën, pa marrë parasysh nëse është dinamike ose statike, që është ndarë nga operator i rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike që e siguron qasjen në internet dhe kodin shfrytëzues për identifikim të parapaguesit ose të shfrytëzuesit të regjistruar;

- data dhe ora e regjistrimit dhe çregjistrimit nga shërbimi për postë elektronike ose nga shërbimet telefonike nëpërmjet internetit, në bazë të zonës së caktuar kohore;

G) të dhënat që janë të nevojshme për indentifikim të llojit të komunikimit:

1) gjatë sigurimit të shërbimeve telefonike nëpërmjet rrjetit publik fiks ose mobil të komunikimeve elektronike, shërbimit telefonik që është shfrytëzuar;

2) gjatë sigurimit të postës elektronike dhe shërbimeve telefonike nëpërmjet internetit: internet shërbimi që është shfrytëzuar;

D) të dhëna që janë të nevojshme për identifikim të pajisjes së komunikimit të shfrytëzuesit ose të asaj për të cilën konsiderohet se është e tij;

1) gjatë sigurimit të shërbimeve telefonike nëpërmjet rrjetit publik fiks ose mobil të komunikimeve elektronike, numrave telefonikë thirrës dhe të thirrur;

2) gjatë sigurimit të shërbimeve telefonike nëpërmjet rrjetit publik fiks ose mobil të komunikimeve elektronike:

- numrat telefonikë thirrës dhe të thirrur;

- identiteti ndërkombëtar i parapaguesit mobil (IMSI) i palës thirrëse;

- identiteti ndërkombëtar i parapaguesit mobil (IMEI) i palës thirrëse;

- IMSI i palës së thirrur;

- IMEI i palës së thirrur;

- në rast të pripejd-shërbimit, data dhe ora e aktivizimit fillues të shërbimit dhe shenja e lokacionit (kod në seli) prej nga është aktivizuar shërbimi;

3) gjatë sigurimit të qasjes në internet, postë elektronike dhe shërbimet telefonike nëpërmjet internetit:

- numri telefonik thirrës për dial-up qasje;

- linjë digjitale parapaguese (DSL) ose pikë tjetër përfundimtare e iniciatorit të komunikimit.

GJ) të dhëna që janë të nevojshme për tu identifikuar lokacioni i pajisjes mobile të komunikimit:

1) shenja për lokacionin (kod i selisë) e fillimit të komunikimit;

2) të dhënat për identifikim të lokacionit gjeograf të selive me udhëzim të shenjave të tyre për lokacion (kod i selisë) për periudhën kohore për të cilën mbahen të dhënat për komunikimin.

(2) Shërbim telefonik nga paragrafi (1) i këtij neni konsiderohen thirrjet (duke përfshirë bisedë, sekretare postare (MEJLI) dhe thirrje konferenciale dhe të të dhënave), shërbime shtesë (duke përfshirë përcjelljen e thirrjes dhe ridestinimin e thirrjes) dhe dërgimin e porosive dhe shërbimeve multimediale (duke përfshirë shërbimin e porosive të shkurta, shërbime të miratuara mediale dhe shërbime multimediale).

(3) Të dhënat nga paragrafi (1) i këtij neni i përfshijnë të dhënat të cilat kanë të bëjnë me përpjekjet e pasuksesshme për thirrje. Operatori nuk ka për obligim t'i mbajë të dhënat për thirrje të cilat janë themeluar.

(4) Operatorëve nuk u lejohet t'i mbajnë të dhënat që e zbulojnë përmbajtjen e komunikimit.

(5) Operatorët janë të obliguar t'i mbajnë të dhënat nga paragrafët (1) dhe (3) të këtij neni për periudhën prej 12 muajsh nga data e komunikimit të kryer.

Kreu i nëntëmbëdhjetë

DISPOZITA NDËSHKIMORE DHE KUNDËRVAJTËSE

Neni 179

Shfrytëzimi i radiofrekuencave pa leje për shfrytëzim të radiofrekuencave

(1) Personi juridik i cili shfrytëzon radiofrekuenca pa leje për përdorim të radiofrekuencave për kryerje të veprimtarisë radiodifuzive dhe me atë për vete fiton dobi pronësore do të ndëshkohet për veprë penale prej 100.000 deri 30 milionë denarë.

(2) Personi përgjegjës te personi juridik ose personi fizik për veprën nga paragrafi (1) i këtij neni do të dënohet me dënim me burg prej një deri në pesë vite.

(3) Krahas dënimit me burg nga paragrafi (2) i këtij neni personit përgjegjës ose personit fizik për veprën e njëjtë i shqiptohet dhe ndalim i përkohshëm për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose obligimit të veçantë në kohëzgjatje prej një deri në tre vite.

Kundërvajtje

Neni 180

(1) Gjobë në shumë prej 7% deri 10% të të hyrave të përgjithshme vjetore të personit juridik (shprehur në shumë absolute) të realizuara në vitin afarist që i paraprin vitit kur është kryer kundërvajtja ose nga të hyrat e përgjithshme të realizuara për periudhë më të shkurtër nga viti që i paraprin kundërvajtjes nëse në atë vit personi juridik ka filluar të punojë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

1) nuk parashtron notifikim në Agjenci, para se të fillojë me sigurimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike (neni 60 paragrafi (1));

2) nuk i përgjigjet kërkesës për qasje ose interkoneksion, ose nuk e lidh marrëveshjen për interkoneksion ose qasje në afatet e caktuara në nenin 73 paragrafi (4) të këtij ligji;

3) nuk plotëson kërkesën për interkoneksion ose qasje në cilëndo pikë në rrjetin e vet, ku është teknikisht e mundur, duke përfshirë qasje në pika që nuk paraqesin pika përfundimtare të rrjetit (neni 73 paragrafi (5));

4) Agjencisë nuk ia parashtron marrëveshjet e lidhura për interkoneksion ose qasje, në pajtim me nenin 73 paragrafin (7) të këtij ligji;

5) fiton pronësi të rrjeteve të komunikimeve, në kundërshtim me ndalimin e caktuar në nenin 83 të këtij ligji;

6) nuk publikon informata në pajtim me nenin 84 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji;

7) Agjencisë nuk i parashtron propozim të ofertës referente për interkoneksion ose qasje, në pajtim me nenin 84 paragrafin (3) të këtij ligji;

8) nuk publikon ofertën referente në ueb faqen e vet në afat prej pesë ditëve nga dita e miratimit nga Agjencia (neni 84 paragrafi (5));

9) çmimet në ofertën referente nuk i aplikon ditën e parë nga muaji i ardhshëm që vijon pas muajit në të cilin është fituar leja nga Agjencia (neni 84 paragrafi (6));

10) shmanget nga kushtet në ofertën referente të miratuar gjatë lidhjes të marrëveshjes për interkoneksion ose qasje (neni 84 paragrafi (8));

11) nuk vepron sipas aktvendimit të Agjencisë në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të saj (neni 84 paragrafi (9));

12) nuk aplikon kushte ekuivalente në rrethana ekuivalente për operatorët tjerë të cilët japin shërbime të njëjta, ose nuk u siguron shërbime dhe informata operatorëve tjerë me kushte të njëjta ose me cilësi të njëjtë si ato të cilat i siguron për shërbimet e veta ose ato për bashkëthemeluesit ose partnerët e tij (neni 85 paragrafi (2));

13) nuk mban kontabilitet të veçantë për aktivitetet e lidhura me interkoneksion ose qasje (neni 86 paragrafi (1));

14) me kërkesë të Agjencisë nuk i parashtron të dhëna kontabiliteti, duke përfshirë edhe të dhëna për të hyrat e pranuar nga palët e treta (neni 86 paragrafi (3));

15) nuk i plotëson obligimet për qasje ose shfrytëzim të përbashkët të mjeteve specifike të rrjetit në pajtim me nenin 87 paragrafët (3) dhe (4) të këtij ligji;

16) nuk e plotëson obligimin për çmime të bazuara në shpenzime ose obligimin për mbajtje të kontabilitetit të shpenzimeve në pajtim me nenin 88 të këtij ligji;

17) nuk e plotëson obligimin t'i ndajë aktivitetet e lidhura me sigurimin e shërbimeve të caktuara të shitjes me shumicë për qasje në subjekt të veçantë të pavarur afarist në pajtim me nenin 89 paragrafin (1) të këtij ligji;

18) nuk u siguron produkte dhe shërbime për qasje të gjithë operatorëve në pajtim me nenin 89 paragrafin (2) të këtij ligji;

19) paraprakisht dhe në kohë nuk e njofton Agjencinë për qëllimin për transferim të pronës në rrjetin e tij për qasje lokale ose pjesë të konsiderueshme nga prona e veçanërisht personit juridik, me pronësi të ndryshme, ose për qëllimin të themelojë subjekt të veçantë afarist, në pajtim me nenin 90 paragrafi (1) të këtij ligji;

20) nuk i plotëson obligimet për rregullim të çmimeve me pakicë, në pajtim me nenin 91 paragrafin (2) të këtij ligji;

21) nuk implementon sistem adekuat kontabiliteti të shpenzimeve, në pajtim me nenin 91 paragrafi (4) të këtij ligji;

22) shfrytëzon radiofrekuenca pa leje për shfrytëzim të radiofrekuencave (neni 129 paragrafi (1));

23) të drejtën për shfrytëzim të radiofrekuencave e transferon ose i jep personit tjetër fizik ose juridik, pa pajtim paraprakisht të pranuar nga Agjencia (neni 145 paragrafi (1));

24) shfrytëzon numra dhe/ose seri të numrave pa aktvendim të pranuar nga Agjencia (neni 150 paragrafi (1));

25) shfrytëzimi i numrave dhe/ose serive të numrave nuk është në pajtim me kushtet për shfrytëzim të numrave dhe/ose serive të numrave (neni 153), dhe

26) lëshon në treg ose fut në përdorim radio pajisje e cila përdor diapazone radiofrekuentive që nuk janë të harmonizuara në nivel të Bashkimit Evropian pa pajtim të Agjencisë (neni 163 paragrafi (1)).

(2) Gjobë në shumë prej 3.000 deri 6.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik dhe tregtarit individ për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 181

(1) Gjobë në shumë prej 4% deri 7% të të hyrave të përgjithshme vjetore të personit juridik (shprehur në shumë absolute) të realizuar në vitin aktual që i paraprin vitit kur është kryer kundërvajtja ose nga të hyrat e përgjithshme të realizuara për periudhë më të shkurtë nga viti që i paraprin kundërvajtjes nëse në atë vit personi juridik ka filluar të punojë, do t'i kumtohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

1) rrjetet publike të komunikimeve elektronike dhe mjeteve shoqëruese nuk ndërtohen në mënyrë të caktuar në nenin 62 paragrafi (4) të këtij ligji;

2) rrjetet publike të komunikimeve elektronike dhe mjeteve shoqëruese nuk planifikohen, projektohen, ndërtohen ose vendosen në mënyrë të caktuar në nenin 64 të këtij ligji;

3) nuk themelon person të veçantë juridik për sigurim të rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, ose nuk mban kontabilitet të veçantë për aktivitetet e lidhura me sigurimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimeve elektronike, në pajtim me nenin 72 të këtij ligji;

4) nuk e mbron besueshmërinë e të gjitha të dhënave të këmbjera gjatë nënshkrimit të marrëveshjes për interkoneksion ose qasje, në pajtim me nenin 73 paragrafin (3) të këtij ligji;

5) nuk siguron qasje në lokacion fiks ose nuk siguron shërbime telefonike, në pajtim me nenin 93 të këtij ligji;

6) nuk siguron informata në listën e plotë telefonike (neni 94 paragrafi (2));

7) të dhënat për parapaguesit e vet nuk ua parashtron dhënësve të shërbimit universal (neni 94 paragrafi (6));

8) nuk i përfshin të dhënat për parapaguesit në listën e plotë telefonike ose në evidencën e shërbimit telefonik për informatat, ose nuk e informon Agjencinë, nëse disa prej operatorëve nuk i parashtrajnë të dhënat e kërkuara (neni 94 paragrafi (7));

9) nuk siguron nga foltoret publike telefonike, pa kompensim, të zgjidhen numrat e shërbimeve për thirrje urgjente (neni 95 paragrafi (2));

10) nuk ndërmerr masa të veçanta për personat me invaliditet në pajtim me nenin 96 të këtij ligji;

11) Agjencisë nuk i parashtron të dhëna për punën e vet (neni 97 paragrafi (13));

12) në formë të shkruar nuk e njofton Agjencinë për qëllimin të transferojë rrjetin e vet lokal të arritshëm, në tërësi ose pjesë më të madhe nga ajo, te personi tjetër juridik i cili ka strukturë tjetër pronësore, në afatin e caktuar në nenin 98 paragrafi (1) të këtij ligji;

13) nuk e plotëson obligimin për kufizim të çmimeve me pakicë ose për formim të çmimit të njëjtë për shërbimin e siguruar në bazë të mesatares gjeografike (neni 99 paragrafi (4));

14) nuk ofron çmime ose pako të veçanta, që dallojnë nga ato që sigurohen në bazë të kushteve normale komerciale (neni 99 paragrafi (5));

15) pronari i lejes nuk e adapton punën e vet në afatin e caktuar në aktvendimin e Agjencisë (neni 146 paragrafi (2));

16) të drejtën për shfrytëzim të radiofrekuencave e transferon ose i jep personit tjetër fizik ose juridik, pa pajtim paraprakisht të pranuar nga Agjencia (neni 155 paragrafi (1));

17) nuk i aplikon principet e objektivitetit, transparencës, proporcionalitetit ose mosdiskriminimit në mënyrë të barabartë ndaj gjithë radiodifuzerëve (neni 159 paragrafi (1));

18) kushtet dhe çmimet për emetim digjital nuk i publikon në ueb faqen e vet ose nuk i dërgon në Agjenci (neni 159 paragrafi (3));

19) në Agjenci nuk dërgon njoftim me shkrim me arsyetim të hollësishëm për ndryshimet e planifikuara ose njoftimin me shkrim ta dërgojë në afat më të shkurtë se 60 ditë nga dita e ndryshimit të planifikuar (neni 159 paragrafi (4));

20) nuk nënshkruan marrëveshje me radiodifuzerin për emetim digjital në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të njoftimit nga trupi rregullator kompetent për punët nga fusha e radiodifuzionit (neni 159 paragrafi (5));

21) lidh marrëveshje për periudhë kohore më të shkurtë nga periudha kohore për të cilën radiodifuzeri ka marrë lejen ose në afat prej shtatë ditëve nga dita e lidhjes së marrëveshjes, të njëjtën nuk e dërgon në Agjencinë (neni 159 paragrafi (6));

22) nuk mban kontabilitet të veçantë për aktivitetet e lidhura me interkoneksion ose qasje (neni 159 paragrafi (8));

23) nuk ndërmerr masa adekuate teknike dhe organizative me qëllim në mënyrë adekuate të menaxhojë me rreziqet për sigurinë e rrjeteve dhe shërbimeve (neni 166 paragrafët (1) dhe (2));

24) nuk miraton ose implementon politikë për siguri (neni 166 paragrafi (3));

25) Agjencisë nuk i dërgon njoftim për cenimin e sigurisë ose humbjen e integritetit që ka pasur ndikim të konsiderueshëm mbi funksionimin e rrjeteve ose shërbimeve në pajtim me nenin 166 paragrafin (4);

26) nuk i informon parapaguesit për rrezik të konsiderueshëm nga cenimi i sigurisë së rrjetit, në pajtim me nenin 166 paragrafin (6) të këtij ligji;

27) nuk vepron sipas kërkesës së Agjencisë në pajtim me nenin 166 paragrafin (8) të këtij ligji;

28) Agjencisë dhe Drejtorisë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale nuk u dërgon njoftim për cenim të sigurisë së të dhënave personale, në pajtim me nenin 167 paragrafin (1) të këtij ligji;

29) nuk e informon parapaguesi ose individi në pajtim me nenin 167 paragrafin (2) të këtij ligji;

30) njoftimi nuk është në pajtim me nenin 167 paragrafin (3) të këtij ligji;

31) nuk mban regjistër të prishjeve të sigurisë së të dhënave personale në pajtim me nenin 167 paragrafin (6) të këtij ligji;

32) bën dëgjim, përcjellje, ruajtje, incizim, mbajtje ose çdo lloj forme të dhënies së ndihmës ose mbikëqyrjes mbi komunikimet pa pajtim të pranuar nga shfrytëzuesit për të cilat janë në pajtim me nenin 168 paragrafin (2) të këtij ligji;

33) ruan informata ose jep qasje në informatat të cilat veç më janë ruajtur në pajisjen terminale të parapaguesit ose shfrytëzuesit, në kundërshtim me nenin 168 paragrafin (5) të këtij ligji;

34) nuk i shlyen ose nuk i bën anonime të dhënat për komunikacion të komunikimeve në pajtim me nenin 169 paragrafin (1) të këtij ligji;

35) përpunon të dhëna për komunikacion komunikimi në kundërshtim me nenin 169 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji;

36) lejon qasje në përpunimin e të dhënave për komunikacion komunikimi të personave të paautorizuar (neni 169 paragrafi (5));

37) nuk siguron të dhënat për komunikacion komunikimi për shkak të zgjidhjes së kontesteve (neni 169 paragrafi (6));

38) të dhënat për komunikacion komunikimi nuk i ruan në Republikën e Maqedonisë (neni 169 paragrafi (7));

39) i përpunon të dhënat për lokacion në kundërshtim me nenin 171 paragrafët (1), (2) dhe (3) të këtij ligji;

40) lejon qasje në të dhënat për lokacion të personave të paautorizuar (neni 171 paragrafi (4));

41) nuk i siguron të gjitha kushtet e domosdoshme teknike për të mundësuar përcjellje të komunikimeve në rrjetin e tij (neni 175 paragrafi (1));

42) Në shpenzim personal nuk siguron ose mirëmban, interfejs personal ose nuk vendos përçues elektronik të komunikimit për transmetim nga organi i autorizuar për përcjellje të komunikimeve (neni 175 paragrafi (2));

43) nuk kërkon nga organi i autorizuar për përcjellje të komunikimeve specifikim teknik për llojin dhe karakteristikat e pajisjes për interfejs (neni 175 paragrafi (3));

44) nuk i zbaton masat dhe standardet e përcaktuara për siguri të informacionit në pajtim me nenin 175 paragrafi (4) të këtij ligji;

45) Nuk e mënjanon dendësimin hyrës ose kriptombrojtjen e komunikacionit komunikues (nenin 175 paragrafi (5));

46) nuk i mundëson organit të autorizuar për përcjellje të komunikimeve, përcjellje të komunikimeve në kohën reale, informata për përcjellje të komunikimit nuk është në dispozicion menjëherë pas përfundimit të komunikimit ose përcjellja e komunikimit nuk është e pandërprerë gjatë tërë kohëzgjatjes së saj (neni 175 paragrafi (6));

47) nuk siguron lidhje të saktë dhe të njërendësishme të informatës për komunikimin ardhshëm me përmbajtjen e komunikimit i cili përcillet (neni 175 paragrafi (7));

48) nuk siguron personi komunikimet e të cilit përcillen ose person tjetër i paautorizuar të mos vërejnë çfarëdo qoftë ndryshimi në kualitetin e shërbimit të komunikimit ose funksionimin e shërbimit të ardhshëm komunikues është i ndryshuar për personin komunikacionit e të cilit përcillen (nenin 175 paragrafi (8));

49) nuk garanton siguri të njëjtë ose më të madhe dhe kualitet të shërbimit të ardhshëm të komunikimit të sigurisë dhe kualitetit të shërbimeve të komunikimit të cilat i janë mundësuar personit komunikimet e të cilit përcillen (nenin 175 paragrafi (9));

50) nuk i mban të dhënat për komunikimet elektronike në pajtim me nenin 176 paragrafi (1) të këtij ligji;

51) të dhënat dhe të gjitha informatat tjera të domosdoshme nuk ua dorëzon organeve kompetente në pajtim me nenin 176 paragrafin (3) të këtij ligji;

52) në shpenzime personale nuk i siguron të gjitha mjetet e domosdoshme teknike dhe masa organizuese për mbajtje të të dhënave (nenin 176 paragrafi (4));

53) të gjitha mjetet e domosdoshme teknike janë të vendosura jashtë nga Republika e Maqedonisë (neni 176 paragrafi (5));

54) nuk i respekton parimet për siguri të të dhënave të përcaktuara me nenin 177 të këtij ligji;

55) nuk i mban llojet të të dhënave të përcaktuara në nenin 178 paragrafët (1) dhe (3) të këtij ligji;

56) mban të dhëna të cilat e zbulojnë përmbajtjen e komunikimit (nenin 178 paragrafi (4)), dhe

57) nuk i mban të dhënat në periudhë kohore në pajtim me nenin 178 paragrafi (5) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 1.5000 deri në 3.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës te personi juridik dhe tregtarit individual për shpenzimin nga paragrafi (1) të këtij neni.

Neni 182

(1) Gjobë në shumë prej 20.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

1) nuk mundëson kryerje të papenguar të mbikëqyrjes ose nuk i jep të gjitha informatat dhe të dhënat të nevojshme për kryerje të mbikëqyrjes (nenin 40 paragrafi (1));

2) nuk siguron kushte të domosdoshme për punë të papenguar ose përcaktim të gjendjes faktike (neni 40 paragrafi (2));

3) nuk mundëson në afatin e caktuar qasje në hapësirat ose dokumentet të cilat janë lëndë e mbikëqyrjes (neni 40 paragrafi (3));

4) në procedurën për kryerje të mbikëqyrjes nuk i plotëson detyrimet nga neni 42 të këtij ligji;

5) në kërkesë të Agjencisë nuk i dorëzon informatat në nivel të hollësisë ose në afatin e caktuar në kërkesë (neni 55 paragrafi (4));

6) mirëmbajtja e rrjeteve publike elektronike të komunikimit dhe mjeteve përcjellëse nuk kryhet në mënyrë të përcaktuar në nenin 62 paragrafin (3) të këtij ligji;

7) ndërtesa afariste ose e banimit nuk është e planifikuar ose ndërtuar në mënyrë të përcaktuar në nenin 63 të këtij ligji;

8) operatorit të rrjetit publik elektronik të komunikimit nuk i mundëson qasje deri te infrastruktura fizike me kushte, afate dhe çmime të drejta (nenin 66 paragrafi (1));

9) në afat prej një muaji nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim nga cili do operator, të njëjtit nuk i siguron qasje te informatat minimale, ose nuk siguron qasje në kushte proporcionale, jodiskriminuese ose transparente (neni 67 paragrafi (4));

10) operatorit nuk i mundëson kontroll në vendin e ngjarjes të elementeve të infrastrukturës të tij fizike, në afat prej një muaji nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim ose nuk i respekton parimet e proporcionalitetit, mosdiskriminimit dhe transparencës (nenin 67 paragrafi (5));

11) operatorit nuk ia vë në dispozicion informatat minimale të cilat kanë të bëjnë me punët rrjedhëse ose të planifikuara ndërtimore, në pajtim me nenin 67 paragrafin (6) të këtij ligji;

12) nuk i siguron informatat e kërkuara, në afat prej 60 ditësh nga dita e pranimit të kërkesës me shkrim, nuk i siguron në kushte proporcionale, jodiskriminuese ose transparente, ose të njëjtat nuk ua bën të kapshme Agjencisë (nenin 67 paragrafi (7));

13) nuk siguron qasje në pikën për përqendrim të ndërtesës në pajtim me nenin 69 paragrafi (1) të këtij ligji;

14) Agjencisë nuk i dorëzon informata për realizimin e qasjes në pajtim me nenin 69 paragrafin (5) të këtij ligji;

15) nuk i siguron detyrimet për shfrytëzim të përbashkët të lokacionit të njëjtë (kolokacion) ose shfrytëzim të përbashkët të elementeve të rrjetit dhe mjete përcjellëse në pajtim me nenin 75 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji;

16) Agjencisë nuk ia dorëzon informatat në lidhje me punët e planifikuara ndërtimore në pajtim me nenin 75 paragrafin (5) të këtij ligji;

17) çmimet e shërbimeve individuale të përfshira me shërbimin universal nuk janë të barabarta në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë (neni 99 paragrafi (2));

18) çmimet e shërbimeve individuale të përfshira me shërbimin universal nuk i shpall në ueb faqen e vet dhe/ose në mënyrë në të cilën do të jenë të kapshme për publikun (neni 99 paragrafi (6));

19) parapaguesve të vet nuk u siguron mundësi për kontroll të shpenzimeve në pajtim me nenin 100 paragrafin (2) të këtij ligji;

20) parapaguesve të vet nuk u jep llogari të hollësishme, në pajtim me nenin 101 të këtij ligji;

21) nuk i plotëson parametrat për kualitet në pajtim me nenin 103 paragrafin (1) të këtij ligji;

22) marrëveshja për kyçje dhe shfrytëzim të rrjeteve publike të komunikimit dhe/ose shërbime të komunikimit elektronik publikisht të kapshme nuk i përmban të dhënat nga neni 107 paragrafët (1), (2) dhe (4) të këtij ligji;

23) të dhënat i shfrytëzon për dedikime të ndryshme nga ato të përcaktuara në nenin 107 paragrafin (6) të këtij ligji;

24) të dhënat nuk i ruan në pajtim me nenin 107 paragrafin (7) të këtij ligji;

25) nuk mban evidencë për të gjitha marrëdhëniet e vendosura të parapagimit në pajtim me nenin 107 paragrafin (8) të këtij ligji;

26) nuk shpall informata transparente, përkatëse ose të azhuruara, në pajtim me nenin 108 paragrafët (1), (3) dhe (4) të këtij ligji;

27) publikisht nuk shpall informata krahasuese, përkatëse ose të azhuruara për kualitetin e shërbimeve të veta ose për masat e ndërmarra për sigurim të ekuivalencës në lidhje me qasjen e shfrytëzuesve të fundit me invaliditet, ose para se t'i shpall këto informata nuk ia dorëzon Agjencisë (neni 109 paragrafët (1) dhe (2));

28) nuk siguron kushte për kontroll dhe matje të parametrave për kualitet të shërbimeve publike të komunikimit (nenin 109 paragrafi (3));

29) nuk siguron kualitet të caktuar minimal të shërbimit, në pajtim me angazhimin nga Agjencia (nenin 109 paragrafi (4));

30) nuk i njofton parapaguesit e vet, falas dhe para se të jenë të përfshirë në listën telefonike, për qëllimin e listës telefonike të shtypur ose elektronike, ose për të gjitha mundësit e mëtejme për përdorim të të dhënave të tyre personale (nenin 112 paragrafi (5));

31) i përfshin parapaguesit e vet ose ka shpallur të dhëna personale të parapaguesve të vet në listat telefonike dhe shërbimet telefonike për informata pa pajtim të marrë paraprak për atë (nenin 112 paragrafi (6));

32) nuk i siguron mundësi parapaguesit, falas t'i ndryshojë ose plotësojë të dhënat personale, ose ta revokojë pajtimin për përfshirje të vet në lista telefonike dhe shërbime telefonike për informata (neni 112 paragrafi (7));

33) i ka vënë shfrytëzuesit e shërbimeve në hamendje me dhënie të informatave të gabuara ose të pavërteta ose me mbulim të informatave të vlefshme (neni 113 paragrafi (1));

34) në fillim të çdo thirrje ndaj shërbimit me vlerë të shtuar nuk siguron paralajmërim për çmimin e thirrjes ose për fillimin e pagesës, ose nuk siguron ndërprerje të thirrjes pas paralajmërimit në afat të arsyeshëm, ndërsa para fillimit të pagesës për thirrjen (neni 113 paragrafi (2));

35) e kufizon qasjen dhe/ose shfrytëzimin e shërbimeve dhe aplikime në kundërshtim me nenin 114 të këtij ligji;

36) kryen kufizim të përkohshëm ose ndërprerje të qasje, në kundërshtim me nenin 115 të këtij ligji;

37) nuk siguron mundësi të qasjes falas deri te numrat e shërbimeve për thirrje urgjente ose numri unik evropian për thirrje urgjente "112" në pajtim me nenin 117 paragrafët (1) dhe (2) të këtij ligji;

38) trupit kompetent për pranim të thirrjeve në numrin unik evropian për thirrje urgjente "112" nuk ia dorëzon pa kompensim, të gjitha të dhënat në dispozicion për thirrjet e realizuara në numrin "112" (nenin 117 paragrafi (4));

39) me thirrjet në numrin "112" nuk vepron në mënyrë të njëjtë, si dhe me thirrjet tjera në numrat e shërbimeve për thirrje urgjente të cilat ende shfrytëzohen në Republikën e Maqedonisë (nenin 117 paragrafi (5));

40) nuk mundëson vendosjen e të gjitha thirrjeve ndaj numrave nga sesioni i numrave e cila fillon me numrin "116" në pajtim me nenin 119 të këtij ligji;

41) nuk punon në pajtim me lejen për shfrytëzim të radiofrekuencave (neni 142 paragrafi (1));

42) u ndan numra dhe/ose seri të numrave siguruesve të shërbimeve tjera pa marrëveshje të lidhur ose pa e respektuar parimin e mosdiskriminimit (nenin 151 paragrafi (8)) dhe

43) te thirrjet në shërbimet për shërbime urgjente nuk qaset në pajtim me nenin 172 paragrafi (3) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 1 000 deri në 1 500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet personit përgjegjës te personi juridik dhe tregtarit individual për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 183

(1) Gjobë në shumë prej 10.000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

1) nuk e paguan kompensimin vjetor për mbikëqyrje të tregut në afatin e përcaktuar në nenin 30 paragrafi (5) të këtij ligji;

2) nuk e paguan dallimin e llogaritur në pajtim me nenin 30 paragrafi (7) të këtij ligji;

3) nuk e paguan kompensimin vjetor për shfrytëzim të radiofrekuencave në pajtim me nenin 31 paragrafi (5) të këtij ligji;

4) nuk e paguna kompensimin vjetor për shfrytëzim zë numrave dhe/ose serive të numrave në pajtim me nenin 32 paragrafi (6) të këtij ligji;

5) me shkrim nuk e njofton kërkesin për refuzim të kërkesës të tij ose nuk i thekson shkaqet për atë në afatin të përcaktuar në nenin 66 paragrafin (3) të këtij ligji;

6) nuk plotëson kërkesë të arsyeshme për lidhje të marrëveshjes për koordinim të ndërsjellë të punëve ndërtimore, në pajtim me nenin 68 paragrafin (1) të këtij ligji;

7) nuk i azhurnon të dhënat në listën e plotë telefonike ose në shërbimin e plotë telefonik për informata, në pajtim me nenin 94 paragrafin (5) të këtij ligji;

8) nuk e kufizon qasjen te shërbimet e tij dhe/ose e ndërpret parapaguesin ose e prish marrëveshjen për kyçe dhe shfrytëzim të rrjeteve publike të komunikimit dhe/ose shërbime elektronike të komunikimit publikisht të kapshme në kundërshtim me nenin 102 të këtij ligji;

9) publikisht nuk i shpall të dhënat për kualitetin shërbimeve të përfshira me shërbimin universal, ose të njëjtat nuk ia dorëzon Agjencisë (neni 103 paragrafi (2));

10) nuk i paguan mjetet në fondin e kompensimit për shërbim universal në afat ose shumë të përcaktuar me vendim të Agjencisë (nenin 106 paragrafi (4));

11) lidh marrëveshje fillestare në kohë të caktuar obliguese më gjatë se 24 muaj ose parapaguesit nuk i jep mundësi për lidhje të marrëveshjes me kohëzgjatje jo më të gjatë se 12 muaj (nenin 107 paragrafi (9));

12) nuk i plotëson kërkesat teknike ose funksionale në pajtim me nenin 110 paragrafin (1) të këtij ligji;

13) nuk i plotëson detyrimet plotësuese të tërë ose në një pjese të territorit të Republikës së Maqedonisë, në pajtim me nenin 111 të këtij ligji;

14) nuk i plotëson të gjitha kërkesat e arsyeshme për marrje të të dhënave për parapaguesit e vet nga ana e shërbimeve telefonike publikisht të kapshme për informata ose lista telefonike, në pajtim me nenin 112 paragrafi (2) të këtij ligji;

15) të gjithë shfrytëzuesve të fundit të shërbimeve publike telefonike nuk u siguron qasje te shërbimet telefonike për informata (nenin 112 paragrafi (3));

16) parapaguesve të vet nuk u mundëson bartje të numrave në pajtim me nenin 116 të këtij ligji;

17) nuk siguron fillim të thirrjes te numrat nga Plani për numërtim në pajtim me nenin 118 paragrafin (2) të këtij ligji;

18) shfrytëzuesve të shërbimeve nga shteti tjetër nuk u siguron mundësi të kenë qasje te numrat jogjeografikë nga Plani për numërtim në pajtim me nenin 118 paragrafi (4) të këtij ligji;

19) nuk e prish marrëveshjen, pa kompensim ose nuk i kthen të gjitha mjetet në para të paguara pa arsye, në pajtim me nenin 120 paragrafi (7) të këtij ligji;

20) shfrytëzon radiofrekuenca pa leje SERT të vlefshme radioamaterike (nenin 131 paragrafi (2));

21) nuk e njofton Agjencinë për cilin do ndryshim të të dhënave të përcaktuara në kërkesën për dhënie të lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave në afat prej 14 ditë nga dita kur është kryer ndryshimi (nenin 133 paragrafi (6));

22) rrjetet publike të komunikimit nëpërmjet të cilave sigurohet transmetim i shërbimeve digjitale televizive nuk planifikohen në mënyrë me të cilën do të sigurohet transmetim i shërbimeve televizive dhe programe me format të ekranit të gjerë (neni 158 paragrafi (1));

23) gjatë pranimit dhe transportimit kthyes të shërbimeve televizive ose programeve me ekran të gjerë nuk e mbajnë formatin e tyre (nenin 158 paragrafi (2));

24) siguruesit e shërbimeve interaktive të televizionit digjital nuk shfrytëzojnë API të hapur (neni 158 paragrafi (3));

25) siguruesit e pajisjes bashkëkohore të televizionit digjital shfrytëzojnë API të hapur që nuk është në pajtim me kërkesat minimale të standardeve relevante ose specifikime (nenin 158 paragrafi (4));

26) të gjithë radiodifuzerëve nuk u siguron me kushte të drejta, të arsyeshme ose jodiskriminuese, shërbime teknike të cilat do të mundësojnë servis programor të radiodifuzerëve që emetohen në mënyrë digjitale të jenë të pranuar nga shikuesit ose nga dëgjuesit, nëpërmjet të shfrytëzimit të dekoderëve (neni 160 paragrafi (2));

27) nuk mban kontabilitet të veçantë për shërbimet me qasje të kushtëzuar, veçmas nga aktivitetet tjera (nenin 160 paragrafi (3));

28) në ueb faqen e saj nuk e shpall ose nuk e azhurnon llojin dhe specifikimet teknike të interfejsit të rrjetit të vet publik të komunikimit (nenin 162 paragrafi (1));

29) specifikimet teknike nuk janë në pajtim me nenin 162 paragrafi (2) të këtij ligji;

30) nuk e informon parapaguesin ose shfrytëzuesin në pajtim me nenin 169 paragrafi (4) të këtij ligji;

31) nuk e mënjanon mundësinë për parandalim të prezantimit të identifikimit të linjës thirrëse, në pajtim me nenin 172 paragrafi (1) të këtij ligji;

32) nuk i rruan thirrjet hyrëse dhe dalëse të parapaguesit në pajtim me nenin 172 paragrafi (2) të këtij ligji;

33) parapaguesit nuk i siguron mundësi, falas dhe duke shfrytëzuar mjete të thjeshta ta ndërpresë ridrejtimin automatik të thirrjes nga pala e tretë deri te pajisja e tij terminale (nenin 173), dhe

34) Lejon shfrytëzimin e thirrjes automatike dhe të sistemeve të komunikimit për thirrje të numrave telefonikë me parapagesë, pa pajtim të marrë paraprak nga parapaguesi (neni 174 paragrafi (1)).

(2) Gjorbë në shumë prej 500 deri në 1.000 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës te personi juridik dhe tregtarit individual për kundërvajtje nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 184

(1) Gjorbë në shumë prej 5 000 euro në kundërvlerë me denarë, do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:

1) nuk dorëzon raport për shumën e të hyrës së përgjithshme në afatin të përcaktuar në nenin 30 paragrafin (3) të këtij ligji;

2) nuk e njofton Agjencinë për ndryshim të të dhënave na pajtim me nenin 60 paragrafin (6) të këtij ligji;

3) nuk e njofton Agjencinë për ndërprerje me sigurim të rrjeteve publike elektronike të komunikimit dhe/ose shërbime në pajtim me nenin 60 paragrafin (7) të këtij ligji;

4) nuk jep të dhëna për së paku një numër telefonik i cili do të jetë i shpallur në listën e plotë telefonike (neni 94 paragrafi (4));

5) te Agjencia nuk dorëzon të dhëna për të hyra të realizuara në pajtim me nenin 106 paragrafin (5) të këtij ligji;

6) nuk vepron për kundërshtimin e parashtruar nga parapaguesi në pajtim me nenin 113 paragrafi (3) të këtij ligji;

7) nuk vendos për kundërshtimin në afat prej 10 ditësh nga dita e pranimi të të njëjtës (nenin 113 paragrafi (4));

8) bën keqpërdorim të thirrjeve ndaj numrave të shërbimeve për thirrje urgjente ose numri unik evropian për thirrje urgjente "112" në pajtim me nenin 117 paragrafi (7) të këtij ligji;

9) parapaguesit nuk i jep vërtetim për kontrollin e kryer administrativ dhe/ose teknik ose nuk i jep vërtetim me elemente të sakta dhe dukshëm të vendosur nga kontrolli administrativ dhe/ose teknik (nenin 120 paragrafi (4));

10) në rast të kundërshtimit të parashtruar nuk vepron në pajtim me nenin 120 paragrafi (5) të këtij ligji;

11) pa prolongim ose pa kompensim, përsëri nuk fillon ose nuk e vazhdon sigurimin e shërbimit (nenin 120 paragrafi (6));

12) parapaguesit nuk i dorëzon përgjigje me shkrim për themelimin e kundërshtimit të parashtruar në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimi të kundërshtimit (nenin 120 paragrafi (8));

13) nuk e njofton Agjencinë për zbatim të të dhënave për bartësin e lejes për shfrytëzim të radiofrekuencave në afat prej 30 ditësh nga dita e krijimit të ndryshimit (neni 142 paragrafi (2));

14) agjencisë nuk ia dorëzon marrëveshjet e lidhura në afat prej pesë ditësh nga dita e lidhjes së tyre (nenin 151 paragrafi (9));

15) nuk e njofton Agjencinë për çdo ndryshim të të dhënave për poseduesin e të drejtës të shfrytëzimit të numrave dhe/ose të numrave në afat prej 30 ditësh nga dita e ndryshimit të krijuar (neni 152 paragrafi (2));

16) refuzon lidhje të radio pajisjes dhe/ose pajisje terminale të telekomunikimit (nenin 164 paragrafi (1));

17) nuk e njofton Agjencinë se e ka refuzuar lidhjen e radio pajisjes dhe/ose pajisjes terminale të telekomunikimit, se e ka shkyçur ose se e ka tërhequr prej përdorimi, në pajtim me nenin 164 paragrafët (2) dhe (3) të këtij ligji;

18) Kyç në rrjet publik të telekomunikimit radio pajisje ose pajisje terminale të telekomunikimit, e cila nuk është në pajtim me kushtet e përcaktuara në Ligjin për siguri të prodhimeve, rregullat e miratuara në bazë të tij dhe këtij ligji (neni 164 paragrafi (4));

19) agjencisë nuk i dorëzon të dhëna në pajtim me nenin 165 paragrafin (4) të këtij ligji;

20) në kërkesë të Agjencisë nuk e shkyç nga rrjeti publik mobil i komunikimit, pajisjen terminale të telekomunikimit e cila nuk është e evidentuar në regjistër (neni 165 paragrafi (5));

21) shfrytëzuesit të fundit i cili e ka paguar thirrjen nuk i mundëson thjeshtë dhe falas ta pengojë paraqitjen e identifikimit të linjës së thirrjes për çdo thirrje individuale (neni 170 paragrafi (1));

22) parapaguesit të thirrur, nuk i mundëson thjeshtë dhe falas ta parandalojë paraqitjen e identifikimi të linjës së thirrjes, te thirrjet hyrëse (neni 170 paragrafi (2));

23) parapaguesit të thirrur nuk i mundëson në mënyrë të thjeshtë t'i refuzojë thirrjet hyrëse në pajtim me nenin 170 paragrafin (3));

24) parapaguesit të thirrur nuk i mundëson thjeshtë dhe falas ta pengojë paraqitjen e identifikimit të linjës së thirrur (nenin 170 paragrafi (4));

25) nuk e informon publikun në pajtim me nenin 170 paragrafin (6) të këtij ligji;

26) i shfrytëzojnë të dhënat elektronike të kontaktit për postë elektronike të marrë nga konsumatorët e prodhimeve të tyre ose shërbimet në kundërshtim me nenin 174 paragrafi (2) të këtij ligji;

27) siguron komunikime të pakërkuara në kundërshtim me nenin 174 paragrafin (3) të këtij ligji dhe

28) dërgon postë elektronike për marketing të drejtpërdrejtë ose për nxitje të vizitës së ueb faqeve të caktuara në kundërshtim me ndalimin nga neni 174 paragrafi (4) të këtij ligji.

(2) Gjobë në shumë prej 500 eurosh në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet edhe personit përgjegjës te personi juridik edhe tregtarit individual për kundërvajtjen nga paragrafi (1) i këtij neni.

Neni 185

Gjobë në shumë prej 1.000 deri në 1.500 euro në kundërvlerë me denarë do t'i shqiptohet për kundërvajtje personit fizik i cili nuk kryen veprimtari, nëse:

1) nuk dorëzon notifikim te Agjencia, para se të fillojë me sigurimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve publike të komunikimit elektronik (nenin 60 paragrafi (1));

2) bën keqpërdorim të thirrjeve në numrat e shërbimeve për thirrje urgjente ose numrin unik evropian për thirrje urgjente "112" në pajtim me nenin 117 paragrafi (7) të këtij ligji;

3) shfrytëzon radiofrekuenca pa leje për shfrytëzim të radiofrekuencave (neni 129 paragrafi (1));

4) shfrytëzon radiofrekuenca pa SERT leje që vlen radioamaterike (nenin 131 paragrafi (2)) dhe

5) kyç në rrjet publik të komunikimit pajisje radio ose të telekomunikimit, në kundërshtim të dispozitave të nenit 164 paragrafit (4) të këtij ligji.

Neni 186

Sanksione të njëzeta

(1) Personit juridik për kundërvajtje të kryer nga nenet 180, 181, 182, 183 dhe 184 të këtij ligji krahas gjobës do t'i shqiptohet edhe sanksion i kundërvajtjes ndalim për ushtrim të veprimtarisë të caktuar në kohëzgjatje prej gjashtë muaj deri në tre vjet, ndërsa mund t'i shqiptohet edhe sanksion i kundërvajtjes konfiskim i lëndëve me të cilat është kryer kundërvajtja.

(2) Personit përgjegjës te personi juridik për kundërvajtje të kryer nga nenet 180, 181, 182, 183 dhe 184 të këtij ligji, krahas gjobës, do t'i shqiptohet edhe sanksion i kundërvajtjes ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë ose detyrës në kohëzgjatje prej tre muaj deri në një vit.

(3) Tregtarit individ për kundërvajtje të kryer nga nenet 180, 181, 182, 183 dhe 184 të këtij ligji, krahas gjobës, do t'i shqiptohet edhe sanksion i kundërvajtjes ndalim për ushtrim të profesionit, veprimtarisë dhe detyrës në kohëzgjatje prej tre muaj deri në një vit, ndërsa mund t'i shqiptohet sanksion i kundërvajtjes konfiskim i sendeve me të cilat është kryer kundërvajtja.

(4) Personit fizik për kundërvajtje të kryer nga neni 185 i këtij ligji, krahas gjobës, mund t'i shqiptohet edhe sanksion i kundërvajtjes konfiskim i sendeve me të cilat është kryer kundërvajtja.

Kapitulli i njëzet

DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

Neni 187

Anëtarët e Komisionit të Agjencisë dhe drejtori i Agjencisë të emëruar në pajtim me Ligjin për komunikime elektronike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 13/2005, 14/2007, 55/2007, 98/2008, 83/10, 13/12, 59/12, 123/12 dhe 23/13) vazhdojnë ta ushtrojnë funksionin e vet deri në përfundim të mandatit për të cilin janë emëruar.

Neni 188

(1) Agjencia do t'i miratojë rregullat të cilat dalin nga ky ligj në afat prej nëntë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Deri në ditën e hyrjes në fuqi të rregullave nga paragrafi (1) i këtij neni do të zbatohen rregullat e miratuara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(3) Dispozitat nga neni 26 të këtij ligji do të zbatohen nga dita e fillimit të zbatimit të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14) dhe Ligjit për nëpunës administrativë ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 27/14).

(4) Deri në ditën e fillimit të zbatimit të dispozitave nga neni 26 të këtij ligji, për të punësuarit në Agjenci do të vlejné dispozitat e përgjithshme për marrëdhënie pune.

Neni 189

(1) Dispozita nga neni 36 paragrafi (5) të këtij ligji do të zbatohet nga 1 qershori 2015.

(2) Komisioni për dhënie të provimit profesional nga neni 36 paragrafi (5) të këtij ligji, do të formohet më së voni deri më 1 korrik 2015. Komisioni është i obliguar që në afat prej 6 muajsh nga dita e formimit të tij të zbatojë dhënie të provimit profesional personave të cilit para ditës së hyrjes në fuqi të këtij ligji janë të punësuar në shërbimin profesional në Agjencinë nga neni 36 paragrafi (1) të këtij ligji.

(3) Komisioni për vendimmarrje nga neni 50 paragrafi (4) të këtij ligji do të formohet në afat prej 30 ditësh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(4) Procedurat për kundërvajtje të filluara në pajtim me Ligjin për komunikime elektronike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 13/2005, 14/2007, 55/2007, 98/2008, 83/10,13/12, 59/12, 123/12 dhe 23/13) do të vazhdojnë në pajtim me këtë ligj.

Neni 190

(1) Agjencia do ta sigurojë pikën e vetme për informata nga neni 67 paragrafi (1) të këtij ligji në afat prej gjashtë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Agjencia është e obliguar që në afat prej një muaji nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji të fillojë fushatë publike për promovim të pikës së vetme për informata nga neni 67 paragrafi (1) të këtij ligji.

Neni 191

Dhënësit ekzistues të shërbimit universal edhe pas hyrjes në fuqi të këtij ligji vazhdojnë t'i sigurojnë shërbimet e përfshira me shërbimin universal në pajtim me marrëveshjet e lidhura për sigurim të shërbimit universal.

Neni 192

(1) Poseduesit e lejeve për shfrytëzim të radiofrekuencave të cilat janë dhënë para hyrjes në fuqi të këtij ligji, kanë të drejtë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji deri më 25 maj 2016, të dorëzojnë kërkesë te Agjencia që t'i kontrollojnë kufizimet nga aspekti i gjendjes neutrale në lidhje me teknologjitë dhe neutralitet në lidhje me shërbimet, të përcaktuara me leje të dhëna për shfrytëzim të radiofrekuencave.

(2) Gjatë kontrollit të kufizimeve nga paragrafi (1) i këtij neni, Agjencia mund të përcaktojë kushte të reja, më ndryshe, për shfrytëzim të radiofrekuencave nga ato të përcaktuara në lejet e dhëna për shfrytëzim të radiofrekuencave, si dhe pagesë të kompensimit të ri të njëanshëm për shfrytëzim të radiofrekuencave në pajtim me nenin 33 të këtij ligji, nëse bëhet ndryshim i lejes ekzistuese për shfrytëzim të radiofrekuencave.

(3) Agjencia para se të vendosë për kërkesën nga paragrafi (3) i këtij neni obligohet ta njoftojë parashtruesin e kërkesës për kushtet e reja nga paragrafi (2) i këtij neni, si dhe pagesa e kompensimit të ri të njëanshëm për shfrytëzimin e radiofrekuencave dhe t'i caktojë afat të

arsyeshëm në të cilin ai mund ta tërheq kërkesën, nëse nuk i pranon kushtet e reja për shfrytëzim të radiofrekuencave si dhe pagesën e kompensimit të njëanshëm. Në atë rast kushte për shfrytëzim të radiofrekuencave të përcaktuara në lejen ekzistuese për shfrytëzim të radiofrekuencave vazhdojnë të vlejnjë deri më 25 maj 2016.

(4) Pas 25 maji 2016, Agjencia do t'i ndërmarrë të gjitha masat përkatëse që të sigurojë se dispozitat e neneve 126 dhe 127 të këtij ligji zbatohen te të gjithë poseduesit tjerë të lejeve për shfrytëzimin e radiofrekuencave të cilat janë të dhëna para hyrjes në fuqi të këtij ligji, me ç'rast duhet të mbajë llogari për sigurimin e konkurrencës së drejtë në pajtim me këtë ligj.

Neni 193

(1) Operatorët janë të detyruar ta harmonizojnë punën e tyre në pajtim me aktin nga neni 166 të këtij ligji në afat prej 18 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

(2) Operatorët janë të detyruar që t'i sigurojnë të gjitha mjetet teknike të domosdoshme dhe masat organizuese nga neni 176 paragrafi (4) të këtij ligji në afat prej nëntë muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Neni 194

Legjitimacionet ekzistuese të inspektorëve për komunikime elektronike të lëshuara në pajtim me Ligjin për komunikime elektronike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 13/2005, 14/2007, 55/2007, 98/2008, 83/10,13/12, 59/12, 123/12 dhe 23/13), vazhdojnë të vlejnjë deri në miratimin e aktit nënligjor nga neni 37 paragrafi (3) të këtij ligji.

Neni 195

Procedurat për lëshimin e lejeve për shfrytëzimin e radiofrekuencave dhe për bartjen e të drejtës për shfrytëzimin e radiofrekuencave, të filluara në pajtim me Ligjin për komunikime elektronike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 13/2005, 14/2007, 55/2007, 98/2008, 83/10,13/12, 59/12, 123/12 dhe 23/13), do të vazhdojnë në pajtim me këtë ligj.

Neni 196

Me ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji shfuqizohet Ligji për komunikime elektronike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë numër 13/2005, 14/2007, 55/2007, 98/2008, 83/10,13/12, 59/12, 123/12 dhe 23/13).

Neni 197

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tetë nga dita e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".